# GAZETA SHQIPTARE




Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIV - Nr. 7413 E enjte 18 Janar 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)




Intervista e Ditës

Nga MONIKA KRYEMADHI

## Reforma në drejtësi, nuk mund të përdoren dy standarde



Kryetarja e LSI-së Monika Kryemadhi gjatë një interviste në "Ora News" u shpreh se reforma në drejtësi pa LSI nuk do bëhej dhe nuk do të ishte e realizuar ..

Vijon në faqen 20



Opinioni i Ditës

Nga BESIM NDREGJONI

## Dëmshpërblimi i të përndjekurve, detyrim kushtetues

Në preambulën e Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, thuhet: Ne të gjithë, populli shqiptar dhe përfaqësuesit e tij, theksojmë vendosmërinë për ...

Vijon në faqen 21



I mbijetuari: Na qëlluan sapo u futëm në makinë

## Vrasja te "21 dhjetori", Melvi Disha: S'kam dijeni kush janë autorët, ulëm kokat kur shtinë

Atentati ndaj Emiljano Boçit, policia: Nuk kanë lënë asnjë gjurmë

Nga INA ALLKANJARI

Kanë kaluar 5 ditë nga ngjarja tragjike e ndodhur në rrugën "Shefqet Musaraj" në kryeqytet, ku humbi jetën 32-vjeçari Emiljano Boçi, por ende mbeten të panjohur autorët e atentatit. Natën e sulmit, Boçi ishte i shoqëruar ...

Në faqen 9

AGJENCIA E TRAJTIMIT TE PRONAVE: LISTA E PLOTE ME EMRAT E PERFITUESVE

# NIS SOT KOMPENSIMI PER 450 PRONARE, DOKUMENTET

Qeveria jep 300 milionë lekë që do ndahen në Tiranë, Durrës, Shkodër, Elbasan, Fier, Vlorë dhe Korçë. Ku duhet të paraqiteni për kërkesën...



*(Në foto)* Toka (foto ilustruese)

Në faqet 14-17

VIZITA NE TIRANE

## Presidenti maqedon nuk dekreton shqipen, Bujar Osmani: Ligjin do ta miratojmë prapë

Në faqet 4-5

KESHILLAT

## Mjeku popullor Ylli Merja: Me këtë pluhur do e largoni gripin menjëherë

Në faqen 10

FOTO ME RAMEN NE 2013

## Një drejtor galerie për dy shtetet, zgjidhet kuratori Erzen Shkololli

Në faqen 18

ÇFARE NDODHI ME 2015

## Vrau në pritë me kallashnikov të riun, gjykata dënon me 20 vjet burg autorin

Në faqen 12

INTERVISTA/ TENTUAN TE ME PERBALTIN BRENDA PD



## U akuzua sigurims Gjana merr certifikatën e pastërtisë: Në parti secili të hapë 'kutinë'

Në faqen 2

Adela Vasili: Vaksina, mjeti i vetëm për shpëtimin e jetës në të tilla raste

# Epidemi fruthi në vend, 16 fëmijë të prekur

*Epidemiologia e ISHP-së: Mbi 1200 të pavaksinuar në Tiranë*

Nga VOLTIZA DURO

Ka arritur në 16 numri i fëmijëve të konfirmuar me fruth, ndërkohë në kryeqytet mbi 1200 prej tyre janë ende të pavaksinuar. Rastet më të shumta sipas Institutit të Shëndetit Publik, janë kryesisht fëmijë nën 1 vjeç, por vlen të theksohet se mund të jetë prekur edhe një i rritur, i cili po mbahet nën mbikëqyrje. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Adela Vasili, epidemiologe në Departamentin e Kontrollit të Sëmundjeve ...



Në faqen 11

# HAPJA E DOSJEVE
## INTERVISTA

Dokumenti, ish-ministri i PD-së hedh poshtë akuzat për bashkëpunim me ish-Sigurimin

# Gjana merr certifikatën e pastërtisë: Brenda PD-së tentuan të më përbaltin

## "Akuza të paqena, secili në PD të hapë kutinë e tij"



Valentina Madani

*Ish-ministri Jemin Gjana, aktualisht kreu i Departamentit për Kthimin e Figurave Historike në PD, pavarësisht akuzave nga vetë brenda partisë së tij, nuk rezulton të ketë qenë bashkëpunëtor i ish-Sigurimit. "Gazeta Shqiptare" zbardh dokumentin që z.Gjana ka marrë nga Autoriteti për informimin mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Referuar këtij dokumenti, rezulton se Jemin Gjana nuk ka qenë bashkëpunëtor i ish-Sigurimit, nuk është survejuar apo privilegjuar. Dokumenti provon se akuzat në drejtim të ish-ministrit në qeverisjen e PD-së nuk qëndrojnë, ndërsa tregon arsyet se pse iu drejtua institucionit të Autoritetit për Informimin mbi dosjet e ish-Sigurimit. Ndaj, z.Gjana përmes "Gazeta Shqiptare" u përgjigjet sulmeve dhe përbaltjes nga brenda PD-së, duke i kërkuar secilit në PD që të hapë kutinë e tij.*

**Z.Gjana, jeni pajisur me certifikatën e pastërtisë nga Autoriteti i Hapjes së Dosjeve?**

Po, e kam marrë certifikatën e pastërtisë.

**Autoritetit i jeni drejtuar vullnetarisht dhe për cilat arsye?**

Po, kam shkuar në mënyrë vullnetare. I jam drejtuar këtij institucioni në korrik të vitit të shkuar, kur temperaturat e përplasjeve brenda PD-së njohën nivele të larta. Një portal që hiqet se anon djathtas lëshoi ndaj karrierës sime politike dhe ndaj të shkuarës sime një vulg akuzash thjesht e qartë të sajuara në mënyrë të ulët.

**Për çfarë bëhet fjalë…?**

Të parat sajime kishin të bënin me mandatin tim si ministër. Në dijeninë time është hera e parë që ndërtohet një blof i tillë. Gjithsesi, letrat janë aty, firmat e mia për çdo vendim janë aty e kësisoj institucionet ligjzbatuese të shtetit kanë në dorë çdo lloj kontrolli. Jam krenar për njerëzit dhe për drejtorët në ministri dhe dy institucionet qendrore të saj me të cilët punova për katër vjet. Kam ende edhe sot, kudo ku janë, vlerësimet më maksimale për punën dhe profesionalizmin e tyre. Mjafton të theksoj se nga 17 drejtorë në nivel qendror me të cilët kam punuar, 10 prej tyre kanë qenë me titujt doktor, as.profesor dhe deri profesor në lëmin e shkencave bujqësore.

**Jeni akuzuar nga vetë brenda PD-së për bashkëpunim me ish-Sigurimin e Shtetit. Si është e vërteta?**

Një akuzë tjetër, që nuk e prisja nga brenda ishte edhe lidhja ime krejt e sajuar me Sigurimin e Shtetit. Që në momentin që u bëra nënkryetar i PD-së më 1999, në disa raste, media, gazetarë dhe analistë të së majtës e ushqyen publikun me këtë mashtrim të qëllimshëm. Në verën e shkuar këtë e bënë dhe një a disa njerëz me të cilët për dekada kemi qenë në një front politik. Meqë ata që përtypën në verën e vitit të kaluar të njëjtin sajim të ulët dhe më kërkonin publikisht ta sqaroja të kaluarën time, e bëra edhe këtë duke kërkuar përgjigjen zyrtare nga institucionet e shtetit.



Ish-ministri Jemin Gjana



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Tiranë, më 11.10.2017

Lënda: Kthim përgjigje

Z. Jemin Gjana

I nderuar zoti Gjana,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Ermira Shtino



Faksimile e certifikatës së pastërtisë të Jemin Gjanës

**Përse ku vendim i juaj pikërisht në këtë periudhë?**

Do e bëja që në muajt e fundit të vitit të kaluar, por për arsye personale nuk jam ndodhur në Shqipëri që prej fundit të nëntorit 2017.

**Ju i keni kërkuar z.Basha që të hapë "kutinë e zezë" të kritikëve të tij. Kjo është arsyeja që u sulmuat nga brenda PD-së?**

Nuk dua ta zgjas më tepër çështjen e hapjes së atyre "kutive të zeza" në të shkuarën e hershme a të vonshme të të gjithkujt që i fut duart në politikë e në shtet. Por, ajo që dua të them është që secili të hapë "kutinë" e tij.

**AKUZA**

"Kushdo që merret me politikë, flet për politikën, është marrë a merret me shtet, le ta hapë 'kutinë' e tij. Çdo kapje nga pushteti të denatyron, mjerë ai apo ajo që nuk arrin ta lexojë dhe pastaj u vërsulet më shumë kolegëve të kampit të vet, se sa kundërshtarëve politikë".

**Kujt i drejtoheni konkretisht?**

Reagimi im ka të bëjë me faktin se disave në luftën e ethshme brenda PD-së gjetën mënyrat e tyre përmes një portali për të më sulmuar. Qëndrimet e mia nuk kanë lidhje me askënd individualisht. Jam nga të parët njerëz që i jam bashkuar PD-së. Kam qenë sekretar i degës së PD-së në Pogradec që në muajt e parë në vitin 1991, anëtar i Këshillit Kombëtar të kësaj partie prej 27 vitesh, anëtar i kryesisë qendrore prej 20 vitesh, që nga prilli i '97-ës nënkryetar dhe kryetar i grupit parlamentar të PD-së për një mandat, sekretar organizativ i PD-së. Kam drejtuar Komisione të rëndësishme parlamentare si ai i Ekonomisë dhe Financave, i Bujqësisë, i Veprimtarive Prodhuese e shumë komisione të posaçme si Komisioni bipartizan i Reformës Zgjedhore dhe ndarjes së Zonave Elektorale. Jam një ish-pushtetar i demokratëve që nuk jam përballur me akuza abuzimesh.

**Por jeni sulmuar edhe nga brenda PD-së. Për cilat arsye?**

Sulmet nga jashtë Partisë Demokratike i kam injoruar, por ato nga brenda saj, nga disa individë donin përgjigje. Jo për hir të tyre, por për hir të opinionit, për mendimet e mia parimore që të mos mund t'i përbaltnin me akuza të paqena. "Palla në thes nuk futet". Kushdo që merret me politikë, flet për politikën, është marrë a merret me shtet, le ta hapë 'kutinë' e tij. Çdo kapje nga pushteti të denatyron, mjerë ai apo ajo që nuk arrin ta lexojë dhe pastaj u vërsulet më shumë kolegëve të kampit të vet se sa kundërshtarëve politikë.

## Protesta, Basha: S'ndalemi derisa të mposhtim Ramën dhe krimin

Kreu i opozitës, Lulzim Basha, u bëri thirrje dje shqiptarëve që të marrin pjesë në protestën e 27 janarit për të bërë të mundur heqjen e pengesës së fundit për integrimin europian të vendit, Edi Ramës. Në një takim me aktivin e degës 7 të Tiranës, kreu i opozitës përmendi kushtin kryesor për hapjen e negociatave, që Rama nuk po e përmbush. "Prej Ramës nuk po luftohet krimi. Prej Ramës nuk po vihen dot para drejtësisë edhe ata që janë kapur me presh në duar, si Saimir Tahiri. Prej Edi Ramës nuk kapet 'Eskobari i Ballkanit', i cili bredh i lirë nga Tirana në Sarandë dhe nderohet në vend që të arrestohet nga policia dhe oficerët e korruptuar të policisë, që sot e kësaj dite ndodhen në kupolën e saj. Rama është pengesa kryesore për Shqipërinë europiane. Për ambicien e tij, për pushtetin e tij, për frikën e tij, për lidhjet e tij me krimin, e ka bërë kurban Shqipërinë europiane", - tha Basha. Ai përmendi se nën drejtimin e Edi Ramës, policia është shndërruar në një organizatë kriminalë, e cila në vend të luftojë për sigurinë e qytetarëve, është bërë pjesë e klaneve mafioze të krimit të organizuar. Kreu i opozitës theksoi se në rokadën mes Tahirit dhe Xhafajt ka ndryshuar vetëm lloji i drogës, që trafikohet nën mbrojtjen e qeverisë. "Europa ia ka bërë të qartë se pa luftuar drogën, nuk ka dhe nuk mund të ketë Shqipëri në Europë. Ndërsa Edi Rama me Fatmir Xhafajn tallen dhe zëvendësojnë klanin e Habilajve me klanin e Agron Xhafajt. Me Edi Ramën, policia dhe krerët e policisë janë kthyer në trafikantë dhe shitës kokaine", - theksoi kreu i opozitës. Lulzim Basha ftoi shqiptarët të marrin pjesë në protestën e 27 janarit për t'i treguar pakicës qeverisëse se aleanca e shumicës nuk pajtohet me krimin dhe se do pushtetarët e korruptuar para drejtësisë së pakapur nga qeveria. "Bashkohemi aty, sepse aty zëri i gjithsecilit kumbon dhjetëfish më shumë. Martin Luther King thotë: 'Mund të mos jesh përgjegjës për gjendjen për të cilën ndodhesh, por bëhesh bashkëpërgjegjës në qoftë se nuk reagon', ndaj ne do të çohemi, do të reagojmë me zë të lartë, do të bashkohemi, do të marshojmë për vlerat tona europiane. Rruga për t'i thënë 'Jo' aleancës në pushtet, rruga për t'i thënë ndalë të keqes fillon më 27 janar, por nuk ndalon derisa ta mposhtim", - u shpreh z.Basha.



REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA: **Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416, ***Marketingu:*** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com***, **ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu:*** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**



Partitë dorëzojnë emrat, 5 deputetët që do të përzgjedhin anëtarët e KLP dhe KLGJ

# Institucionet e drejtësisë, opozita nuk voton komisionin e përbashkët

## Bylykbashi: Rama do të kapë anëtarët e prokurorisë

Valentina Madani

Mazhoranca dhe opozita zgjodhën dje emrat e deputetëve përfaqësues në komisionin ad-hoc, që do të përzgjedhin anëtarët e Këshillit të Lartë të Gjyqësorit dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Do të jenë 3 anëtarë nga PS-ja dhe 3 nga opozita. PS do të përfaqësohet me Ulsi Manjën, Vasilika Hysin dhe Klotilda Bushën; PD me Oerd Bylykbashin, i cili do të jetë edhe nënkryetar i komisionit, ndërsa LSI me Nasip Naçon. Opozita mori pjesë në mbledhje, por nuk u përfshi në votimin e rregullores së nënkomisionit. Sipas demokratëve, mazhoranca ka arritur të sigurojë shumicën në vendimmarrjen e KLP-së, që do t'i garantojë kapjen jo vetëm të kryeprokurorit me mandat të plotë, por edhe të SPAK-ut. Deputeti Oerd Bylykbashi shpjegoi skemën se si PS-ja sipas tij po bëhet gati të vendosë nën kontroll politik institucionin më të rëndësishëm të drejtësisë, KLP-në. Nga ky institucion do të dalë kandidatura për Prokurorin e Përgjithshëm dhe do të zgjidhet Prokuroria e Posaçme, SPAK, që ka për detyrë hetimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit në nivele të larta. Z.Bylykbashi shpjegoi se PS-ja e ka shtrirë kapjen politike të KLP-së me 11 anëtarë në dy drejtime, duke kontrolluar 5 anëtarët joprokurorë që zgjedh parlamenti dhe duke kontrolluar procesin e zgjedhjes së 6 prokurorëve nëpërmjet presionit të kryeprokurores së përkohshme antikushtetuese. Ish-bashkëkryetari i Komisionit të Reformës në Drejtësi tha se procesi është korruptuar politikisht, që kur në ligj u vendosën filtra antikushtetues, që penguan konkurrimin e lirë të juristëve avokatë, pedagogë dhe shoqërisë civile për 5 anëtarët joprokurorë. Bylykbashi kujtoi se Gjykata Kushtetuese në shumicë 4 me 3, e cilësoi antikushtetues filtrin e vendosur nga mazhoranca në ligj, por numri 5 për ta rrëzuar zyrtarisht nuk u arrit, sepse Partia Socialiste bllokoi plotësimin e dy vendeve vakante në Gjykatën Kushtetuese, duke mos e mbledhur asnjëherë Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, që bën renditjen e kandidatëve për Gjykatën Kushtetuese. Sipas tij, theksoi se veprimet e PS-së për kapjen politike të KLD-së kulmuan me emërimin kundër përcaktimeve të Kushtetutës të kryeprokurores së përkohshme, nëpërmjet të cilës synojnë të kontrollojnë shumicën e 6 anëtarëve të tjerë prokurorë. Oerd Bylykbashi shpjegoi se lëvizjet joligjore që kryeprokuroja e përkohshme antikushtetuese po bën në prokurori janë sinjali më i qartë i presionit ndaj prokurorëve. Bylykbashi tha se, "në një sistem 'de facto' të centralizuar, prokurorët nën presionin e lëvizjes nga vendi i punës do të votojnë sipas urdhrave të një kryeprokuroreje politike, pa mandat, sepse është emëruar pa vetting dhe jo me 3/5-at". Ai u shpreh se me shumicën e KLP-së nën kontroll politik, qeveria nuk do të jetë e interesuar për konsensus në parlament, por do të përcaktojë vetë se kush do të jetë Prokuror i Përgjithshëm dhe prej kujt do të përbehet Prokuroria e Posaçme Kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit. Bylykbashi tha se kapja politike e Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga Edi Rama shpreh frikën e tij se një drejtësi e pakontrolluar prej tij do të përplaste pas hekurave të burgut anëtarët e qeverisë dhe kriminelët që kanë pas. Mazhoranca nuk replikoi, ndërsa sekretari i përgjithshëm i Kuvendit paraqiti raportet e tij për kandidatët.



**KOMISIONI AD-HOC**

- ULSI MANJA
- OERD BYLYKBASHI
- VASILIKA HYSI
- KLOTILDA BUSHKA
- NASIP NAÇO

## Kuvendi rikthen listën e kandidaturave të ONM për KLP

Kuvendi është tërhequr nga lista e kandidatëve për KLP, listë me të cilën rrëzoi propozimet e ekspertëve të ONM. Sekretari i përgjithshëm i Kuvendit, Genc Gjonçaj paraqiti raportin dhe mohoi që nëpërmjet tij ishin rrëzuar kandidaturat e ONM dhe Avokatit të Popullit. Sipas tij, është vota e deputetëve që vendos se kush do të jetë pjesë e KLP. "Raporti i sekretarit të Kuvendit nuk është përjashtues dhe se lista e ONM është pjesë përbërëse e këtij raporti. Raporti i sekretarit të përgjithshëm të Kuvendit nuk përjashton kandidaturat e ONM, përkundrazi ky raport garanton kushtet ligjore që procesi të jetë konkurrues, i pastër dhe transparent. Ndërsa, përzgjedhja e emrit është në tagrin e komisionit tuaj, e nënkomisionit që do krijoni dhe më tej në tagrin e deputetëve në seancën parlamentare", deklaroi z.Gjoncaj.



## Ankimimi, Kushtetuesja "rrëzon" Unionin e Prokurorëve

Gjykata Kushtetuese rrëzoi dje ankimimin e Unionit të Prokurorëve për ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale. Ankimimi i Unionit u rrëzua, pasi nuk u arrit kuorumi. Që të pranohej kërkesa e Unionit të Prokurorëve nevojiteshin 5 vota, por trupa gjykuese votoi me 4 anëtarë pro dhe 3 kundër. Në 2 gusht 2017 Unioni i Prokurorëve bëri ankimim në Gjykatën Kushtetuese kundër Kodit të Ri Penal, që hyri në fuqi më 1 gusht, duke kërkuar shfuqizimin e të paktën 20 neneve që cenojnë sipas tyre, pozicionin kushtetues të prokurorisë. Lidhur me këtë ankimim, përfaqësues të Unionit të Prokurorëve kanë thënë se, "kërkesa për shfuqizimin e disa neneve të ligjit nr. 35/2017 'Për disa ndryshime të Kodit të Procedurës Penale', të ndryshuar ka si qëllim të vetëm të mbrojë organin e prokurorisë si një organ i pavarur për të qenë në të njëjtën linjë, me qëllimin e reformës në drejtësi për të luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin".

"Kryeprokurorja", debate tek Komisioni i Ekonomisë

## Tabaku: Marku nën urdhrat e Ramës. Braçe: S'janë hetuar bashkiakët e PS

Komisioni i Ekonomisë nuk u përfshi dje nga debate për çështjen e kryeprokurores, drejtësisë dhe lëvizjeve të fundit që po ndodhin në organin e akuzës në vend. Demokratët akuzuan Arta Markun se po vepron nën urdhrat e kryeministrit dhe për interes të tij. "Nëse qeveria kishte nxitim kaq të madh për të gjetur një kryeprokuror të njëanshëm, duke mospërfshirë ashtu siç e thotë Kushtetuta, PD dhe opozitën, për një ndryshim kushtetues, atëherë veprimet e saj që nga dhjetori deri më sot tregojnë se është emëruar nga PS dhe thjesht varet nga kryeministri, duke marrë vendime për të bërë presion për të gjitha dosjet që PD ka 4 vite që denoncon. Faktet janë që Prokurori i Përgjithshëm i përkohshëm sot është duke marrë të gjitha vendimet që i interesojnë kryeministrit", tha deputetja Tabaku. Asaj iu kundërpërgjigj kreu i Komisionit të Ekonomisë, Erjon Braçe. Ai sfidoi hapur prokurorët e larguar nga Arta Marku, duke deklaruar se jep dorëheqjen nëse kanë hetuar kryetarët e bashkive të lidhur me PS. "Në qoftë se ju më thoni tani që në Prokurorinë e Durrësit është regjistruar procedim penal përkundrejt kryetarit të Bashkisë së Durrësit, unë jap dorëheqjen dhe largohem. Në qoftë se ju më thoni që ky prokurori i Elbasanit, që në dijeninë time ka nxjerrë policët në tentativë vrasjeje dhe vrasësit i ka nxjerrë nën akuzën e tejkalimit të vetëmbrojtjes, ka regjistruar procedim penal për kryetarin e Bashkisë së Elbasanit, unë jap dorëheqjen. Dhe ai zotëria në qoftë se ka regjistruar procedim penal dhe po heton për këta të dy, patjetër çohem unë dhe iki nga këtu", tha z.Braçe.



**NDRYSHIMET**

Komisioni i Ekonomisë diskutoi disa ndryshime në projektligjin për Këshillin Ekonomik Kombëtar, i cili u miratua me votat e mazhorancës që të kalojë në varësi të ministres së Shtetit për Mbrojtjen dhe Sipërmarrjen.

MAQEDONIA
VIZITA

### Zv. kryeministri maqedonas viziton Tiranën, pritet nga drejtuesit e shtetit

# Bujar Osmani: Ligjin e dygjuhësisë do ta miratojmë prapë në parlament

## *Meta: Zbatim të plotë të marrëveshjes së Ohrit*

Darina Tanushi

Zëvendëskryeministri për Çështjet Evropiane të Republikës së Maqedonisë, Bujar Osmani deklaroi dje, nga Shqipëria se, nëse presidenti Ivanov e nuk e dekreton ligjin e dygjuhësisë, do ta miratojnë sërish në parlament. "Presim verifikimin nga Presidenti, edhe nëse ai e refuzon nënshkrimin e këtij ligji do ta rikthejmë përsëri në parlament dhe me këtë do të bëhet i plotfuqishëm",-tha Osmani, në një intervistë për "Report tv", para refuzimit të Ivanov. Osmani u prit dje, nga Presidenti Ilir Meta, ministri i Jashtëm Ditmir Bushati, kreu i Kuvendit, Gramoz Ruçi si edhe nga kreu i PD-së, Lulzim Basha. Në njoftimin zyrtar të Presidencës thuhet se Presidenti Meta përshëndeti miratimin e ligjit për përdorimin e gjuhës shqipe nga ana e parlamentit të Maqedonisë, si një hap përpara për demokratizimin dhe forcimin e rrugës integruese të Maqedonisë. Presidenti theksoi rëndësinë e zbatimit të plotë të marrëveshjes së Ohrit, për respektimin e të drejtave të shqiptareve në Maqedoni dhe përmirësimin e klimës se besimit të ndërsjellë në mes të shqiptareve dhe maqedonasve, në interes të integrimit euro-atlantik të vendit. Presidenti Meta, shprehu angazhimin e tij për forcimin e bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe Maqedonisë, në interes të dy vendeve dhe perspektivës evropiane të rajonit. Në takimin me kreun e Kuvendit, të dy personalitetet vlerësuan rëndësinë e vizitave të niveleve më të larta për krijimin e kushteve për zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit dypalësh. Në takim u ritheksua vullneti për intensifikimin e përpjekjeve të përbashkëta për të konkretizuar piketat e bashkëpunimit të hedhura në mbledhjen e parë të përbashkët të dy qeverive në Pogradec, me qëllim fuqizimin e ndërlidhjes, përfundimin e korridoreve infrastrukturore, të energjisë, rrëzimin e barrierave të çfarëdollojshme, si dhe për mundësimin e një sinergjie efektive për perspektivën e përbashkët evropiane. Kryetari i Kuvendit theksoi faktin se Shqipëria do të vazhdojë të mbështesë fort integrimin euroatlantik të Maqedonisë dhe rikonfirmoi se "ne ndajmë vizionin e një rajoni integruar në strukturat euroatlantike, pasi Ballkani është një pjesë integrale e sigurisë europiane". Duke çmuar rolin e Shqipërisë dhe të gjithë faktorit shqiptar për paqen dhe stabilitetin në rajon, Kryetari i Kuvendit u shpreh se, për adresimin e çështjeve që i takojnë rajonit të Ballkanit Perëndimor duhet treguar maturi dhe pjekuri, nëpërmjet mekanizmave diplomatikë e politikë, nisur dhe nga mësimet që na ka dhënë historia, për të krijuar dhe forcuar klimën e mirëbesimit mes palëve, për të mos penguar dhe për të çuar përpara procesin e integrimit të rajonit në Bashkimin Europian. Gjatë takimit me ministrin e Jashtëm shqiptar, theksi u vu në mobilizimin e përpjekjeve të përbashkëta për avancimin e projekteve të ndërlidhjes infrastrukturore, energjetike, rrëzimit të barrierave dhe bashkëpunimit ekonomiko-tregtar. Viti mbarëkombëtar i Skënderbeut u konsiderua si një mundësi për evidentimin e trashëgimisë kombëtare, jo vetëm si vektor identiteti, por vlerë e përbashkët evropiane mes dy vendeve tona. Bushati veçoi, në këtë kontekst, përfundimin me sukses të procesit legjislativ për ligjin e përdorimit të gjuhëve, që siguron një shtrirje më të gjerë të përdorimit të shqipes, një akses më të mirë të qytetarëve në shërbime, një përfshirje më të madhe të shqiptarëve në Maqedoni në mirëqeverisje, politikat zhvillimore, si dhe ndërtimin e shoqërie të hapur dhe një shteti bazuar në vlerat evropiane.



Presidenti Ilir Meta dhe zv/kryeministri për Çështjet Evropiane të Republikës së Maqedonisë, Bujar Osmani



Parlamenti i Maqedonisë

**LULZIM BASHA**

Edhe kreu i PD-së në bashkëbisedim tha se miratimi i ligjit për gjuhën shqipe është shenjë e emancipimit të politikës e shoqërisë maqedonase dhe meritë e punës dhe uniakimit të faktorit shqiptar atje. 2018-a mund të jetë një vit i rëndësishëm për çlirimin e vendeve të rajonit nga krimi, korrupsioni dhe keqqeverisja autokratike,-u shpreh kryetari i opozitës.

### Zhvillohet takimi rajonal për bashkëpunimin territorial

## Bushati: Cilësia dhe shpejtësia e reformave do të na afrojnë me BE

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme organizoi dje, takimin rajonal mbi Programet e Bashkëpunimit Territorial, në të cilat aderon Shqipëria, me fokus mirëkoordinimin e instrumenteve financues të Bashkimit Evropian. Në fjalën e tij në këtë takim, ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme Ditmir Bushati tha se viti në të cilin kemi hyrë, është vit vendimtar jo vetëm për progresin e Shqipërisë drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, por për të gjitha vendet e rajonit të Ballkanit. "Prezantimi i Strategjisë së Zgjerimit muajin e ardhshëm, vendos në fokus politik dhe në një perspektivë konkrete politikën e zgjerimit. Ne presim nga kjo strategji propozime konkrete për hapat e radhës në ecurinë e procesit të aderimit për vendet e rajonit, përfshirë Shqipërinë, në një perspektivë afatshkurtër e afatgjatë",-tha ministri duke shprehur bindjen se veçanërisht, vijimi i implementimit të reformës në drejtësi, do të bëjë të mundur që dhe Shqipëria t'i bashkohet dy vendeve fqinje që tashmë kanë hapur negociatat për anëtarësim me Bashkimin Evropian, Mali i Zi dhe Serbia. Në fjalën e saj, ambasadorja e Bashkimit Evropian në Tiranë, Romana Vlahutin vlerësoi si të rëndësishme programet ndërkufitare dhe transnacionale, pasi sipas saj, ato jo vetëm rrisin cilësinë e jetës në vendet e rajonit, por ndërtojnë besimin mes njerëzve, mundësojnë shkëmbimin e njohurive, vlerave kulturore dhe traditave mes tyre. Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj i pranishëm në takim, tha se programet ndërkufitare dhe asistenca financiare e BE-së në përgjithësi, janë instrument kryesor i përmbushjes së vokacionit tonë drejt BE-së.



### Prokurori amerikan: Gjykatësit shqiptarë nuk justifikojnë pasurinë e luksin

Gjyqtarët në Shqipëri kanë një pasuri pesë deri në gjashtë herë më të madhe se ajo që mund të justifikohej me rrogat që ata marrin. Ky është mendimi i këshilltarit amerikan që asiston reformën në drejtësi, John Leonardo, i cili shprehet se korrupsioni është në nivele të shfrenuara në vendin tonë. Nga investigimet e para, Leonardo shpjegon se problematika kryesore mbetet dhënia e ryshfetit për funksionarët e gjyqësorit, në këmbim të favoreve gjatë dhënies së vendimeve. Prokurori amerikan, John Leonardo, i cili ndodhet në Tiranë funksionin e këshilltarit të reformës në drejtësi është shprehur se Shqipëria sikurse pjesa tjetër Ballkanit vuan nga një korrupsion i shfrenuar, i cili prek gjykatësit, prokurorët dhe policinë. "Gjyqtarët në këtë vend në 10 vitet e fundit kanë qenë të detyruar të deklarojnë asetet financiare dhe atë që zotërojnë. Ata pretendojnë se bëjnë një jetë modeste, por, në fakt, ata jetojnë në një ambient disi më luksoz nga ajo që thonë",-tha ai. Sipas Leonardos në Shqipëri ka një pritshmëri të madhe se pas vetingut, shumë gjyqtarë dhe prokurorë do të shkarkohen. Në mbyllje, Leonardo thotë se pritshmëritë e shqiptarëve nga Shtetet e Bashkuara dhe partnerët europianë janë të mëdha dhe se një mbështetës i madh i reformës në drejtësi ka qenë ambasadori amerikan në Tiranë, Donald Lu.



**NJOFTIM ANKANDI**

**Përmbarues gjyqësor privat Artan Sima**, në **datë 8/02/2018, ditën e Hënë, ora 16,00**, përfundon ankandin e ri (të dytë), për shitjen e pasurisë së paluajtshme të llojit **"truall"** me sipërfaqe 300 m2, nga e cila ndërtesë me sipërfaqe 94 m2, e ndodhur në Trevllazer, rrethi Vlorë në vlerën **280.000 lekë**. Pasuria është lenë garanci bankare nga debitorët z.Fatmir e Fatmiroshe Ismailaj banues në lagjen "24-Maji" tek Pishat Vlorë për detyrimin ndaj kreditorit Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit (FAF) Sh.a, me seli në Tiranë, Dega Rajonale Vlorë
Ankandi zhvillohet pranë zyrës së përmbaruesit me seli lagjen nr.3, Rruga "Avni Rustemi", nr.31 .k,1. Korçë. Kontakt Cel.0674044666, e-mail. simaartan@yahoo.com



Kuvendi maqedon e miratoi më 11 janar përdorimin e gjuhës tonë dhe në shtet

# Presidenti i Maqedonisë nuk dekreton shqipen si zyrtare

## Gjeorgje Ivanov: Ligji për përdorimin e gjuhëve, antikushtetues

Pas një pauze të gjatë, Presidenti i Maqedonisë, Gjorgje Ivanov përmes një paraqitjeje për opinionin të mërkurën në mbrëmje ka njoftuar se nuk do ta dekretojë ligjin për përdorimin e gjuhëve. Kuvendi i Maqedonisë më 11 janar miratoni ligjin për përdorimin e gjuhëve të bashkësive etnike, përmes së cilit avancohet përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe në të gjitha organet e pushtetit qendror. Ligji u miratua me 69 vota pro, asnjë kundër. Në seancë nuk morën pjesë deputetët e opozitës maqedonase të udhëhequr nga VMRO-DPMNE, parti kjo që këtë ligj e cilëson si antikushtetues. Presidenti Ivanov tha se ligji i gjuhëve është miratuar nga shumica parlamentare pa debat publik, pa marrë opinionin e ekspertëve, pa praninë e opozitës dhe i njëjti, sipas tij, është në kundërshtim me direktivat e Bashkimit Evropian. Ivanov tha se ligji në fjalë rrezikon karakterin unitar të shtetit, sovranitetin dhe integritet territorial të Maqedonisë, duke favorizuar vetëm gjuhën shqipe. "Sot e informova Parlamentin e Maqedonisë për vendimin tim që të mos e dekretoj ligjin për përdorimin e gjuhëve. Në kuadër të njoftimit me shkrim, në formë të detajuar kam arsyetuar vendimin e marrë. I ftoj deputetët e Parlamentit të Maqedonisë që me vëmendje t'i shqyrtojnë të gjitha vërejtjet e apostrofuara", ka theksuar Presidenti i Maqedonisë, Gjorgje Ivanov. Por, sipas ekspertëve të çështjeve juridike, mosdekretimi i ligjit vetëm se e shtyn implementimin e të njëjtit për një muaj, sepse i njëjti kthehet në parlament dhe pasi të marrë vizë për të dytën herë nga shumica parlamentare, atëherë presidenti i shtetit është i detyruar ta dekretojë. "Gjashtëdhjetenëntë deputetët, të cilët votuan pro ligjit të gjuhëve do të votojë sërish edhe pas një muaji. Por, në këtë kontekst, presidenti i shtetit duhet të tregohet më fleksibël ndaj kërkesave të shumicës parlamentare, mendoj shumicës që përfaqësojnë qytetarët e Maqedonisë dhe në përputhje më këtë edhe të sillet", thotë për radion "Evropa e Lirë", njohësi i çështjeve politike, Nikolla Dujovski. Ndërkohë, një deputet i VMRO-DPMNE-së, Ilija Dimovski ka ngritur në Gjykatën Kushtetuese një kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjit për gjuhët, duke kërkuar nga ky institucion të dalë me qëndrimin se ligji është antikushtetues, pasi sipas tij, në bazë të Kushtetutës, gjuhë e vetme zyrtare në Maqedoni është gjuha maqedonase dhe shkrimi i saj cirilik. Por, Mersim Maksuti, ligjërues i së Drejtës Kushtetuese në Universitetin e Tetovës, për radion "Evropa e Lirë" thotë se ligji i gjuhëve buron nga vetë Kushtetuta dhe si i tillë, në asnjë mënyrë nuk bie ndesh me të. "Është vetë Kushtetuta e Maqedonisë ajo, e cila e ka zyrtarizuar gjuhën shqipe, në kuptimin e asaj se e njeh si gjuhë zyrtare edhe se e definon si gjuhë që e flasin mbi 20 për qind e popullatës së Maqedonisë. Tani me ligjin e gjuhëve vetëm mundësohet zgjerimi apo shtrirja më e gjerë e përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe, por baza kushtetuese për gjuhën shqipe si gjuhë zyrtare ekziston". "Ata që synojnë të ngrenë iniciativë para Gjykatës Kushtetuese, duhet të kenë parasysh se bëhet fjalë për një ligj, që vendos themelet e bashkëjetesës mes dy bashkësive më të mëdha etnike në Maqedoni dhe institucionalizimi në një përmasë më të gjerë, në asnjë mënyrë nuk e rrezikon shtetin, përkundrazi përforcon karakterin demokratik të tij", thotë Maksuti. Përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe është formuluar si gjuhë të cilën e flasin mbi 20 për qind nga numri i përgjithshëm i popullatës në Maqedoni dhe përmes ligjit për përdorimin e gjuhëve mundësohet një shtrirje më e gjerë e përdorimit të gjuhës shqipe në institucionet e pushtetit vendor dhe atij qendror. Ligji në fjalë ishte edhe pjesë e marrëveshjes së partive politike shqiptare para formimit të qeverisë së re të Maqedonisë. Njëherësh, avancimi i gjuhës shqipe ishte edhe pjesë e premtimeve parazgjedhore të socialdemokratëve të kryeministrit Zoran Zaev, në sajë të të cilave arritën të siguronin një numër të konsiderueshëm të votave edhe nga elektorati shqiptar.



Presidenti i Maqedonisë, Gjeorgje Ivanov

**VENDIMI**

"Duke pasur parasysh vlerësimet e ekspertëve për okushtetutshmërinë e këtij ligji, kam sjellë vendimin që të mos e dekretoj", theksoi Ivanov në një dalje të tij para mediave. Ai tha se ka informuar Kuvendin lidhur me vendimin. Në letrën presidenti u shpreh se në mënyrë të detajuar ka arsyetuar vendimin dhe ka bërë thirrje që deputetët të shqyrtojnë sugjerimet e tij dhe më pas të veprojnë me përgjegjësi.

## Ministri i Shtetit, Majko takon arbëreshët: Lehtësira për diasporën

Për diasporën do të krijohen lehtësira, u shpreh min istri i Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko, në një takim me përfaqësuesit e Federatës së Shoqatave Arbëreshe. Gjatë takimit, Ministri Majko u njoh me problematikat që prekin komunitetin arbëresh dhe, gjithashtu, me propozime që do të ndihmonin në ruajtjen e gjuhës dhe traditave të trungut më të vjetër të diasporës shqiptare. Majko informoi përfaqësuesit e Federatës së Shoqatave Arbëreshe mbi hapat qe po ndërmerr ministri për krijimin e lehtësirave për diasporën. Ai premtoi të mbështesë iniciativat e komunitetit Arbëresh për ruajtjen dhe promovimin e gjuhës dhe traditave të tij. Gjithashtu dje, ministri i Shtetit për Diasporën priti në takim përfaqësuesit e organizatës joqeveritare 'Kosova për Sanxhakun". Grupi i kryesuar nga Ismet Azizi e falënderoi ministrin Majko për vëmendjen e kushtuar këtyre trevave, kulturës e traditës së tyre. Përfaqësuesit e organizatës e ftuan Majko të merrte pjesë në aktivitetet akademike e kulturore të organizuara prej tyre në të ardhmen e afërt. Ministri, nga ana e tij, u tregua i disponueshëm për t'u bërë pjesë e këtyre aktiviteteve.

**NJOFTIM SHITJE ME ANKAND**

**ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'**

Pasuria e paluajtshme nr. 7/244-N59, "Dyqan nr. 28", ndodhur në zonën kadastrale 8220, volum 19, faqe 19, regjistruar në Regjistrin Hipotekor nr. 1286 dt. 08.11.2010, me sipërfaqje 84 m2, në katin e parë Godinë Polifunksionale 3, 8 dhe 9 kat, me 2 kate parkim nëntokë, në pronësi të ARDIAN Ndre KIRI, me adresë: Rruga e Kavajës", Tiranë .

**ÇMIMI 56.448 EURO . Data e zhvillimit të ankandit do jetë 15.02.2018 .**

**CEL. 0684026666 ; 0693262866 .**

**KUVENDI**

Kuvendi i Maqedonisë më 11 janar miraton ligjin për përdorimin e gjuhëve të bashkësive etnike, përmes së cilit avancohet përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe në të gjitha organet e pushtetit qendror. Ligji u miratua me 69 vota dhe asnjë kundër. Në seancë nuk morën pjesë deputetët e opozitës maqedonase të udhëhequr nga VMRO-DPMNE, që këtë ligj e cilëson si antikushtetues.



Presidenti Ilir Meta

Presidenti, në aktivitetin për 550-vjetorit

## Viti i Skënderbeut, Meta: Reflektim dhe konsensus për negociatat me BE

Presidenti i Republikës, Ilir Meta, mori pjesë në eventin përmbyllës të 550-vjetorit të vdekjes së heroit tonë kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeut. Meta në fjalën e tij tha se "Festat e çdo gjë e jona ka në ballë figurën e tij". Kreu i shtetit, gjithashtu, bëri thirrje që ky vit i përkujtimit të tij të jetë një vit drejtë integrimit tonë si komb përmes një bashkëpunimi të singertë mes forcave politike. "Gëzimet, festat e çdo gjë e jona ka në ballë figurën e tij. Kujtesa e përjetshme e kombit tonë për kryeheroin tonë. Shkollat, akademitë, rrugët, dekoratat e çmimet janë përjetësim i Gjergj Kastriot Skënderbeut. Qëndresa e Skënderbeut solli mbijetesën tonë si komb. Ju arbëreshët e Skënderbeut, vëllezërit tanë arbëreshë që jeton në Kalabri e Sicili e deri në Argjentinë meritonin një nderim të veçantë. Ju e mbajtët të gjallë jetën dhe veprën e Gjergj Kastriotit",-tha Presidenti. "Ky vit i përkujtimit le të jetë një vit drejt integrimit tonë si vend, si komb, aty ku na e caktoi vendin heroi ynë në Europë, ylli polar i kombit tonë. Duhet të përforcojmë rrugën për çeljen e negociatave në qershor, kjo do të jetë e mundur përmes një bashkëpunimi mes të gjitha forcave"-deklaroi Meta. Në ceremoninë e organizuar nga presidenca ku ishin të pranishëm arbëreshët, Meta njoftoi se do të ketë disa aktivitete në Itali këtë vit.

Në prill nisin ndërhyrjet, Gjiknuri: Akset kryesore do të pajisen me ndriçim

# Rehabilitimi i rrugëve, Rama: Akset rrugore ku do kryhen punime

## "Janë 13 milionë për mirëmbajtjen e 1332 kilometrave"

Ornela Manjani

Kryeministri Edi Rama ka zhvilluar një takim me kompanitë e mirëmbajtjes në kuadër të krijimit të Flotës së Solidaritetit. Të pranishëm në këtë takim ishin edhe drejtori i Autoriteti Rrugor Shqiptar, Afrim Qendro si dhe ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, Damian Gjiknuri. Në fjalën e tij, kryeministri u shpreh se po fillon puna konkrete me financimin masiv, që është vënë në dispozicion të mirëmbajtjes së rrugëve. "Janë 13 milionë euro në vit që do të financojnë mirëmbajtjen e akseve kryesore në një total 1332 kilometra. Sa i takon pjesës tjetër, prej 2600 km do të mirëmbahen me një financim nga buxheti i shtetit prej 3.7 miliardë lekësh", u shpreh kryeministri. Ndërsa u shpreh se do të hapim një kapitull të ri për mirëmbajtjen e rrugëve, Rama shtoi se brenda këtyre katër viteve, akset rrugore do të bëhen të certifikueshme. Ai ka renditur edhe akset ku do të ndërhyhet për mirëmbajtjen, rikonstruksionin dhe ndërtimin e tyre, nisur nga vepra e artit në hyrje të Tiranës, për të vijuar më tej me 'Bypass'-in e Tepelenës dhe përfundimin e rrugës 'legjendare' Korçë-Ersekë, siç e ka cilësuar ai. Ndërkohë, kreu i qeverisë shtoi më tej se do të fillojë puna në Rrugën e Arbrit si dhe do të bëhet lidhja e kontratave për akset Thuman-Kashar dhe Balldren-Milot në pjesën e parë të vitit. Sa i takon aksit Kashar-Rrogozhinë, Rama tha se fillimi i punës do të nisë brenda vitit dhe do të ndërtohet me një skemë financimi me pagesë. Ndërkohë, pritet të fillojë puna edhe në aksin rrugor Rrogozhinë-Fier dhe në 'Bypass'-in e Fierit dhe Vlorës, që sipas Ramës është shumë afër zgjidhjes. Ndërkohë, për aksin rrugor Kashar-Durrës, Rama nënvizoi se: "Në pranverë njerëzit do të shohin që shumë nga ato pjesë të rrugës Kashar- Durrës, që është një problem më vete, do të përmirësohen ndjeshëm me një mirëmbajtje të standardeve europiane". Flotës së Solidaritetit do t'i bashkëngjiten edhe 58 kompani të tjera që operojnë në të gjithë territorin.


Kryeministri Edi Rama

**KRYEMINISTRI**

"Do të fillojë puna në Rrugën e Arbrit si dhe do të bëhet lidhja e kontratave për akset Thuman-Kashar dhe Balldren-Milot në pjesën e parë të vitit. Sa i takon aksit Kashar-Rrogo-zhinë. Fillimi i punës do të nisë brenda vitit dhe do të ndërtohet me një skemë financimi me pagesë".

**MIREMBAJTJA**

"Në pranverë njerëzit do të shohin që shumë nga ato pjesë të rrugës Kashar-Durrës, që është një problem më vete, do të përmirësohen ndjeshëm me një mirëmbajtje të standardeve europiane". Flotës së Solidaritetit do t'i bashkëngjiten edhe 58 kompani të tjera që operojnë në të gjithë territorin.

### MIRËMBAJTJA

Mirëmbajtja e rrugëve ka qenë kryefjala e takimit për krijimin e Flotës së Solidaritetit. Kompanitë e kontraktuara për mirëmbajtjen e rrugëve në bashkëpunim me autoritetet do të angazhohen në reagimin e shpejtë për të garantuar kalueshmërinë e akseve kombëtare, kur kushtet e motit janë të rënduara. Duke folur për investimet që rrisin sigurinë rrugore, ministri i Infrastrukturës, Damian Gjiknuri, lajmëroi se në muajt në vijim do të nisë rehabilitimi i rrugëve duke shtuar se Shqipëria do të rrisë stokun e rrugëve dhe kjo kërkon volume më të mëdha të mirëmbajtjes. "Duke filluar nga muaji prill do të kemi ndërhyrje masive për t'i sjellë rrugët në nivelet e duhura të sigurisë. Fazë e parë e këtij procesi ishte pastrimi i tabelave nga akset rrugore. Duhet të bëjmë ndërhyrje që këto akse kryesore dhe këto nyje ku ka zona të banuara të jenë të ndriçuara. Po mendojmë për shfrytëzimin e energjive të rinovueshme. Këto janë kosto që do të përfshihen në mirëmbajtje, por janë kosto të përballueshme dhe jashtëzakonisht të nevojshme për procesin e sigurisë në rrugë", tha Gjiknuri. Shembull i këtyre ndërhyrjeve është aksi Plepa-Rrogozhinë, për të cilin ndriçimi i rrugëve pritet të realizohet brenda 45 ditëve. Sipas Gjiknurit, sektori i mirëmbajtjes së rrugëve është një nga elementët jashtëzakonisht të domosdoshëm më të neglizhuar ndonjëherë. Përgjegjësi për këtë neglizhencë, sipas ministrit, kanë edhe bashkitë. "Ne do të ndryshojmë ligjin, që disa nga këto akse të ketë mundësi t'i marrë në dorë edhe qeveria. Por edhe bashkive do u shikohet pjesa buxhetore, pasi nuk mund të lihen pa investime. Bëhet fjalë jo për rrugët nacionale, por për rrugë të tjera me rëndësi nga pikëpamja kombëtare", u shpreh ministri. Gjiknuri paralajmëroi edhe ndryshime në sistemin e mirëmbajtjes së rrugëve, proces i cili do të vazhdojë sipas modelit të Bankës Botërore, por do të rishikohet supervizori i mirëmbajtjes, i cili të mos jetë më vetëm një për të gjithë vendin, por të ndahet në bazë të rajoneve.

**AEROPORTI**



### MIE: Tre operatorë dorëzojnë ofertën për ta ndërtuar në zonën e Akërnisë

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bëri me dije dje se një konsorcium me tri kompani në përbërje të tij ka dorëzuar një ofertë për ndërtimin e aeroportit të Vlorës. Sipas njoftimit, tashmë do të vijohet me fazën e radhës së vlerësimit nga ana e dy ministrive, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ajo për Financat dhe Ekonominë. Në njoftimin zyrtar, ministria bën me dije se kompanitë kanë marrë përsipër të bëjnë investimin me fondet e tyre dhe jo përmes buxhetit të shtetit. Aeroporti i Vlorës është cilësuar si një nga projektet më të rëndësishme në sektorin e transportit ajror. Ai është lidhur direkt si një projekt me ndikim në turizëm dhe zhvillimin e rajonit në jug të vendit. "Në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë është paraqitur shprehja e interesit për projektin e aeroportit të Vlorës. Sipas propozimit, aeroporti mendohet të ndërtohet në zonën e Akërnisë. Oferta është paraqitur nga një konsorcium i tri kompanive ndër më seriozet, të cilat janë 'Cengiz Construction', 'Kalyon Construction' dhe 'Kolin Construction'. Me marrjen e ofertës, do të ngrihet një grup i posaçëm me përfaqësues nga MIE dhe MFE, që do të shqyrtojnë aspektet teknike të propozimit dhe do të ndjekë hapat e mëtejshëm në përputhje me përcaktimet ligjore", - thuhet në njoftimin e ministrisë.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**BANKA E SHQIPERISE**
**DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT**
**SEKTORI I PROKURIMIT**

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemit 'Autoclear' të mbrojtjes elektronike në objektet dhe degët e Bankës se Shqipërisë"**

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 1,500,000 Lekë"**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkese me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:
Përfituesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemit 'Autoclear' të mbrojtjes elektronike në objektet dhe degët e Bankës se Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 20 Shkurt 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**BANKA E SHQIPERISE**
**DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT**
**SEKTORI I PROKURIMIT**

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje e një pajisje pirun elektrik, për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**.

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 1,970,000 Lekë"**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkese me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje e një pajisje pirun elektrik, për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 09 Shkurt 2018, ora 09:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

### Mbyllet kompania ARMO, qeveria në kërkim të një investitori të ri për rihapjene rafinerisë

# Ahmetaj: Pagesë papunësie për të gjithë naftëtarët

## *Ngelen në rrugë 1200 punëtorë, ministri: Aplikoni si të papunë*

Ornela Manjani

Rafineria e vetme e përpunimit të naftës në Shqipëri, ARMO, është mbyllur. 1200 punëtorë të uzinës së Fierit dhe Ballshit janë të papunë, ndërsa grupi investitor "IRTC Oil" është larguar. Në një konferencë për shtyp, ministri i Financave, Arben Ahmetaj tha se qeveria ka miratuar një vendim për të përshpejtuar procedurat e dhënies së pagesës së papunësisë për të gjithë naftëtarët. "Është marrë angazhim nga qeveria që zyra e punës në qarkun e Fierit të jenë në ndihmë të punonjësve të dy rafinerive për t'i ndihmuar për aplikimin e statusit të papunësisë, në mënyrë që ata punonjës që sot janë papunë të përfitojnë menjëherë në bazë të ligjit pagesën e papunësisë", - tha Amhetaj. Ai kërkoi të qetësojë naftëtarët e mbetur pa punë dhe premtoi se qeveria është në kërkim dhe pritje të çdo oferte që vjen nga një grup investitor serioz, për të rivënë në punë rafinerinë. "Jemi në kërkim dhe në pritje të çdo investitori serioz për të vënë në punë ARMO-n", - deklaroi ministri i Financave dhe Ekonomisë.

**ARMO**

Kompania ARMO është rivënë në punë në shtator të vitit 2016-të nga një firmë amerikane e regjistruar në ishujt britanikë Virxhin në bashkëpunim me një firmë shqiptare. Investitori premtoi se do të rikthejë shkëlqimin e dikurshëm të rafinerisë, por burime zyrtare thonë se deri në fund të vitit 2017-të borxhet në tatime e dogana vetëm gjatë një viti kanë arritur vlerën e 60 milionë dollarëve.

**PROTESTAT**

Takimi i fundit mes naftëtarëve ishte në fund të vitit të shkuar. Ministrat Gjiknuri dhe Ahmetaj theksuan në takim faktin se rafineria është tanimë një ndërmarrje në pronësi e përgjegjësi private e për pasojë është detyrim ligjor dhe kontraktual i punëdhënësit privat të respektojë të gjitha detyrimet sipas legjislacionit në fuqi. Ndërkohë, premtuan se institucionet shtetërore, duke marrë parasysh problematikën e parashtruar nga qytetarët e Bashkisë së Ballshit, por edhe shqetësimet e bëra publike nga Sindikata e Naftëtarëve, janë angazhuar me seriozitet të plotë dhe në mënyrë të vazhdueshme që nga njëra anë punëdhënësi privat të plotësojë të gjitha detyrimet kontraktuale ndaj punonjësve dhe nga ana tjetër të drejtat e punonjësve të garantohen sipas ligjit. Në lidhje me 'Statusin e naftëtarit', përfaqësia e punonjësve të rafinerisë së naftës në Ballsh do të punojë ngushtësisht me grupin e punës të ngritur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për të përmbyllur në një kohë sa më të shpejtë aplikimet ligjore për përfitimin e statusit.


Ministri i Financave, Arben Ahmetaj

**AHMETAJ**
"Është marrë angazhim nga qeveria që zyra e punës në qarkun e Fierit të jenë në ndihmë të punonjësve të dy rafinerive për t'i ndihmuar për aplikimin e statusit të papunësisë, në mënyrë që ata punonjës që sot janë papunë të përfitojnë menjëherë në bazë të ligjit pagesën e papunësisë".

### Falimenti i ARMOS, Preçi: Publikoni bilancet

Pas njoftimit të ministrit të Financave për shpalljen e falimentit për kompaninë ARMO, reagon një prej ekspertëve të ekonomisë, Zef Preçi. "ARMO, falimentimi i një kompanie strategjike në të cilën qeveria zotëron 15% të aksioneve. Në botën e sotme kompani të tilla shtetëzohen dhe pasuritë natyrore përdoren për të përshpejtuar zhvillimin ekonomik e shoqëror të vendit", - shkruan në 'FB' Preçi. "Publikoni bilancin e kompanisë ARMO të dekadës së fundit, duke përfshirë edhe



2016-2017 dhe konfirmoni se qeveria zotëron 15% të aksioneve me këtë kompani dhe ndoshta lajmi për falimentimin mund të përkthehet ndryshe. Të paktën për miliona tonë nafte bruto që ka pasuruar klientët e qeverisë së radhës, ka rrënuar bankat dhe të ardhurat buxhetore, si dhe ka shkatërruar qindra-mijëra makina nga shitja e naftës me squfur në tregun e brendshëm. Një model, siç nuk duhen qeverisur pasuritë strategjike, pronë formalisht e qytetarëve shqiptarë. Ndërsa punëtorët qetësisht 'këshillohen' të shkojnë drejt zyrave të ndihmës ekonomike, drejt mjerimit. Dhimbje dhe keqardhje bashkë", - shkruan Preçi.


Deputetja Jorida Tabaku

### Kompensimi i të përndjekurve, reagimi i PD për ndërprerjen

Partia Demokratike deklaron se qeveria ngriu fondin e dëmshpërblimit të ish-të përndjekurve politikë, me qëllim përjashtimin e 13 mijë familjeve që ligji ua njeh këtë të drejtë. Deputetja Jorida Tabaku tha se qeveria po shkon drejt një hapi të tillë jo se nuk ka para, por se nuk ka vullnet. "Qeveria ka para, sepse këtë vit do të paguajë 2.5 milionë euro për palmat e autostradës. Qeveria ka para, sepse vetëm për koncesionin e dështuar të 'check up'-it në shëndetësi do të paguajë këtë vit 5 milionë euro", u shpreh ajo. Partia Demokratike qeverisi për 8 vite, por nuk shleu detyrimin financiar ndaj të përndjekurve. Kjo sipas Tabakut ndodhi sepse PD vendosi dëmshpërblimin më të madh të mundshëm për ta, ndërsa qeveria "Rama", sipas saj, uli me 3.2 mld lekë fondin për kompensimin. "Nga viti 2009 deri në vitin 2013, me 9.3 miliardë lekë u dëmshpërblyen mbi 62 mijë ish-të persekutuar dhe familjarë të tyre. Pas vitit 2013, qeveria ka dëmshpërblyer financiarisht 43 mijë të përndjekur më pak", deklaroi Tabaku. Ishte ministri Arben Ahmetaj, që paralajmëroi se pas dëmshpërblimit të plotë për ish-të përndjekurit politikë që ende jetojnë, qeveria mund të anulojë kompensimet për trashëgimtarët, veçanërisht përtej brezit të parë.

---

### Guvernatori i Bankës së Shqipërisë merr pjesë në forumin "Euromoney"

# Sejko: Shqipëria ka avantazhe për të qenë destinacion për investim

Perspektiva pozitive e rritjes ekonomike, avantazhet konkurruese që ofron Shqipëria në terma të pasurive natyrore, të pozicionit të favorshëm gjeografik, si dhe stabilitetin në rritje që ofron procesi i anëtarësimit në Bashkimin Evropian, e shndërron Shqipërinë në një destinacion të përshtatshëm biznesi dhe investimi. Ky ka qenë një ndër mesazhet kryesore që guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko, ka përcjellë gjatë forumit të "Euromoney". Në datat 16-17 janar 2018, "Euromoney" organizoi forumin për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore në Vjenë. Ky forum zhvillohet çdo vit dhe mbledh në një tryezë të përbashkët diskutimi personalitete të njohura ndërkombëtare nga fusha politike, ekonomike e financiare nga vendet e EQL-së. Punimet e këtij forumi dyditor ishin konceptuar në formën e paneleve me tema specifike, ku të pranishmit ishin të ftuar të diskutonin mbi zhvillimet më të fundit ekonomike në vendet e Evropës dhe më gjerë. Një rëndësi të veçantë në këtë organizim kishin paneli i dedikuar Shqipërisë dhe ai i bankave qendrore. Pjesë e tryezës së dedikuar vendit tonë ishin guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Sejko; zëvendësministri i Financave dhe i Ekonomisë, Erjon Luçi; drejtori i përgjithshëm i Bankës Kombëtare Tregtare, Seyhan Pencabligil dhe drejtorja e përgjithshme e Finance in Motion, Elvira Lefting. Ky panel trajtoi tema të rëndësishme të lidhura me politikën fiskale dhe ndikimin e saj në rritjen ekonomike të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore. Gjatë zhvillimit të panelit në fjalë, guvernatori Sejko bëri një panoramë të zhvillimeve më të fundit ekonomike dhe financiare në vend, si dhe i njohu të pranishmit me sfidat kryesore me të cilat përballet ekonomia shqiptare, në kuadrin e politikave makroekonomike dhe reformave strukturore të nevojshme për të nxitur rritjen ekonomike dhe përmirësimin e klimës së biznesit, për tërheqjen e investime të huaja në Shqipëri. Në ndërhyrjen e tij, guvernatori Sejko vuri në dukje tri mesazhe kryesore. Së pari, ekonomia shqiptare po forcohet dhe perspektivat e saj të rritjes janë pozitive, kjo edhe në sajë të kuadrit të kujdesshëm të politikave makroekonomike dhe të angazhimit serioz të autoriteteve për vazhdimin e reformave strukturore. Së dyti, ai theksoi se sistemi financiar shqiptar është i shëndetshëm dhe parametrat kryesorë të operimit të tij janë drejt përmirësimit. Megjithatë, ky sistem duhet të jetë më realist e largpamës në nxitjen e kreditimit dhe më ambicioz në zhvillimin e segmenteve të reja të tregut financiar. Së fundi, duke theksuar perspektivën pozitive të rritjes ekonomike, duke evidentuar avantazhet konkurruese që ofron Shqipëria në terma të pasurive natyrore, të pozicionit të favorshëm gjeografik, si dhe stabilitetin në rritje që ofron procesi i anëtarësimit në Bashkimin Evropian, guvernatori Sejko u bëri thirrje të pranishmëve të rritnin vëmendjen e tyre ndaj Shqipërisë si një destinacion i përshtatshëm biznesi dhe investimi.


Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko, gjatë forumit të "Euromoney"

GRABITJA E BANKES
DESHMIA

Policia në kërkim të të riut që bastisi bankën dhe vodhi 500 mijë lekë

# Grabitja te Hipoteka, polici privat: Me kapi ne befasi dhe me kërcënoi

## "Agresori ishte gati të më vriste"

TIRANE

Një ditë pas arrestimit, polici privat, i cili u akuzua për shpërdorim detyre, gjatë grabitjes së bankës së nivelit të dytë brenda Hipotekës së Tiranës, ka dhënë dëshminë e tij përpara uniformave blu. 48-vjeçari F.F. nuk ka mundur të neutralizojë ditën e grabitjes, autorin e armatosur dhe të maskuar që mundi të vjedhë 500 mijë lekë nga banka. Në lidhje me këtë ngjarje, F.F. dëshmoi se e ka pasur të pamundur të ndalojë agresorin. "E kisha të pamundur të veproja për ta kapur. Ai më kapi në befasi dhe më kërcënoi që të mos lëvizja, në të kundërt do të më vriste. E kisha të pamundur të lajmëroja edhe operatorin e qendrës apo policinë",- mësohet të jetë shprehur 48-vjeçari. Policia ka referuar materialet në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, edhe për shtetasin R.K.. 61-vjeçari, i cili është përgjegjësi i sigurisë së sallës operative të kompanisë private, po procedohet penalisht në gjendje të lirë nga policia.

**DËSHMIA**
"E kisha të pamundur të veproja për ta kapur. Ai më kapi në befasi dhe më kërcënoi që të mos lëvizja, në të kundërt do të më vriste. E kisha të pamundur të lajmëroja edhe operatorin e qendrës apo policinë", - mësohet të jetë shprehur polici privat.



Vendi ku ndodhi grabitja

**NGJARJA**

Një grabitje me armë zjarri ndodhi mesditën e së hënës në orën 14:00 në një bankë të nivelit të dytë brenda ambienteve të Hipotekës në kryeqytet. Një person i maskuar dhe nën kërcënimin e pistoletës mori paratë e arkës. Sipas burimeve grabitësi ka pasur edhe një bashkëpunëtor, i cili po e priste jashtë godinës. Autori i ngjarjes, i cili dyshohet të jetë një i ri rreth moshës 25 vjeç, ka përdorur një kapele në kokë për të fshehur identitetin. Mësohet se në brez ka pasur një armë zjarri tip pistoletë. Në momentin kur ka hyrë në ambientet e bankës, bëhet me dije se grabitësi nën kërcënimin e pistoletës, fillimisht kanosi policin privat duke e mënjanuar te muri dhe më pas i ka kërkuar punonjësve të bankës të mos lëvizin nga vendi. Më pas ai i është drejtuar sportelit të bankës private ku u ka drejtuar armën arkëtareve. Mësohet se autori i grabitjes ka kanosur me armë arkëtaren duke i kërkuar lekët se përndryshe do ta vriste. Arkëtarja për disa sekonda ka hezituar dhe nuk ka bërë asnjë veprim. Në këtë moment grabitësi me qytën e armës ka qëlluar xhamin e bankës, i cili ka pësuar plasaritje. E trembur arkëtarja ka hapur kasafortën e arkës dhe i ka futur në një qese të zezë mbeturinash të gjitha paratë. Nga aty dyshohet se ai ka marrë xhiron ditore, një shumë prej rreth 500 mijë lekësh. Pas krimit grabitësi u largua në drejtim të bllokut të pallateve pranë rrugës "Don Bosko", ku është ndeshur me një punonjës policie, të cilit i ka drejtuar pistoletën dhe i ka kërkuar të mos e ndjekë pasi përndryshe do ta qëllonte. Autori ka qenë i veshur me të zeza dhe mban në kokë një kapuç dhe një kapele me strehë. Policia ka shtrirë kërkimet e saj në këtë zonë, ndërsa janë marrë edhe pamje të kamerave të sigurisë në disa drejtime. Dyshohet se autori e kishte planifikuar gjithçka deri në detaj dhe ishte profesionist, pasi grabitjen e ka kryer për rreth një minutë. Gjithashtu, ka dyshime se grabitësi është ndihmuar edhe nga një tjetër person për t'u larguar me makinë. Autori mendohet se i ka dhënë çantën me para personit tjetër, ndërsa fshihet në një banesë në zonën e 'Don Boskës'. Sakaq bëhet me dije se forcat policore janë njoftuar nga alarmi i bankës sapo grabitësi është futur, por nuk mundën ta arrestojnë në flagrancë. Blutë janë vendosur prej mesditës së hënë në kërkim të tij, por ende nuk është bërë i mundur arrestimi i të riut.

SHKURT

### Tiranë, dhunohet nga 3 persona shefi i regjimit të Burgut 313

TIRANË- Një ngjarje e rëndë është regjistruar mëngjesin e djeshëm në kryeqytet, ku pre e dhunës ka rënë shefi i regjimit të Burgut 313, Bledar Pura. Persona të paidentifikuar mësohet se kanë dhunuar Purën duke e goditur me sende të forta disa herë në zonën e Freskut, rreth orës 06:30. Shefi i regjimit të burgut është dërguar në spitalin e Traumës për mjekim, ndërsa raportohet se ndodhet jashtë rrezikut për jetën. 36-vjeçari nuk ka dëmtime serioze, ndërsa ka dëshmuar para grupit hetimor se kanë qenë disa persona që e kanë dhunuar me sende të forta. Nga të dhënat e para mësohet se ngjarja ka lidhje me detyrën, ndërsa policia vijon hetimet për të identifikuar dhe arrestuar autorët.

### Ndihmoi Alket Rizain të arratisej, ekzekutohet mafiozi grek

Mafiozi grek Vassilis Stefanakos u vra dje pas orës 7 në Athinon Avenue në periferi të lagjes 'Haidari' të Athinës Perëndimore. Sipas informacioneve paraprake, po e ngiste makinën e tij kur dy persona në një moto iu afruan dhe e vranë atë në vend. Autorët thuhet se kanë përdorur një armë "Kallashnikov" dhe kanë gjuajtur 22 plumba. Pas nëntë vjet burg, Stefanakos u lirua në verën e vitit 2016. Në vitin 2007, ai kishte tentuar të kishte një ID të ri të lëshuar me ndihmën e dy policëve. Ai u arrestua në janar 2008 pranë shtëpisë së tij në 'Haidari' dhe u dënua me 21 vjet e tre muaj burgim si për vrasjen e një mafiozi tjetër grek, si dhe për arratisjen e burgut të dy kriminelëve, Alket Rizai shqiptar dhe Vassilis Palaiokostas nga burgu i Koridhalos.


NJOFTIM ANKANDI

**Përmbarues gjyqësor privat Artan Sima** zhvillon ankandet sipas datave të mëposhtme:
1) **Datë 25/01/2018**, ditën e Enjte, ora 16:00, përfundon ankandi i ri (i parë), për shitjen e pasurive të paluajtshme të llojit:
-**"Arë"** me sip. 2506 $m^2$, e ndodhur në fshatin Vashtmi Korçë, në vlerën **300,720 lekë.**
-**"Arë"** me sip. 1216 $m^2$, e ndodhur në fshatin Vashtmi Korçë, në vlerën **145,920 lekë.**
-**"Arë"** me sip. 1080 $m^2$, e ndodhur në fshatin Vashtmi Korçë, në vlerën **173,520 lekë.**
-**"Truall+arë"** me sip. 352 $m^2$, nga kjo truall 200 $m^2$, si dhe ndërtesë prej 80 $m^2$, e ndodhur në fshatin Vashtmi Korçë, në vlerën **2,080,720 lekë.**
Pasuritë janë lenë garanci bankare nga debitori Trashëgimtarëve të të ndjerit/Debitor z.Algent Minir Panajoti, znj.Manjola Rexhep,Panajoti, znj.Sara Algent Panajoti, z.Glediol Algent Panajoti banues në fshatin Vashtemi, bashkia Maliq, rrethi Korçë, për detyrimin ndaj kreditorit Fondi Besa Sh.a, me seli në ish Blloku Tiranë.
2) **Datë 25/01/2018**, ditën e Enjte, ora 16:00, përfundon ankandi i ri (i parë), për shitjen e pasurive të paluajtshme të llojit:
-**"Arë"** me sip. 1489 $m^2$, e ndodhur në fshatin Zagfradec Devoll, në vlerën **124,900 lekë.**
-**"Arë"** me sip.1489 $m^2$, e ndodhur në fshatin Zagfradec Devoll, në vlerën **153,600 lekë.**
Pasuritë janë lenë garanci bankare nga debitori Trashëgimtarëve të të ndjerit/Debitor z.Xhevair Zama dhe Nexhmije Zama, z.Aurel Zama, z.Sokol Zama, z.Melsi Zama, banues në fshatin Zagradec, bashkia Devoll, për detyrimin ndaj kreditorit Fondi Besa Sh.a, me seli në ish Blloku Tiranë.
3)**Datë 8/02/2018**, ditën e Hënë, ora 16:00, përfundon ankandi i ri **(i dytë)**, për shitjen e pasurisë së paluajtshme të llojit **"Arë"** me sip. 4,312 $m^2$, e ndodhur në Lasaj, Dibër, në vlerën **434.649 lekë**. Pasuria është lenë garanci bankare nga debitorët trashëgimtarë znj.Nafie Bitri, z.Elda Shquti (Bitri), z.Shkëlqim Bitri, znj.Merita Toci (Bitri), znj. Fitore Lala (Bitri), znj.Vjollca Vasilef (Bitri), znj Elvira Bitri banuese në fshatin Fushë-Cidhen, Rrethi Dibër.
4)**Datë 8/02/2018**, ditën e Hënë, ora 16:00, përfundon ankandi i ri **(i tretë)**, për shitjen e pasurisë së paluajtshme të llojit **"Truall"** me sip. 190 $m^2$, nga kjo ndërtesë 81 $m^2$, e ndodhur në fshatin Koshnice-Devoll në vlerën **252.000 lekë**. Pasuria është lenë garanci bankare nga (debitorët/hipotekues) z Ylli Islam Palla dhe znj.Lule Osman Palla, banues në fshatin Koshnice, Devoll, për detyrimin ndaj kreditorit Fondi Besa Sh.a,me seli në ish Blloku Tiranë.
5)**Datë 8/02/2018**, ditën e Hënë, ora 16:00, përfundon ankandi i ri **(i dytë)**, për shitjen e pasurisë së paluajtshme të llojit **"Arë"** me sip. 1,000 $m^2$, truall 190 $m^2$, nga kjo ndërtesë 81 $m^2$ e ndodhur në fshatin Zdojan , Dibër në vlerën **112.000 lekë**. Pasuria është lenë garanci bankare nga (debitorët/hipotekues) z. Bedri Allaman Tuka, banues në fshatin Zdojan-Brezhan, bashkia Dibër, rrethi Dibër, për detyrimin ndaj kreditorit Fondi Besa Sh.a, me seli në ish Blloku Tiranë.
Ankandet zhvillohet pranë zyrës së përmbaruesit me seli lagjen nr.3, Rruga «Avni Rustemi», nr.31 .k,1. Korçë. Kontakt Cel.0674044666, e-mail. simaartan@yahoo.com


### I pandehuri në kërkim ndërkombëtar nga Interpol Tirana

## Nën akuzë për vepra të rënda penale, hapet procesi gjyqësor për Domart Konjarin


Domart Konjari

Gjykata për Krimet e Rënda hapi ditën e djeshme procesin gjyqësor ndaj Domart Konjarit, i njohur si miku i Franc Konomit. Konjari akuzohet për disa vepra të rënda penale të kryera në Francë, mes të cilave "trafik i narkotikëve", "organizatë kriminale" dhe "pastrim parash". Mbrojtja kërkoi transferimin e procedimit penal të Konjarit në Francë, por kjo kërkesë u refuzua nga gjykata. Gjykimi ndaj Domart Konjarit po bëhet në mungesë, kjo për faktin se i pandehuri u arratis pak pasi Apeli për Krimet e Rënda zbuti masën e sigurisë "arrest në burg" në "detyrim për paraqitje". Domart Konjari është shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Interpol Tirana. Ai akuzohet si drejtues i një grupi të trafikut të drogës në Francë. Prej dhjetorit 2016 ndaj tij është në fuqi masa e sigurisë "arrest me burg", për llogari të hetimeve të nisura nga prokuroria shqiptare pas kërkesës së autoriteteve franceze. Sipas organit të akuzës, Konjari është i përfshirë në trafikun e kokainës dhe heroinës nga Amerika Latine në Europë e kryesisht në Francë. Konjari mendohet se ka lidhje direkte me burimin në Amerikën e Jugut. Ai dyshohet se drejtonte rrjetin e trafikut të kokainës në disa shtete të Europës Qendrore.

Policia, dyshime se atentatorët janë vrasës me pagesë: Nuk kanë lënë asnjë gjurmë

# Vrasja e Emiljano Boçit, flet i mbijetuari: S'kam dijeni kush mund të jenë autorët

## Disha: Na qëlluan sapo u futëm në makinë

Ina Allkanjari

**TIRANE**

Kanë kaluar 5 ditë nga ngjarja tragjike e ndodhur në rrugën "Shefqet Musaraj" në kryeqytet, ku humbi jetën 32-vjeçari Emiljano Boçi, por ende mbeten të panjohur autorët e atentatit. Natën e sulmit, Boçi ishte i shoqëruar me një vajzë dhe me shokun e tij Melvi Disha, i cili mbeti i plagosur. Vetëm 4 ditë pas atentatit ku u plagos me një plumb në shpatull, 27-vjeçari Disha ka mundur të japë dëshminë e tij para uniformave blu, në ambientet e spitalit të Traumës, aty ku dhe po merr mjekim. Ai pohoi se nuk i ka parë autorët dhe nuk ka dijeni se kush mund të jenë. "Ishim duke darkuar në një restorant afër. U afruam drejt makinës dhe nuk pamë asgjë të pazakontë. Unë u ula në sediljen e pasme, mbrapa shoferit. Sapo u futëm në makinë na qëlluan nga pas. Kur plumbat më prekën në shpatull u shtriva poshtë sediljeve dhe qëndrova pa lëvizur për shumë minuta. Jam ngritur vetëm pasi gjithçka mbaroi. Nuk kam mundur të shquaj autorët dhe nuk kam asnjë dyshim se kush mund të jenë", - ka dëshmuar ai në polici. Policia nuk ka ende një version zyrtar për ngjarjen, por nisur nga fakti që autorët nuk kanë lënë asnjë gjurmë në vendngjarje, dyshohet se atentati mund të jetë kryer nga vrasës me pagesë. Pistat që policia po heton janë konfliktet në të shkuarën e 32-vjeçarit, ku Boçi ka qenë i dënuar për plagosje si dhe pazaret e drogës ku mund të ketë qenë i përfshirë. Emiljano Boçi lëvizte vazhdimisht në Holandë dhe Gjermani ku mendohet se merrej me trafik të lëndëve narkotike.


Melvi Disha

**DËSHMIA**

"Ishim duke darkuar në një restorant afër. U afruam drejt makinës dhe nuk pamë asgjë të pazakontë. Unë u ula në sediljen e pasme, mbrapa shoferit. Sapo u futëm në makinë na qëlluan nga pas. Kur plumbat më prekën në shpatull u shtriva poshtë sedileve dhe qëndrova pa lëvizur për shumë minuta. Jam ngritur vetëm pasi gjithçka mbaroi. Nuk kam mundur të shquaj autorët dhe nuk kam asnjë dyshim se kush mund të jenë", - ka dëshmuar Melvi Disha në polici.

**NGJARJA**

32-vjeçari, Emiljano Boçi u ekzekutua me dy plumba në kokë rreth orës 17:50 të ditës së diel, në rrugën "Shefqet Musaraj", brenda në automjetin e tij. Mësohet se atentati ndodhi pranë banesës së Boçit dhe mendohet se ka më shumë se një autor, të cilët ende nuk janë identifikuar. Menjëherë pasi doli nga një restorant në kryeqytet, 32-vjeçari iu drejtuar automjetit "Range Rover" i shoqëruar nga miku i tij Melvi Disha, 27-vjeç, i cili mbeti i plagosur dhe një vajzë identiteti i së cilës nuk bëhet i ditur. Mësohet se autori ka qëlluar nga pjesa e pasme e makinës "Range Rover" në drejtim të vendit të shoferit çka tregon se objektivi ka qenë pikërisht viktima. Vajza, e cila ndodhej brenda në automjet i ka shpëtuar mrekullisht plumbave të këtij atentati, ndërsa mësohet se ka qenë ajo e cila ka njoftuar forcat e policisë. Menjëherë pas krimit, sipas dëshmisë së vajzës, autorët u larguan nëpërmjet pallateve të lagjes, "Sheqet Musaraj". Banorët përreth nuk kanë dëgjuar të shtëna, çka shton dyshimet se atentatori ka përdorur armë me silenciator. Ndërkohë në vendngjarje policia ka gjetur 4 gëzhoja. Sakaq bëhet me dije se uniformat blu kanë sekuestruar pamjet e sigurisë të disa bizneseve dhe dyshohet se ngjarja u fiksua nga një prej kamerave të sigurisë. Shërbimet e policisë po punojnë për sqarimin e plotë të rrethanave të ngjarjes dhe identifikimin dhe kapjen e autorit/ve.


bashkëpunimi gjerman
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT
Implemented by giz

**PROJECT "COUNTERING SERIOUS CRIME IN THE WESTERN BALKANS"**

The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ) is a federal enterprise that supports the German Government in achieving its objectives in the field of international cooperation for sustainable development. The project is composed of 4 areas of intervention with the overall objective to counter Serious Crime in the Western Balkans. The technical expertise will be provided by EU Prosecutors and Legal Advisors.

**GIZ Office Albania seeks the following staff: Finance/ administrative support**

**A. Responsibilities**

The position holder is responsible for:
■ **Permanent interaction with the ECT/Focal Point for the ECT** (EU Prosecutor and Legal Advsior)
■Provide administrative **support to the EU Prosecutor** in the implementation of area I and IV of the Action;
■ Provide administrative **support to the Legal Advisor** in the implementation of area II and III of the Action;
■ Provide administrative **support to the Sub Project Manager** "ORF South East Europe - Legal Reform";

**In this context, the position holder fulfils the following tasks:**
**B. Tasks**

**1. Core scope of tasks**
■ Ensures the strict application of the GIZ O+R;
■ Manages the daily accounting and manage both the Cash-book and Bank-book;
■ Maintains and administers the GIZ financial systems within the project in accordance with the guidance of the Head of Finance and Administration Officer, GIZ HQ book-keeping and financial controller;
■ Efficient processes of all local payments in compliance with GIZ and EU procedures and daily invoice checking, processing and record keeping;
■ Liaisons with the GIZ HQ in the country in relation to booking costs and checking invoices;
■ Ensures detailed financial records are kept in the formats needed for GIZ internal controlling, internal audits and for EU audits;
■ Monitors and regular reports on the spent and planned resources;
■ Communicates with partners of the project;
■ Organises events, meetings, conference and trips with the region and to the EU

**2. Other duties/additional tasks**
The position holder
■ Has regular contact to the other project offices in the region;
■Participates in Team Meetings outside the country
■ Is capable to work in a sensitive environment

**C. Required qualifications, competencies and experience**

■ Bachelor's degree in economics/business
■ At least 3 years of previous experience in accounting preferably in the context of EU-funded projects
■ Organisational skills, experience with organizing events, meetings, conference and trips
■ Proficient IT skills (in particular: Word, Excel, SAP)
■ Personal and interpersonal skills, including excellent team-working and communication skills.
■ Attention to detail and accuracy, in particular in relation to accounting or budget monitoring
■ Customer and service-oriented attitude, fast-learner and willingness to be flexible and prepared to contribute to the company in other duties as required.
■ Experience with the Legal Sector/Politics and or International Cooperation will be considered as a significant advantage

***Contract conditions***
■ Full-time employment
■ Project office in Tirana
■ Duration: 2 years

Please forward your application until **28th of January 2018**, to GIZ Office Albania by E-Mail: **giz-albanien-hr@giz.de** , including the following information: Application letter, CV in English (Euro Pass format), references.

Only short-listed candidates will be contacted for interviews. They might be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates.

***GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!***


### Policia: Murati i dyshuar për vrasje me paramendim

# Zhdukja e Artan Lleshit, zbardhet dëshmia e Altin Muratit: Nuk kam gisht në krimin e rëndë

"Artan Lleshin e njoh, se kam punuar me të në Amaliadha të Greqisë. S'kam kurrfarë dijenie për vendndodhjen e tij dhe as se çfarë mund t'i ketë ndodhur". Kështu mësohet të ketë dëshmuar përpara uniformave blu, Altin Muratit, i dyshuar për bashkëpunim në zhdukjen e shtetasit Artan Lleshi në nëntor të vitit të kaluar. I vënë në pranga gjatë një aksioni policor tejet sekret, pak ditë më parë me "akuzën e vrasjes me paramendim, Murati, ka rrëfyer njohjen me 40-vjeçarin e zhdukur dhe takimin e fundit me të, por ka mohuar të ketë gisht në krimin e rëndë. "Kohët e fundit kam jetuar në Gjermani. Në shtator u ktheva dhe me Artanin jam takuar disa herë, në Laprakë dhe Paskuqan, ndërsa në një rast kemi udhëtuar bashkë drejt Burrelit dhe jemi kthyer brenda ditës. Për herë të fundit e kam takuar pranë stacionit të autobusit në Babrru, në datën 5 nëntor 2017 rreth orës 11:00. Unë kam qenë me makinën tip Volksvagen Polo, që e kisha marrë me qira. Artani më kërkoi makinën, por nuk ia dhashë. Prej asaj dite nuk jam takuar më me të. S'kam kurrfarë dijenie për vendndodhjen e tij dhe as se çfarë mund t'i ketë ndodhur",-ka dëshmuar Altin Murati. Alibia e të dyshuarit kundërshtohet nga rrëfimet e personave të tjerë, të cilët thonë se Artan Lleshi u pa për të fundit herë në afërsi të rreth rrotullimit të Kamzës, në shoqërinë e Altin Muratit. Prokuroria ka dyshime se zhdukja e 40-vjeçarit, ka lidhje me hasmërinë disa vjeçare, që nisi vite më parë në Angli, ku një pjesëtar i fisit Hoxha u rrëmbye dhe më vonë u gjet i djegur. Për këtë ngjarje drejtësia britanike cilësoi fajtor dhe dënoi Arben Lleshin, kushëri me të zhdukurin. I dyshuari Altin Murati, i vetmi deri tani në pranga, është pyetur nga hetuesit nëse kishte dijeni për problemet që kishte Artan Lleshi. Kjo për faktin se i dyshuari rezulton të ketë lidhje gjaku me familjen Hoxha. "E dija që ishte në hasmëri, por jo me cilën familje. Artani më ka thënë se i kanë bërë dy atentate",-tha Murati. Prokuroria ka dyshime se 40-vjeçari Lleshi, i zhdukur pa gjurmë prej tre muajsh, mund të jetë ekzekutuar.


Altin Murati



Voltiza Duro

### Mjeku popullor: Bimët mjekësore që ju ndihmojnë në luftimin e virozave të stinës

# Ylli Merja: Me këtë pluhur do e largoni gripin menjëherë

## "Propolis e hudhër, mbrojtësit më të mirë"

Vendi jonë falë pozitës gjeografike ka një larmishmëri bimësh medicinale për një shëndet pa problematika. Nëse i referohemi një bime të njohur botërisht si shtara e zezë apo rrënja e sanzës do të shikojmë efektet e saj çudibërëse kundër gripit. Shija e saj është shumë e hidhur, por ka rezultate të mrekullueshme brenda një kohe të shkurtër në kurimin e gripit dimëror dhe jo vetëm. Ky pluhur mund të hidhet në gojë dhe ta shoqërosh me ujë apo ta hedhësh në kos. Ky pluhur ndikon në forcimin e rruazave të bardha të gjakut, pra leukociteve si dhe grimcat që kanë hyrë në organizëm i bllokon dhe nuk i lejon që virusi të krijojë lidhje me qelizën. Kjo bimë ka një mori lëndësh kimike, rreth 10-12 të tilla që japin efekte pozitive jo vetëm në sistemin imunitar të organizmit, por ndihmojnë dhe përmirësojnë shumë funksionimin e mëlçisë. Gjithashtu, mund të përdoret edhe te fëmijët anemikë, pasi qelizat absorbojnë hekurin, pra është një bimë e mrekullueshme që përmirëson edhe oreksin. Kjo bimë pavarësisht efekteve, nuk është shumë e njohur në vendin tonë. Një vlerë shumë të rëndësishme ka edhe çaji i trëndafilit të egër, i cili ndikon në kurimin e gripit. Në këtë periudhë përballemi me uljen e temperaturave në ambientet e jashtme dhe mbajtjen në vlera të larta të temperaturës në shtëpi. Pikërisht këto ndryshime temperaturash pëlqen edhe virusi i gripit, qoftë ai A, B apo C. Më të shpeshtit janë virusi A dhe B që përhapen me rrugë ajrore nga njëri person te tjetri nëpërmjet teshtimave, prekjes së objekteve të përbashkëta, ose kollitja në ambientet publike. Këto janë mënyrat e përhapjes së gripit që me rrugët aspiratore hundë apo gojë, arrijnë në brendësi të alveolave të mushkërive, më pas hyjnë në kombinacion me to. Mbështjellja proteinike e viruseve, ngjiten në alveolën e mushkërive, hyjnë në bashkëpunim me qelizën e fillojnë ta shkatërrojnë. Kjo periudhë inkubacioni që zgjat 24-72 orë shoqërohet me çrregullime fiziologjike, këputje trupore, rrjedhje hundësh, skuqje sysh etj. ky është momenti që njeriu duhet të kuptojë që virusi është i pranishëm në trupin e tij dhe pas 1-2 ditësh bëhet si një burim amplifikacioni e përhapet edhe te të tjerët. Ndërsa në trupin e të sëmurit fillon ajo "lufta" e brendshme fiziologjike e organizmit e i gjithë ky cikël zgjat 5, 7 apo 10 ditë. Por, nëse marrim masa mbrojtëse, ky cikël do të shkurtohet e shkalla e agresivitetit të virusit do të bjerë.



Mjeku popullor Ylli Merja

### HUDHRA E PROPOLISI

Nëse njeriu konsumon 2-3 thelpinj hudhër në ditë, të shoqëruara me një gotë ujë, mund ta parandalojë më së miri prekjen nga virusi, ndërsa në moshat e vogla, përdoret 1 thelb hudhër në ditë.

Vrasësit e këtyre viruseve janë rigoni e trumza, që përmbajnë disa elemente antibakteriale e antimykotike. Këto bimë mund t'i përdorim në gjellë apo në çaj e për fëmijët e vegjël gjysmë lugë kafeje me rigon është më se e mjaftueshme. Për të pasur epërsi ndaj virusit që mund të jetë zhvilluar e lufton leukocitet për të shumëzuar vetveten, mund të përdorim çaj me piper të zi, petat e arrës, karafil e kanellë. Kjo përzierje rrit rezistencën e organizmit dhe shton fuqinë goditëse ndaj viruseve. Por më i fuqishmi është propolisi antimykotik, i cili nuk lejon inflamacion bajamesh, laringite dhe acarim të mushkërive. Në të kundërt rekomandojmë që në pak çaj apo ujë, të hedhim pak propolis për të minimizuar shijen paksa të hidhur. Ndërsa kur hasim vështirësi në frymëmarrje e bllokim hundësh te fëmijët, rekomandohet që të merret vaj dafine, e t'i vendoset te hunda, t'i hidhet një pikë në gojë e 2-3 pika në gjoks. Brenda 2 minutash rrugët respiratore do të jenë totalisht të zhbllokuara. Gjithashtu, duhet të përdoren shumë lëngje frutash, veçanërisht ai i limonit. Në rastet kur fëmijët kanë temperaturë të lartë, rekomandohet që mos të shkohet direkt në spital. Ata mund të marrin një thelb hudhër, ta shtypin që t'i marrin lëngun e ta përziejnë me pak sodë buke e pak mjaltë e t'i lyejnë fëmijës bajamet. Nëse nuk e realizojnë dot këtu, t'i përgatisin një çaj me trëndafilin e egër, lulen e shtogut, pak lëvore shelgu apo limoni dhe aguliçë apo peta të arrës. Pas kësaj i hedhim dhe 10 pika propolis, e ia japim fëmijës vazhdimisht duke e masazhuar me pak raki rrushi ku ke hedhur 1 apo 2 paracetamolë. Ky masazhim duhet të bëhet jo shumë afër reflektorit, e më pas ta mbështjellim mirë e t'i fshijmë djersët. Pas kësaj temperatura do të bjerë. Në rastet e fëmijëve alergjikë, duhet të kontrolloni gjuhën nëse ka myk apo bajamet mos janë të qelbëzuara. Nëse i pastrojmë gjuhën me sodë e hudhër, e trajtojmë me propolis e i japim pak çaj me disa bimë si trëndafil i egër, piper i zi, vaj dafine për të marrë rezultate të menjëhershme. Fëmijës në këto raste i është ulur rezistenca e duhet patjetër që të merret me aktivitet fizik. Për uljen e temperaturës së lartë mund të përdoret edhe propolisi si dhe kompresat e ftohta me uthull molle në ballë, pasi kjo e fundit ka efekt të menjëhershëm. Por nuk duhet të mjaftohemi me kaq, sepse duhet të marrë edhe vitaminën C nëpërmjet bimëve të ndryshme si çaj trëndafili, çaj mali, boronica etj. Ndërsa në rastet kur njeriu vuan nga bronkiti apo ndonjë inflamacion i mushkërive, duhet të përdoret dafinë dhe çaj mente për të eliminuar fillimisht mukozën e thatë dhe gërhitjen.

### PLUHURI I SANZËS

Nëse i referohemi një bime të njohur botërisht si shtarë e zezë apo rrënja e sanzës do të shikojmë efektet e saj çudibërëse kundër gripit. Shija e saj është shumë e hidhur por ka rezultate të mrekullueshme brenda një kohe të shkurtër në kurimin e gripit dimëror dhe jo vetëm. Ky pluhur mund të hidhet në gojë dhe ta shoqërosh me ujë apo ta hedhësh në kos. Ky pluhur ndikon në forcimin e rruazave të bardha të gjakut, si dhe grimcat që kanë hyrë në organizëm i bllokon dhe nuk i lejon që virusi të krijojë lidhje me qelizën.



## SHKURT

### Ja specialitetet për mjekët që do të punojnë me bonus

Të gjithë mjekët specialistë që janë të interesuar për të punuar në spitalet rajonale e bashkiake mund të paraqesin kërkesën e tyre për t'u punësuar me bonus 2.5 milionë lekë të vjetra mbi pagën. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ftoi dje publikisht të gjithë mjekët si dhe shpalli specialitetet për të cilat kërkohet punësimi i mjekëve, sipas nevojave të spitaleve. Përkatësisht, specialitetet e kërkuara janë në kirurgji, anestezi reanimacion, kardiologji, obstetrikë-gjinekologji, neurologji, pediatri, imazheri, mjekësi interne dhe ortopedi - traumatologji. Të gjithë mjekët që do bëjnë kërkesën duhet të jenë të gatshëm të punojnë në spitale rajonale apo bashkiake, për një periudhë nga 6 muaj deri në 1 vit, me të drejtë rinovimi, me kushte dhe aktivitet të përcaktuar, bazuar në vendimin e marrë për masën e bonusit deri në 250 mijë lekë plus pagën e mjekut. Fondi i vënë në dispozicion nga qeveria shqiptare për këtë vit është 52 milion lekë, për mjekët që do të japin shërbimin aty ku janë nevojat.

### Rabdishti, pjesë e projektit "100 fshatrat"

Ministri i Turizmit dhe i Mjedisit, Blendi Klosi ishte i pranishëm në një bashkëbisedim me banorët e fshatit Rabdisht, të cilin e cilësoi si një prej të përzgjedhurve në projektin e "100 fshatrat". "Kemi zgjedhur fshatin tuaj si një nga këto pika e së bashku me partnerë mbështetës të politikave tona të turizmit ne mund ta ndryshojmë kryekëput situatën e zhvillimit turistik. Ne kemi të gjitha mundësitë që numrin prej 20 mijë turistësh që ka kjo zonë në vit, ta pesëfishojmë me pak investime." - tha ministri. Ky i fundit theksoi se ngritja dhe rregullim i bujtinave krahas kulinarisë, shërbimeve të tjera dhe guidave dhe mbajtjes pastër të së gjithë zonës do të ketë një ndikim të ndjeshëm në afrimin e turistëve. Gjatë bashkëbisedimit me banorët, Klosi deklaroi se investime si rruga e Arbrit do të çojnë në 100 mijë numrin e turistëve në zonën e Dibrës. Ndërkaq, programi i qeverisë "100 fshatrat" synon zbatimin e investimeve të përbashkëta strategjike për zhvillimin e integruar të hapësirave rurale të vendit.


**SHPALLJE ANKANDI**

Shoqëria përmbarimore gjyqësore private "ARB" Sh.p.k., zhvillon Ankandin e Dytë për shitjen e pasurisë së paluajtshme **Apartament**, me sipërfaqe **98.39** m² (**nëntëdhjetë e tetë pikë tridhjetë e nënët metra katrorë**), e regjistruar në Zonën Kadastrale Nr. **8603**, Regjistruar në Regjistrin Hipotekor Nr. **322**, datë **19.11.2004**, Numri i Pasurisë **26/121+2-7**, Vol. **17**, Faqe. **243**, me adresë: **Lagjja "28 Nëntori", Vlorë**, në pronësi të **Edlira Aliaj**, për kredinë e marrë pranë Bankës NBG Albania Sh.a. Çmimi fillestar me të cilin fillon ankandi i dytë është **25,600.00** (**njëzet e pesë mijë e gjashtëqind**) **Euro.** Ankandi do të zhvillohet datë **14.02.2018**, ora **16:00**, në adresën: **Qendra e Zhvillimit të Ankandeve Publike Përmbarimore** ("**QZHAPP**"), me adresë në: Rruga "Nikolla Jorga", Ndërtesa Nr. 9, Kati 2, pranë Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, Tiranë. Secili ofertues duhet të depozitojë si garanci në llogarinë e **ARB** me **IBAN AL21901110510027173510016018** në **EURO** pranë **Bankës NBG Albania** shumën prej 10 % (dhjetë përqind) të çmimit fillestar. Për informacion të mëtejshëm kontaktoni me shoqërinë përmbarimore gjyqësore private "ARB" Sh.p.k., me adresë: Rruga "Fatmir Haxhiu", Pall.: 21, Shk.: 3, Ap.: 3, Tiranë; tel: 042 252888; ose në adresën e email-it: info@arb.al



**SHPALLJE ANKANDI**

Shoqëria përmbarimore gjyqësore private "ARB" Sh.p.k., zhvillon Ankandin e Dytë për shitjen e pasurisë së paluajtshme **Apartament**, me sipërfaqe **59.5** m2 (**pesëdhjetë e nëntë pikë pesë metra katrorë**) e ndodhur në Zonën Kadastrale Nr **2291**, Pasuria me Nr. **306/68+1-18**, vol. **21**, Fq. **245**, me adresë në: Kryemëdhenj, Kavajë, në pronësi të **Edmond Zyberi**, për kredinë e marrë pranë Bankës NBG Albania Sh.a. Çmimi fillestar me të cilin fillon ankandi i dytë është **15,360.00** (**pesëmbëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë**) **Euro.** Ankandi do të zhvillohet datë **14.02.2018**, ora **17:00,** në adresën: **Qendra e Zhvillimit të Ankandeve Publike Përmbarimore** ("**QZHAPP**"), me adresë në: Rruga "Nikolla Jorga", Ndërtesa Nr. 9, Kati 2, pranë Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, Tiranë. Secili ofertues duhet të depozitojë si garanci në llogarinë e **ARB** me **IBAN AL21901110510027173510016018** në **EURO** pranë **Bankës NBG Albania** shumën prej 10 % (dhjetë përqind) të çmimit fillestar. Për informacion të mëtejshëm kontaktoni me shoqërinë përmbarimore gjyqësore private "ARB" Sh.p.k., me adresë: Rruga "Fatmir Haxhiu", Pall.: 21, Shk.: 3, Ap.: 3, Tiranë; tel: 042 252888; ose në adresën e email-it: info@arb.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
SHOQËRIA PËRMBARIMORE "EXECUTORES LITIUM" (EXC LIT) sh.p.k

**Shoqëria Përmbarimore "Executores Litium " sh.p.k**
**do të zhvillojë ankandin e pare për pasurinë e paluajtshme :**

**Njësi me nr. Pasurie 6/121-N12, vol 22, fq.28, e regjistruar në ZVRPP Tiranë ZK 8160, me sipërfaqe 37 m2, në pronësi të Albert Sokol Elezi**
***Cmimi me të cilin do të filloje ankandi është në vlerën 29,600 Euro***
**Ankandi do të zhvillohet në datë 29.01.2018 ora 16:00, në zyrën përmbarimore "Executores Litium" sh.p.k, me adresë *Blv "Zhan Dark", Kulla 1 Teknoprojekt, shk 1, kati 4, ap 10, Tirane*.**

SEMUNDJA
ALARMI

Adela Vasili: Vaksina, mjeti i vetëm për shpëtimin e jetës në të tilla raste

# Epidemi fruthi në vend, shkon në 16-të numri i fëmijëve të prekur

## Epidemiologia e ISHP-së: Mbi 1200 të pavaksinuar në Tiranë

Voltiza Duro

Ka arritur në 16 numri i fëmijëve të konfirmuar me fruth, ndërkohë në kryeqytet mbi 1200 prej tyre janë ende të pavaksinuar. Rastet më të shumta sipas Institutit të Shëndetit Publik, janë kryesisht fëmijë nën 1 vjeç, por vlen të theksohet se mund të jetë prekur edhe një i rritur, i cili po mbahet nën mbikëqyrje. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Adela Vasili, epidemiologe në Departamentin e Kontrollit të Sëmundjeve Infektive në ISHP, shprehet se për fruthin edhe një rast i vetëm përbën epidemi. Por ajo më tej shton se popullata kryesisht është e mbrojtur dhe vetëm 4% e popullatës nuk është vaksinuar. Epidemiologia i bën thirrje të gjithë prindërve që të vaksinojnë fëmijët e tyre në të mirë të shëndetit të tyre.

**Sa është numri i fëmijëve të prekur nga fruthi deri më tani në vendin tonë?**

Deri tani janë shtruar në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" 20 fëmijë, nga të cilët 16 janë të konfirmuar me fruth. Të prekurit janë kryesisht fëmijë të moshës nën 1 vjeç që nuk e kanë bërë vaksinën. Por, gjithashtu, rezultojnë me fruth edhe fëmijë mbi 1 vjeç që prindërit ende nuk i kanë vaksinuar. Ndërkohë analizat e 2 fëmijëve janë ende në pritje, ndërsa dy të tjerë kanë rezultuar negativ.

**Aktualisht ku po trajtohen të prekurit nga sëmundja dhe si paraqitet gjendja e vogëlushëve?**

Fëmijët janë vendosur në një karantinë apo pavion të veçantë në Pediatrinë Infektive në QSUT, ku janë 6 dhoma në katin e dytë për trajtimin e tyre. Mesa kemi kontaktuar me mjekët specialistë, gjendja e fëmijëve nuk paraqitet e rëndë.

**A mund të themi se kjo situatë përbën epidemi?**

Për fruthin edhe një rast përbën epidemi, por fakti që kemi jo shumë raste të prekura na bën të kuptojmë që popullata ka mbrojtje. Sëmundja po prek vetëm të pa vaksinuarit kryesisht nën 1 vjeç. Pra, ka një lloj mbrojtjeje. Por ne po bëjmë apel që mos të shtyhet vaksinimi, pasi fëmijët e pavaksinuar janë të pambrojtur.

**Cilat janë disa nga arsyet që këta fëmijë nuk janë vaksinuar?**

Prindërit nuk i kanë vaksinuar për arsye të ndryshme, disa thonë se fëmija ka qenë i sëmurë, disa të tjerë kanë refuzuar vaksinimin me pretekste nga më të ndryshmet.

**Sa është numri i të pavaksinuarve në rang vendi?**

Në vendin tonë rreth 4% e popullatës janë të pavaksinuar nga fruthi, e po t'i referohemi Tiranës, ka 1200-1300 fëmijë që kanë mbushur 1 vjeç dhe ua kanë shtyrë vaksinimin. Kjo shtyrja është e gabuar e shpresojmë që prindërit të ndërgjegjësohen sa më shpejt. E nëse këta fëmijë janë të grupuar në një zonë të caktuar, atëherë propabiliteti për të përhapur virusin te njëri-tjetri është shumë i madh.

**Cilët janë më të rrezikuarit?**

Ka fëmijë që nuk vaksinohen për arsye shëndetësore dhe nëse ky fëmijë bie në kontakt me një tjetër që nuk është vaksinuar, sepse prindi ka refuzuar, rrezikon jetën. Pasojat që lë fruthi për këtë kontigjent fëmijësh që nuk mund të vaksinohen pasi janë të sëmurë, janë shumë të rrezikshme. Kështu që të vaksinohen të gjithë për të mbrojtur ata që realisht nuk e bëjnë dot vaksinën e kanë imunodeficencë.

**Nënat janë kontaktuar nga mjekët e ju është komunikuar që të vaksinojnë fëmijët urgjentisht. Në rastin që fëmija është prekur nga virusi, vaksina nuk duhet të bëhet pasi ka rrezik. Si do veprohet në këto raste?**

Në rastet kur fëmija e ka marrë virusin e është i sëmurë me fruth, normalisht nuk e bën vaksinën. Fruthi ka disa shenja karakteristike e automatikisht pediatri do e konstatojë këtë gjë. Nuk ka gjasa të ndodhë diçka e tillë, të bëhet një vaksinim te fëmijët me fruth e t'u vihet jeta në rrezik.

**A është e mjaftueshme sasia e vaksinave dhe sa interes ka pasur nga prindërit pas rishfaqjes së fruthit?**

Në këto 2-3 ditët e fundit ka pasur një ndërgjegjësim e prindërit janë drejtuar në qendrat shëndetësore për të vaksinuar fëmijët. Vaksina ka dhe ne do i furnizojmë prap qendrat, jo vetëm për të vegjlit, por edhe për kontigjentin e viteve 1980-1990 që nuk e kanë bërë vaksinën.

**Cilat janë shenjat e para të fruthit?**

Fruthi nuk është aq i lehtë për t'u kuptuar, sepse është virozë dhe shfaq temperaturë, kollë e më pas shfaqen puçrrat. Në momentin që shfaqen këto të fundit, është e vendosur diagnoza klinike. Mjeku është ai që gjykon rastet.

**A ka gjasa të ndikojë vaksina e fruthit në spektrin e autizimit?**

Lajmi që është publikuar rreth 2 vite më parë e që lidhte vaksinën e fruthit me autizmin është hedhur poshtë. Autizmi është përjashtuar si variant i një lidhjeje të mundshme me vaksinën, në bazë të studimeve që janë bërë. Kështu prindërit nuk duhet të kenë frikë nga kjo hipotezë e rremë. Ndërkohë është thënë se edhe myslimanët nuk i kanë vaksinuar fëmijët. Komuniteti mysliman në Shqipëri ka deklaruar se nuk ka asnjë teolog apo institucion fetar që të jetë kundër vaksinave. Për më tepër, në bazë të statistikave në shumë vende myslimane ka mbulim të mirë me vaksina e madje dhe kërkesë për të.

**Cila është thirrja juaj drejt popullatës?**

Duhet të ketë një sensibilizim akoma më të madh nga ana e mjekëve që vaksinat janë mjetet e vetme për shpëtimin e jetëve në të tilla raste. Prindërit duhet të jenë të bindur se grupi i vaksinave që duhen bërë, është për të mirën e shëndetit të fëmijëve të tyre. Ju bëjmë thirrje prindërve që kanë fëmijë të vegjël të pavaksinuar që mund të kenë viroza apo temperaturë të mos drejtohen te urgjenca e QSUT-së, por te mjeku i familjes. Kjo bëhet për të evituar kontaktin me fëmijët që kanë shenjat e fruthit e mund të kontaminohen.

**Në cilat shtete duhet të tregojnë kujdes personat që lëvizin jashtë Shqipërisë? Pra, cilat vende janë të prekura nga fruthi?**

Shtetet e prekura nga fruthi sipas statistikave janë Kosova, e cila shënon 2 raste vdekjesh nga kjo sëmundje, Italia, Greqia, Serbia, Rumania, Maqedonia. Pra, të gjitha shtetet fqinje janë të prekura nga fruthi.



Adela Vasili, epidemiologe në Departamentin e Kontrollit të Sëmundjeve Infektive në ISHP

### EPIDEMIOLOGIA E ISHP-SË

### "Të rivaksionohen individët që kanë lindur në vitet 1980-1990"

Deri më tani ka vetëm një person të rritur që dyshohet i prekur nga fruthi i lindur në vitet 1980-1990, kategori për të cilën mjekët bëjnë apel sërish që të rivaksinohet. Ky individ i përket këtij kontigjenti e duhej të ishte vaksinuar. Sipas epidemiologes, pacienti është shtruar dy ditë më parë e së shpejti do të ketë analizën e saktë për rastin e tij. Fëmijët që kanë lindur në vitet 1980-1990 janë vaksinuar vetëm një herë e duhet të marrin edhe dozën tjetër të vaksinës ndaj fruthit. Që prej 2016, Instituti i Shëndetit Publik ka bërë thirrje sensibilizuese ndaj kësaj kategorie e vjet kanë vënë në dispozicion një sasi të konsiderueshme vaksinash për ta. "Ka pasur raste që i janë përgjigjur shumë mirë, pozitivisht thirrjes sonë, por ka pasur të tjerë që vetëm pyesnin por nuk shkonin të bënin vaksinën. Të gjithë ata individë që kanë mbetur vetëm me një dozë që prej asaj kohe, mund të shkojë në qendrat shëndetësore e të bëjë vaksinën e dytë".



**16**

**FËMIJË TË PREKUR NGA FRUTHI**

"Deri tani janë shtruar në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" 20 fëmijë, nga të cilët 16 janë të konfirmuar me fruth. Të prekurit janë kryesisht fëmijë të moshës nën 1 vjeç që nuk e kanë bërë vaksinën. Por, gjithashtu, rezultojnë me fruth edhe fëmijë mbi 1 vjeç që prindërit ende nuk i kanë vaksinuar. Ndërkohë analizat e 2 fëmijëve janë ende në pritje, ndërsa dy të tjerë kanë rezultuar negativ", - tregon Vasili.

**1200**

**TË PAVAKSINUAR NË TIRANË**

"Në vendin tonë rreth 4% e popullatës janë të pavaksinuar nga fruthi, e po t'i referohemi Tiranës, ka 1200-1300 fëmijë që kanë mbushur 1 vjeç dhe ua kanë shtyrë vaksinimin. Kjo shtyrje është e gabuar e shpresojmë që prindërit të ndërgjegjësohen sa më shpejt. E nëse këta fëmijë janë të grupuar në një zonë të caktuar, atëherë propabiliteti për të përhapur virusin te njëri-tjetri është shumë i madh", - shprehet epidemiologia.

### ADELA VASILI

### "Çerdhet e kopshtet më të rrezikuara nga përhapja e virusit"

Një rrezik tjetër i përhapjes së fruthit janë ambientet e shkollave, kopshteve e çerdheve, ku fëmijët janë më të predispozuar për t'u prekur. ISHP bën me dije për "Gazeta Shqiptare" se po merren të gjitha masat për parandalimin e përhapjes së sëmundjes. "Po merren të gjitha masat, po kontrollohen, por në përgjithësi në shkolla fëmijët duhet t'i kenë marrë të dyja dozat pasi janë mbi 6 vjeç. Po bëhet kontrolli nëse ka fëmijë që kanë marrë vetëm një dozë për të proceduar më tej me vaksinimin e tyre", - tregon Vasili. Problemi më i madh qëndron te çerdhet dhe kopshtet, ku vogëlushët kanë marrë vetëm një dozë vaksine antifruth sipas kalendarit kombëtar të vaksinimit. "Fëmija është 1 vjeç dhe është në çerdhe, e aty është gjithë problemi, sepse në çerdhe ka raste kur s'është bërë vaksina e parë e në kopshte s'është bërë e dyta. Ne nuk mendojmë që të ketë ndonjë përhapje të madhe të sëmundjes pasi popullata është e vaksinuar", - thekson epidemiologia.

### Ngjarja në vitin 2015, dënohet me 10 vite heqje lirie edhe bashkëpunëtori

# Vrau në pritë me kallashnikov 24-vjeçarin, gjykata dënon me 20 vite burg autorin

Senad Nikshiqi

## Viktima Luigj Gjergji i kishte ngacmuar motrën

**SHKODËR**

Gjykata e Shkallës së Parë e Shkodrës ka dënuar me 20 vite burg Eduart Hulejn, i cili më 9 tetor të vitit 2015 vrau të riun Luigj Gjergjin, se i ngacmoi motrën. Ndërsa, bashkëpunëtori në këtë krim të rëndë, Akil Gradeci u dënua me 10 vite burg. Të dy këta persona u shpallën fajtorë. Ngjarja ndodhi në fshatin Stajkë, ndërsa viktima nga fshati Pistull u gjet i vrarë me armë zjarri brenda mjetit të tij. Gjatë seancave që kanë zgjatur 2 vite deri në dhënien e dënimit, dëshmitë dhe provat e siguruara nga policia dhe prokuroria kanë bërë që trupa gjykuese e kryesuar nga Sokol Shehu t'i deklarojë fajtorë Hulejn dhe Gradecin. Ndërkaq, ky i fundit ka kërkuar pafajësinë, duke thënë në sallën e gjyqit se nuk ka pasur dijeni se çfarë ka bërë shoku i tij. Nga ana tjetër, i pandehuri Eduart Hulej dhe avokatja e tij kanë pranuar vrasjen, por kanë kërkuar ndryshimin e cilësimit të akuzës nga "vrasje me paramendim", në vrasje e thjeshtë, pra pa paramendim. "Luigj Gjergji ka dashur që të më vrasë. Jemi takuar rastësisht dhe pas një debati, pata frikë se ai mund të më vriste, ndaj e qëllova. Unë nuk kam dashur ta vras dhe këtë nuk e kam bërë me paramendim, por ka qenë një ngjarje e çastit", është shprehur Hulej në sallën e gjyqit. Pavarësisht këtij pretendimi, prokuroria tha se provat tregojnë mjaftueshëm se Eduart Hulej ka mirorganizuar vrasjen e Luigj Gjergjit, ndërsa shoku i tij, Akil Gradeci e ka ndihmuar në këtë krim. Në këtë mënyrë, prokuroria kërkoi 30 vite burg për Hulejn dhe 15 vite



Viktima, Luigj Gjergji

burg për Gradecin. Gjykata e Shkallës së Parë pranoi kërkesën e prokurorisë duke dënuar me 30 vite Hulej dhe 15 vite Gradecin, por të dy këta përfituan nga gjykimi i shkurtuar, teksa iu ul 1/3 e dënimit. Eduart Hulej do të vuajë 20 vite burg dhe shoku i tij Akil Gradeci 10 vite.

**VRASJA**

24-vjeçari Luigj Gjergji po kthehej nga Rinasi në Shkodër, kur u ekzekutua me breshëri automatiku. Ngjarja e rëndë që i mori jetën emigrantit ka ndodhur rreth orës 02:15 të 9 tetorit 2015. I riu sapo kishte përcjellë nënën e tij për në Greqi dhe po kthehej në shtëpi. Ai po udhëtonte me mjetin tip "Audi", me targë greke NZP8147 dhe në aksin rrugor Shkodër-Vau Dejës, Eduart Hulej i ka zënë pritë dhe e ka qëlluar për vdekje. Pas breshërisë me automatik, makina me të cilën po udhëtonte ka përfunduar poshtë një kanali, në anë të rrugës duke rënë në ujë. Në atë orë të vonë kanë qenë banorët e zonës, ata që kanë lajmëruar policinë, pasi kanë dëgjuar të shtënat e kallashnikovit. Pas njoftimit, forcat e policisë menjëherë kanë mbërritur në vendngjarje, teksa kanë parë 24-vjeçarin, i cili kishte humbur jetën nga plumbat e shumtë që ka marrë në trup. Menjëherë pas ngjarjes, policia shpalli në kërkim Eduart Hulejn dhe Akil Gradecin. Në vetëm pak ditë pas vrasjes, policia arriti që ta zbardhte ngjarjen. Eduart Hulej, sipas burimeve policore ka vrarë Luigj Gjergjin, pasi ky i fundit kohë më parë i kishte ngacmuar motrën. Viktima dhe autori pak ditë para vrasjes kishin pasur edhe një debat të fortë mes tyre. Pas debatit, Hulej i ka zënë pritë duke qëlluar 24-vjeçarin Luigj Gjergji dhe duke e lënë të vdekur në vend. Në vendngjarje u sekuestruan 10 gëzhoja automatiku.

**Sherbime Konsulence (Sektori I Gjenerimit Hidrik –Rehabilitim/Modernizim)**
**Afati I fundit: 12 Shkurt 2018 (Ora 16:00)**

**VENDI: Albania**
**REFERENCA NR.:** BMZ ID 2009 66 531
**FTESE PER TENDER:** Tender I hapur nderkombetar me parakualifikim
**REF.:**Sherbime Konsulence per Konsulent Zbatimi per Qendren Dispecer e te Monitorimit te Digave per Hec-et e Kaskades se lumit Drin.
**AGJENCIJA E ZBATIMIT TE PROJEKTIT:** KESH - Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a.
**MASAT NDERHYRESE TE PROJEKTIT:**
Nje Program iI Sigurise se Digave – nen implementim- perfshin investime te ndryshme te fokusuara ne sigurine e digave dhe ne Hec-et ne kaskaden e lumit Drin. Pjese e ketij Programi eshte edhe implementimi I Qendres Dispecer e te Monitorimit te Hec-eve te Kaskades se lumit Drin (DMDC). Projekti I propozuar perfshin punesimin e nje konsulenti zbatimi per DMDC.
Ne kuadrin e Programit, nje konsulent tjeter ka perfunduar studimin e fizibilitetit per Qendren ne fjale. Objektivi i Sherbimit te Konsulences eshte te siguroje sherbim profesional, te plote dhe gjitheperfshires duke asistuar PMU ne KESH ne zbatimin e Projektit. nepermjet:
(i) Perpunimi i projektit paraprak te Qendres Dispecer e te Monitorimit (DMDC),
(ii)Pergatitja e Dokumentave te Tenderit per kontraktimin.
(iii) Asistence ne procesin e prokurimit bazuar ne udhezuesin e prokurimit te KfW si dhe ne Librin e Verdhe te FIDIC. (iv) Negocimi dhe menaxhimi ne menyren me te perfitueshme te kontrates per implementimin e DMDC
(v) Mbikqyrja e punimeve dhe asistence per PMU me qellimin e arritjes se nje cilesie optimale te punimeve dhe mallrave me koston me te arsyeshme dhe periudhen e zbatimit me te shkurter te nevojshme..
**FINANCUAR:** Bashkepunimi Financiar Gjerman nepermjet Bankes se Zhvillimit KfW.
**SHERBIMET E KERKUARA TE KONSULENCES:**
Konsulenti do te siguroje asistence per KESH-PMU ne aktivitetet qe i perkasin zbatimit te projektit. Objekti i punes perfshin si me poshte:

**1.**Sherbime te parandertimit, perfshire pergatitjen e projektit paraprak te punimeve si dhe procesin e tenderimit per DMDC.
**2**.Asistence ne Menaxhimin e Projektit.
**3**.Rishikimi i dokumentacionit te leshuar nga Kontraktori.
**4**.Mbikqyrje e Kontraktorit ne vendin e zbatimit te Projektit.
**5**.Monitorimi I Sistemit te Shendetit dhe te Sigurise dhe Plani I Mbrojtjes se Mjedisit te Kontraktorit.
**6**.Inspektimi i vendit te prodhimit te komponenteve kryesore.
**7**.Asistence ne korrektimin e mangesive gjate periudhes se garancise se difekteve.
**8**.Raportim.
Punimet qe do te kryhen ne kuadrin e Projektit jane komplekse dhe kerkojne nje experience nderdisiplinore ne fushat e meposhtme te inxhinierise:
- Kontrolli Dixhital, Mbrojtje dhe Matje (Menaxheri I Projektit),
- Telekomunikacion dhe SCADA (Ekspert),
- Elektrik/Mekanik,
- Gjeologji/ Sizmike ,
- Hidrologji/Hidroteknike
- Ndertim/Topografi,
- Prokurim, Finance dhe Administrate Kontrate
- Komisionim/Kontroll Cilesie
- Menaxher i sistemeve te shendeti sigurise dhe mjedisit

Menaxheri I Projektit duhet te kete te pakten 15 vjet experience profesionale ne projekte te ngjashme. Specialistet e tjere duhet te kene te pakten 10 vjet experience profesionale ne fushat e kerkuara.
Sherbimet e konsulences do te vazhdojne per nje periudhe 18 mujore. Konsulenti do te punoje ngushte me counterpartin e tij local ne PMU. Sherbimi do te kryhet kryesisht ne Shqiperi (Tirane dhe ne vendet e Projektit gjate fazes se zbatimit te punimeve).
Ky parakualifikim per sherbimet e konsulences do te kryhet ne perputhje me versionin e fundit te "Udhezuesit per Punesimin e Konsulenteve ne Bashkepunimin Financiar me Vendet Partnere" (referojuni faqes se internetit te Bankes per Zhvillim KfW (www.kfw-entwicklungsbank.de). Parashikohet qe sherbimet e konsulences ti jepen nje firme konsulente te pavarur qe ka marre pjese ne projekte rehabilitimi dhe modernizimi te HEC eve dhe me experience te thelle ne projektim dhe operim te sistemeve te SCADA es dhe preferohet ne Europe. Xhiroja vjetore per tre vjetet e fundit te mos jete me e vogel se 1.5 million euro. Ftesa per Shprehjet e Interesit do te kerkohet ne KESH - Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a. ne adresen e meposhtme:

**KESH:**Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a. ("KESH")
Drejtuar Mr. Fatos Bundo (Drejtor I Projekteve)
Blloku "Vasil Shanto", Tiranë, Shqipëri
Albania
**Tel/Fax** : +355 4 2262148
**Cel** +355 69 40 42 518
**E-mail** : bundof@kesh.al

**Consulting Services (Hydropower Sector –Rehabilitation/Modernization)**
**Deadline: 12 February 2018 (16:00 hours CET)**

**COUNTRY: Albania**
**REFERENCE-NO.:** BMZ ID 2009 66 531
**INVITATION TO TENDER:**International competitive bidding with pre-qualification
**REF.:** Consulting Services for an Implementation Consultant for the Dam Monitoring and Dispatch Center (DMDC) for Drin River Cascade HPPs.
**PROJECT EXECUTING AGENCY:**KESH - Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a. (Albanian Power Corporation)
**PROJECT MEASURES:**
A Dam Safety Programme - under implementation - comprises various investments focusing on hydropower and dam safety in the Drin river cascade. Part of the Programme is the implementation of a Dam Monitoring and Dispatch Centre (DMDC) for the Drin River Cascade HPPs. The proposed Project includes appointing of an implementation consultant for the DMDC.In the framework of the Programme another consultant carried out the feasibility study for the envisaged DMDC.The objective of the Consulting Services for the Project is to provide complete, comprehensive and professional services by assisting the Project Management Unit (PMU) of KESH in the implementation of the Project by:
**(I)** Elaborating the Preliminary Design for the DMDC,
**(II)** Preparing of the Tendering Documents (TD) for the contract.
**(III)** Assisting the procurement process of the based on the procurement guidelines of KfW and based on FIDIC Yellow Book,
**(IV)** Negotiating and managing in the most profitable way the contract for implementation of DMDC
**(V)** Supervising the works and to assist the PMU aiming on optimal quality of the works and goods at the most reasonable costs and the shortest necessary implementation period.
**FINANCING:** German Financial Cooperation through KfW Development Bank
**REQUESTEDCONSULTINGSERVICES:**
The Consultant will provide assistance to KESH-PMU in activities pertaining to the implementation of the Project. The Scope of Works will be the following:
**1**.Pre-construction services, including the preparation of preliminary design works as well as tendering process for the DMDC,
**2**.Assistance in Project Management,
**3**.Reviewing of Contractor's output,
**4**.Supervision of Contractor´s works at site,
**5**.Monitoring Contractor´s Health and Safety System and Environmental Protection Plan,
**6**.Inspections at Manufacturer´s site of main components,
**7**.Assistance to correct all deficiencies within the Defects Liability Period,
**8**.Reporting.
The works to be performed in the framework of the Project are complex and require interdisciplinary experience in the following fields of engineering:·
- Digital Control, Protection and Metering Engineering Expert (Project Manager), ·
- Telecommunications and SCADA Expert, ·
- Electrical/ Mechanical Expert, ·
- Geologist/ Seismic Expert, · Hydrology/ hydro-technical Expert, ·
- Civil/Survey engineering Expert, ·
- Procurement, Finance and Contract Administration Expert,·
- Commissioning/Quality Control Expertise, ·
- HSE Manager

The Project Manager shall have at least 15 years of professional experience in similar projects. The other specialists must have at least 10 years of professional experience in the requested fields.
The Consultant's Services shall continue for a period of 18 months. The Consultant will work closely with his local counterparts in the PMU. Services will be carried out mainly in Albania (Tirana and at the Project sites during the implementation phase).
This prequalification for consulting services will be guided by the latest version of the "Guidelines for the Assignment of Consultants in Financial Cooperation with Partner Countries" (refer to the home page of KfW Development Bank www.kfw-entwicklungsbank.de). It is foreseen to assign the services to an independent consultant firm having participated in modernization and rehabilitation of HPP and with profound experience in the design and operation of SCADA systems preferably in Europe The minimum annual turnover shall be not less than EUR 1.5 million for the last 3 years. The Invitation for Expression of Interest will be made available upon request by Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a. (KESH) under the following address:

**KESH:**Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a. ("KESH")
Att.: Mr. Fatos Bundo (Head of PMU)
Blloku "Vasil Shanto", Tiranë, Shqipëri
Albania
**Phone :** +355 4 2262148
**Mobile** +355 69 40 42 518
**Fax :** +355 4 2262148
**E-mail** : bundof@kesh.al

## Të riut iu gjet dhe drogë në banesë

# I gjenden mina me sahat në makinë, arrestohet 26-vjeçari



**VLORË** - Një 26-vjeçar nga Vlora ka përfunduar në pranga, pasi i janë gjetur dhe sekuestruar dy mina me sahat si dhe kanabis sativa. Bëhet fjalë për Roberto Hodajn, banues në qytetin bregdetar, i cili u arrestua dje në flagrancë gjatë operacionit të kodur "Packages". Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së Qarkut të Vlorës bënë me dije se Hodaj u kap, pasi gjatë kontrollit të ushtruar në automjetin tip "Benz ML", që përdorej prej tij i janë gjetur dy mina me sahat. Gjithashtu, mësohet se gjatë kontrollit të banesës, e cila përdorej prej tij, në lagjen "Rilindja", në dhomën e gjumit iu gjetën dhe iu sekuestruan nga policia 7 kg lëndë narkotike e mbështjellë me qese të zezë. 26-vjeçarit i janë sekuestruar dhe makina si dhe celularë. Ndërkaq, policia dhe prokuroria e Vlorës po vijojnë hetimin me metoda speciale dhe proaktive për dokumentimin e plotë të kësaj veprimtarie kriminale. Materialet hetimore i kaluan prokurorisë Vlorë për veprime të mëtejshme. Pritet që Gjykata e Shkallës së Parë e Vlorës të vendosë masën e sigurisë ndaj Roberto Hodajt.

## S'mbikëqyrën punimet e një objekti

# Rreziku i shembjes së pallatit, procedohen 2 zyrtarë të bashkisë

**GJIROKASTËR** - Prokuroria e Gjirokastrës ka nisur procedimin penal për dy zyrtarë të bashkisë, pasi akuzohen se nuk mbikëqyrën punimet e objektit disa metra larg pallatit 5-katësh në lagjen "Punetore", i cili rrezikon të shembet nga rrëshqitja e tokës dhe të lërë në qiell të hapur 15 familje. Zyrtarët e paditur janë: Vullnet Tola, përgjegjës i Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor (INUV) dhe Aleksandër Pesha inxhinier në zyrën e bashkisë. Burime zyrtare nga organi i akuzës bënë me dije se ata akuzohen për shpërdorim detyre. Gërmimet e bëra për ndërtimin e një muri pranë pallatit dhe një vile 3 katesh dyshohet se janë shkaku për rrëshqitjen e tokës që rrezikon familjet.Ndërkohë, në raportin e gjeologeve parashikohen ndërhyrje me mure mbrojtëse për të shmangur avancimin e rrëshqitjeve të tokës. Gjithashtu, zona do jetë nën monitorim të vazhdueshëm. Pas situatës së krijuar, disa nga familjet e pallatit 5 katesh janë sistemuar te të afërmit e tyre dhe në hotele, ndërsa zona ku ka rrëshqitje dheu është rrethuar si pikë rreziku.

## SHKURT

### Vrasja e dy motrave në Zvicër, kushëriri: Nuk duam hakmarrje

**LEZHË** - Trupat e pajetë të dy motrave Frroku, të cilat u vranë në Zvicër nga burri i njërës prej tyre, kanë mbërritur dje në Lezhë. Ngjarja e rëndë ka ndodhur në Hausen të Kantonit Aargau në Zvicër më 8 janar. Sipas policisë vendase, 54-vjeçari R.B. akuzohet se vrau gruan e tij Alma B, 38 vjeç dhe motrën e saj Eldën, 31 vjeç. Kjo e fundit kishte shkuar nga Franca ku jetonte prej vitesh, për të kaluar festat e fundvitit tek e motra, por aty gjeti vdekjen e dhunshme. Familjarët e viktimave kanë hapur dyert e mortit në banesën e tyre në Lezhë. Kushëriri i viktimave u shpreh se nuk kërkojnë hakmarrje, por kanë besim se shteti zviceran do të zbardhë ngjarjen.

### Prostitucioni , kapet i shumëkërkuari me tre emra

**ELBASAN** - Policia e Elbasanit ka arrestuar një 49-vjeçar, pasi drejtësia italiane e ka dënuar me 6 vite e 6 muaj burg për kryerjen e disa veprave penale. Në pranga ka përfunduar Artur Llupa, i cili ishte në kërkim ndërkombëtar dhe rezulton me 3 emra të ndryshëm. Sipas policisë, Artur Llupa, (alias Luan Tabaku alias Robert Cani), banues në këtë qytet u kap në lagjen "5 Maji", pasi më datë 16.01.2018 ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar, nga Interpol Roma, Itali. Mësohet se Autoritetet Gjyqësore në Torino, Itali, me datë 07.12.2017 e kanë dënuar atë me 6.6 vjet burg për veprat penale: "Shfrytëzim Prostitucioni", "Plagosje" dhe "Mbajtja pa leje e armëve të zjarrit".

### Sherr mes fqinjëve, 55-vjeçari plagos me çifte të riun

**KUKËS** - Një sherr mes fqinjëve ka çuar në plagosjen e një të riu në fshatin Gjinaj të Hasit. Sipas të dhënave zyrtare, ngjarja ka ndodhur dje. ku ka mbetur i plagosur me armë gjahu 28-vjeçari me iniciale A.B.. Pas marrjes së njoftimit për plagosjen, policia ka shkuar në vendngjarje, ku nga hetimet paraprake ka rezultuar se 55-vjeçari Zek Asllanaj, banues në Gjinaj pas një konflikti për motive të dobëta ka plagosur me çifte në bark shtetasin A.B.. Ndërkaq, policia ka bërë të mundur identifikim dhe kapjen e autorit. I plagosuri ndodhet në spitalin e Kukësit jashtë rrezikut për jetën, ndërsa grupi hetimor po punon për dokumentin e plotë të ngjarjes.

## "Dritan Gina zëvendësoi prokuroren Armanda Xhaferi që po hetonte"

# Mashtrimi me TVSH, prokuroria çon në gjykatë dosjen për kompaninë "Kurum"

## *Falsifikuan faturat tatimore për blerje skrapi nga 4 shoqëri të tjera në Laç, Fushë-Krujë, Tiranë e Kavajë*

**ELBASAN**

Prokuroria e Elbasanit ka dërguar në gjykatë dosjen e administratorittë "KURUM", Koray Zeytinoglu; drejtorit të blerjeve në këtë kompani, Yücel AKSU si dhe vetë kompaninë turke. Nga hetimet e kryera nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan ka rezultuar e provuar se përgjatë dy viteve 2011-2012, të pandehurit: Koray Zeytinoglu dhe Yücel Aksu, kanë organizuar dhe zbatuar një skemë mashtruese lidhur me blerjen e lëndës skrap. Kompania më e madhe e prodhimit të hekurit në vend, "Kurum" akuzohet për 'Mashtrim' në bashkëpunim me pasoja të rënda si dhe për 'Pastrim të produkteve të veprës penale'. Mësohet se dosja në gjykatë është dërguar nga prokurorja, Armanda Xhaferi, të cilës ish-drejtuesi i komanduar i prokurorisë së Elbasanit, Dritan Gina ia hoqi çështjen nga hetimi.

**NJOFTIMI I PROKURORISË**

1. Koray ZEYTINOGLU, i datëlindjes 17.06.1977, me shtetësi turke dhe shqiptare, i cili ka pasur detyrën e administratorit të shoqërisë tregtare "KURUM INTERNATIONAL" SH.A, në kohën e aktivitetit kriminal 2011-2012;

i akuzuar për kryerjen e veprave penale të:

1) "Mashtrimit" të kryer në bashkëpunim, më shumë se një herë, dhe me pasoja të rënda, të parashikuar nga neni 143, pikat 2 dhe 3 të K.Penal, si dhe

2) "Pastrimit të produkteve të veprës penale", të kryer gjatë ushtrimit të një veprimtarie profesionale, në bashkëpunim, më shumë se një herë, dhe me pasoja të rënda, të parashikuar nga neni 287, pika1, germa (a), dhe pika 2, të K.Penal.

1.Yücel AKSU, i datëlindjes 09.01.1982, me shtetësi turke dhe shqiptare, i cili ka pasur detyrën e Drejtorit të Blerjeve të shoqërisë tregtare "KURUM INTERNATIONAL" SH.A, në kohën e aktivitetit kriminal 2011-2012;

I akuzuar për kryerjen e veprës penale të:

1) "Mashtrimit" të kryer në bashkëpunim, më shumë se një herë, dhe me pasoja të rënda, të parashikuar nga neni 143, pikat 2 dhe 3 të K.Penal,

si dhe ndaj

2. shoqërisë tregtare "KURUM INTERNATIONAL" SH.A, me NIPT K02727230T, aktualisht me zyrë qendrore: Tiranë, Njësia Administrative Nr.5, rruga "Ibrahim Rugova", pallati nr.14 KT, "Green Park", apartamenti nr.39, kati 6.

E akuzuar për kryerjen e veprave penale të:

1) "Mashtrimit" të kryer në bashkëpunim, më shumë se një herë, dhe me pasoja të rënda, të parashikuar nga neni 143, pikat 2 dhe 3 të K.Penal, si dhe

2) "Pastrimit të produkteve të veprës penale", të kryer gjatë ushtrimit të një veprimtarie profesionale, në bashkëpunim, më shumë se një herë, dhe me pasoja të rënda, të parashikuar nga neni 287, pika1, germa (a), dhe pika 2, të K.Penal.

Nga hetimet e kryera nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan ka rezultuar e provuar se, përgjatë dy viteve 2011-2012, të pandehurit Koray ZEYTINOGLU dhe Yücel AKSU, duke vepruar përkatësisht në detyrën e Administratorit dhe Drejtorit të blerjeve të shoqërisë "KURUM INTERNATIONAL" SH.A, kanë organizuar dhe zbatuar një skemë mashtruese lidhur me blerjen e lëndës skrap. Konkretisht, nga hetimet ka rezultuar se faturat tatimore të blerjes së lëndës skrap nga shoqëria "KURUM INTERNATIONAL" SH.A prej 4 shoqërive të tjera "Kurbini" sh.p.k me qendër në Laç, "ERAD&XHT" sh.p.k me qendër në Tiranë, "R&B 2011", sh.p.k me qendër në Fushë-Krujë, dhe "Kavaja-CO" sh.p.k me qendër në Kavajë, janë të falsifikuara pasi këto shoqëri nuk kanë ushtruar asnjëherë aktivitet skrapi. Dy të pandehurit Yücel AKSU dhe Koray ZEYTINOGLU, në cilësinë e përfaqësuesve të shoqërisë "KURUM INTERNATIONAL" SH.A, përkatësisht, kanë nënshkruar dhe më pas depozituar, të dhënat mbi këto fatura tatimore të falsifikuara, pranë Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë dhe mbi bazën e këtyre dokumenteve të falsifikuara shoqëria "KURUM INTERNATIONAL" SH.A ka përfituar në mënyrë të kundërligjshme nga skema e rimbursimit me TVSH-në. Gjatë hetimeve ka rezultuar se ky aktivitet kriminal i përfaqësuesve të shoqërisë "KURUM INTERNATIONAL" SH.A është kryer edhe me shoqëri të tjera me qendër në Tiranë dhe në Durrës. Theksojmë se procedimi i mësipërm është një prej procedimeve, për të cilat u zëvendësua prokurorja Armanda Xhaferi, nga ishtitullari i Prokurorisë Elbasan, Dritan Gina.




**HETIMI**

Nga hetimet ka rezultuar se faturat tatimore të blerjes së lëndës skrap nga shoqëria "KURUM INTERNATIONAL" SH.A prej 4 shoqërive të tjera "Kurbini" sh.p.k me qendër në Laç; "ERAD&XHT" sh.p.k me qendër në Tiranë; "R&B 2011", sh.p.k me qendër në Fushë-Krujë dhe "Kavaja-CO" sh.p.k me qendër në Kavajë, janë të falsifikuara, pasi këto shoqëri nuk kanë ushtruar asnjëherë aktivitet skrapi.

Dokumentet që duhen dorëzuar në Agjencinë e Trajtimit të Pronave për të marrë paratë

# Nis sot kompensimi për 450 pronarë

## Fondi 300 mln lekë, përfituesit në Durrës, Elbasan, Tiranë, Korçë, Fier, Vlorë e Shkodër

Ornela Manjani



Nis sot procesi për kompensimin e pronarëve që u është zënë toka nga ndërtimet pa leje. Vlera në total e kompensimit arrin në afro 300 milionë lekë. Përfituesit duhet të plotësojnë shtatë dokumente, të cilat duhet t'i dorëzojnë në Agjencinë e Trajtimit të Pronave duke filluar nga sot. Mësohet se përfituesit do të jenë në qarkun Dibër, Durrës, Elbasan, Tiranë, Korçë, Fier, Vlorë dhe Shkodër. "Procesi i pranimit të kërkesave të subjekteve përfituesve do të fillojë në datën 18.01.2018 dhe nuk do të jetë i kushtëzuar dhe i kufizuar në kohë. ATP fton të gjitha subjektet e interesuara të paraqiten pranë zyrave të saj, në adresën Rruga "Muhamet Gjollesha", Nr. 54, Tiranë, çdo ditë nga e hëna në të premte për plotësimin e kërkesës për kompensim dhe dorëzimin e dokumenteve përkatëse", -thuhet në njoftimin e ATP-së.

### PRANIMI I KËRKESAVE

Me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të ATP-së ngrihet grupi i punës për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave, me objekt shpërblimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimet informale dhe shpërndarjen e fondit përkatës. Grupi i punës brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për kompensimin e pronës kryen verifikimet e duhura. Drejtori i përgjithshëm i ATP-së brenda 30 ditëve nga data e përfundimit të procesit të verifikimit nga grupi i punës nxjerr vendimin me emrat e subjekteve që përfitojnë nga kompensimi dhe urdhëron publikimin e listës së subjekteve që kompensohen. Gjithashtu, ai njofton edhe aplikantët që nuk përfshihen në listën e subjekteve që kompensohen, duke përcaktuar arsyet e mospërfshirjes.


FORMULAR APLIKIMI
KOMPENSIM FINANCIAR PËR PRONARËT E PASURIVE TË PALUAJTSHME
QË PREKEN NGA LEGALIZIMI I NDËRTIMEVE INFORMALE
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE
MINISTRIA E DREJTËSISË

Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni:
Tel: (+355) 42 22 56 831 / 38
E-mail: info.atp@atp.gov.al
Web: www.atp.gov.al
Shënim: Ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë, ME SHKRONJË TË MADHE E NË NGJYRË BLU.
HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN

SEKSIONI A: INFORMACION MBI APLIKANTIN
1. Emri
2. Mbiemri
3. Emri i Babait
4. NID Nr. i identifikimit personal
5. Gjinia Mashkull Femër
6. Datëlindja Data Muaji Viti
7. Vendlindja
8. Shtetësia
9. Adresa
10. Qyteti
11. Rrethi
12. Kodi Postar
13. E-mail
14. Nr. Tel. Celular
15. Nr. Tel. Fiks

SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN
16. Subjekti përfitues
Emri — Emri i Babait
Mbiemri
Emri — Emri i Babait
Mbiemri
Emri — Emri i Babait
Mbiemri
Emri — Emri i Babait
Mbiemri
Emri — Emri i Babait
Mbiemri
Emri — Emri i Babait
Mbiemri
Emri — Emri i Babait
Mbiemri
Emri — Emri i Babait
Mbiemri

### DOKUMENTET

Subjekti apo përfaqësuesi i tij me prokurë duhet të paraqesë pranë ATP-së, Tiranë, kërkesën TIP që i vihet në dispozicion nga grupi i punës pranë AKKP-së, të plotësuar sipas rubrikave. Në listën e dokumenteve është dëshmia e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfitues, sipas radhës së trashëgimtarëve, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil. Sipas ligjit për dëshmitë e trashëgimive të lëshuara nga gjykata për testamentin e bërë me akt noterial duhet të sillet certifikatë familjare e personit për të cilin është lëshuar kjo dëshmi. Një tjetër dokument është prokura e posaçme, e nënshkruar nga të gjitha subjektet që përfitojnë kompensim. Në rastin e kërkesave individuale të secilit bashkëpronar apo të një pjese të tyre, për çdo aplikim të kryer paguhet tarifë shërbimi në vlerën 2 000 lekë, pavarësisht se i përket të njëjtës pasuri të paluajtshme.

**DOKUMENTET**

1. Kërkesa për kompensimin e pronës, sipas formatit TIP, që i vihet në dispozicion nga ATP.
2. Dëshminë e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfitues, sipas radhës së trashëgimtarëve, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil.
3. Prokurën e posaçme të nënshkruar nga të gjitha subjektet që përfitojnë kompensim, ku si tagër i nevojshëm të jetë edhe e drejta për të tërhequr vlerën financiare në emër të tyre. (Në rastet kur nuk është e mundur të dorëzohet prokura e posaçme, secili bashkëpronar apo një pjesë e tyre paraqesin kërkesë individuale apo të përbashkët për pjesën takuese në pronën që kompensohet. Në rastin e kërkesave individuale të secilit bashkëpronar apo të një pjese të tyre, për çdo kërkesë të kryer paguhet tarifë shërbimi në vlerën 2 000 (dymijë) lekë, pavarësisht se i përket të njëjtës pasuri të paluajtshme);
4. Vërtetimin origjinal i lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë për hapjen e llogarisë bankare në emër dhe për llogari të subjektit përfitues, ku përcaktohet edhe numri i llogarisë bankare (IBAN), ku do të transferohet vlera financiare e përfituar.
5. Fotokopje e dokumentit të identifikimit;
6. Mandat pagesa që vërteton pagimin e tarifës së shërbimit në vlerën 2 000 (dymijë) lekë.

| Kompensimi i Pronarëve | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Emër | Atësi | Mbiemër | Nr. i pasurisë | Masa e kompensimit (m²) | Çmimi (leke/m²) | Shuma - Vlera e kompensimit (lek) | Seksioni i Veçantë |
| 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | 16 (16=14*15) | 17 |
| MURAT | MAHMUT | QAFLESHI | | | | | |
| ABDULLAH | | QAFLESHI | | | | | |
| AZMI | | QAFLESHI | 2/236 | 279,4 | 12.764 | 3.566.261,60 | |
| NIAZI | YMER | HOXHA | 12/237 | 27,8 | 12.764 | 354.839,20 | |
| BAJRAM | MEDI | TERA | | | | | |
| DIK | | TUSHA | | | | | |
| SULEJMAN | VELI | FACI | | | | | |
| KADRI | | TUSHA | 109/14 | 500 | 284 | 142,000 | |
| | | | | | | | |
| DALIP | KADRI | BAKALLI | | | | | |
| DRITAN | SADIK | CENGELI | | | | | |
| FATUSH | | BAKALLI | | | | | |
| NASHIFER | | BAKALLI | | | | | |
| MELEQ | | BAKALLI | | | | | |
| KADESHE | | BAKALLI | | | | | |
| MUSA | | BAKALLI | | | | | |

| Kompensimi i Pronarëve | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Emër | Atësi | Mbiemër | Nr. i pasurisë | Masa e kompensimit (m²) | Çmimi (leke/m²) | Shuma - Vlera e kompensimit (lek) | Seksioni i Veçantë |
| 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | 16 (16=14*15) | 17 |
| SHEJNAZ | | BAKALLI | | | | | |
| BURBUQE | | BAKALLI | 1372/7 | 183,40 | 12.764 | 2.340.917,60 | |
| | | | | | | | |
| | | | | 361,70 | | 4.616.738,80 | |
| | | | | 152,20 | | 1.942.680,80 | |
| | | | | 287,60 | | 3.670.926,40 | |
| | | | | 302,80 | | 3.864.939,20 | |
| | | | | 111,70 | | 1.425.738,80 | |
| | | | | 331,40 | | 4.229.989,60 | |
| MERJEME | ADEM | HUTA | 1415/99 | 127,91 | 12.764 | 1.632.643,24 | |
| HASAN | | BEBETI | 1415/5 | 173,05 | 12.764 | 2.208.810,20 | |
| FLORA | XHAFERR | HASEKIU(UCI) | | | | | |
| FISNIK | XHAFERR | HASEKIU | | | | | |
| ENGJELL | XHAFERR | HASEKIU | | | | | |
| FEIME | SKENDER | HASEQIU | | | | | |
| MARSELA | BARDHUL | HASEQIU | 1415/258 | 225,90 | 12.764 | 2.883.387,60 | |

VENDIMI

# ERZEN SHKOLOLLI

## Një drejtor për dy shtete, nga Galeria e Kosovës në krye të Galerisë së Shqipërisë

Fatmira Nikolli

Erzen Shkololli është drejtori i ri i Galerisë Kombëtare të Arteve të Shqipërisë. Pas katër vitesh në këtë detyrë, Artan Shabani do i dorëzojë detyrën Shkolollit, më herët ish-drejtor i Galerisë Kombëtare të Arteve në Kosovë. Prej muajsh emri i tij ka qenë më i përfoluri për postin në fjalë dhe për dy arsye: e para, sepse Shkololli është shumë i përfshirë në skenën e artit bashkëkohor ndërkombëtar, jo vetëm si ish-drejtor i GKK-së në Prishtinë, por edhe si kurator në disa ekspozita ndërkombëtare të dorës së parë, si "documenta". E dyta, sepse marrëdhëniet e tij me qeverinë shqiptare janë të kahershme. Zanafilla e këtyre marrëdhënieve shënohet prej kohës kur ai ishte në krye të GKK-së së Kosovës. Madje, si i tillë, ai ka ardhur me ekspozitë edhe në GKA-në e Shqipërisë, kur nga Kosova sillej ekspozita e Simon Shirokës.

Ka qenë një vendim qeverie i ditës së mërkurë, që e ka emëruar Erzen Shkolollin, i cili nga ana tjetër nuk është i panjohur në selinë e Këshillit të Ministrave. Ai ka hapur sezonin e tretë të vitit 2016 në COD- Qendra për Hapje e Dialog në Kryeministri. Sezoni titullohej "Të dialogosh me prani", ndërsa ekspozita i shtonte këtij titulli një konstatim "Duke qëndruar pezull"... Në rolin e kuratorit, ai pat ftuar në COD, artistët Flaka Haliti nga Kosova, Laurent Mareschal (Francë), Nathan Coley (Mbretëri E Bashkuar), Peter Kogler (Austri) dhe Vigan Nimani (Kosovë).

**POR, KUSH ËSHTË ERZEN SHKOLOLLI?**

Erzen Shkololli është artist dhe kurator, drejtor i Fondacionit "Unë e du Kosovën" në Prishtinë, Kosovë. Gjithashtu, ka qenë këshilltar kuratorial për 'documenta 14'. Ka qenë drejtor i Galerisë Kombëtare të Kosovës nga viti 2011 deri më 2015. Në vitin 2013, Shkololli ishte komisioner i prezantimit të parë të Republikës së Kosovës në edicionin e 55-të të Bienales së Venecias. Nga viti 2003 deri më 2007 mbajti pozitën e drejtorit artistik në Institutin e Artit Bashkëkohor EXIT në Pejë, një iniciativë e shkëmbimit në Kosovë, e cila e transformoi skenën kulturore vendëse. Praktika e tij artistike përdor ritualet dhe folklorin vendës për të tërhequr vëmendjen te situata specifike socio-politike dhe është ekspozuar ndërkombëtarisht në muze, siç janë Van Abbemuseum, Eindhoven; Centre Pompidou, Paris dhe Fridericianum, Kassel.

Shkololli organizoi Ekspozitën e Kontakt Art, të titulluar "Thirty One" (Tridhjetë e një) dhe kuruar nga Hans Ulrich Obrist e Petrit Halilaj në Galerinë Kombëtare të Kosovës (2015). Ishte kurator i "Thirty Years After: Šejla Kameri?"(2015), "Sokol Beqiri: Retrospektivë" (2014), "Simon Shiroka: Retrospektivë" në Galerinë Kombëtare në Tiranë (2014) dhe në Galerinë Kombëtare të Kosovës (2013); bashkëkurator i ekspozitës "Engjëll Berisha - Befre: Retrospektivë" (2013) dhe "Grafika" nga koleksioni i GKK-së (2013).



Gusht, 2013 Rama me Shkolollin në Prishtinë



Tetor 2016, Kumbaro me Shkolollin në Tiranë



2014, drejtori që ikën Artan Shabani me drejtorin Shkololli që vjen në Tiranë

*Kush është kosovari në krye të institucionit kryesor të artit pamor në vend*

Nga viti 2008 deri më 2009 ishte përfitues i Bursës së DAAD-së për Artistët në Rezidencë. Nga viti 2003 është anëtar i Parlamentit Europian të Kulturës.

Artan Shabani erdhi në krye të GKA-së në vitin 2013, nga Italia ku jetonte. Pas katër vitesh ai i lë detyrën, ish-homologut të tij në Kosovë. Ndryshe prej epokës së Shabanit, ku qeveria la Galerinë Kombëtare pa asnjë mbështetje duke qenë se fokusi i saj ishte te Muzeu Marubi, Teatri "Migjeni", Muzeu i Ikonave në Korçë, Teatri i Korçës, Shtëpia me gjethe, etj., në këtë 4-vjeçar, GKA si edhe Muzeu Historik e Biblioteka Kombëtare do jenë në fokus të investimeve.

## VITI I SKËNDERBEUT, IPESHKVIJTË KATOLIKË: NUK I PËRKET VETËM NJË FEJE...

*"Papa thoshte se heroi i meritoi lëvdatat më shumë nga të gjithë princat katolikë"*

Me rastin e Vitit mbarëkombëtar kushtuar Gjergj Kastriotit Skënderbeut, në 550-vjetorin e vdekjes, ipeshkvijtë katolikë të Shqipërisë u kanë drejtuar shqiptarëve një mesazh. Mes të tjerash, ata shtrojnë një sërë pyetjesh për të sotmen: "A ndjehemi vërtetë të lirë, pas 27 vjetësh nga rënia e komunizmit? Çfarë na shtyp akoma? Cilat janë frikërat tona? Pse kaq vonesa për të hyrë në Bashkimin Europian, një ëndërr që na shoqëron gjithmonë? Pse nuk e duam atdheun tonë si etërit tanë që vdiqën për të, por ne duam të ikim prej tij? Kush janë armiqtë tanë sot kundër të cilëve duam të luftojmë e t'i mundim së bashku: varfëria, zhvillimi i pabarabartë i shoqërisë sonë, korrupsioni, analfabetizmi, etj.? Kemi nevojë për një hov të fortë "ndershmërie" dhe "meritokracie" nga ana e të gjithëve për të mirën e kombit tonë".




Ipeshkvit e Shqipërisë

Në të njëjtin mesazh, ipeshkvijtë thonë se kur, para pesëdhjetë viteve, shqiptarët të shpërndarë në shumë vende kremtonin pesëqind vjet nga vdekja e heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, Papa Pali VI shkroi një letër në të cilën tha se Skënderbeu "... ishte biri i lavdishëm i një toke që pati fatbardhësinë të ishte pjesë

➔

TRASHEGIMIA



# Forumi i Trashëgimisë:

## Gjirokastra në listë rreziku, alarmante e fatale

Fatmira Nikolli

Ka reaguar edhe Forumi për Mbrojtjen e Trashëgimisë kulturore sa i takon alarmit të ngritur për sitin e Gjirokastrës, si një ndër 7 monumentet që mund të futen në listën e rrezikut nga "Europa Nostra".

Përmes një deklarate për mediat, Forumi thotë se zëri i tyre ka rënë në vesh të shurdhër për gjendjen e monumenteve në sitin e mbrojtur nga UNESCO.

"Përkundër mendimit tonë që gjendja në Gjirokastër është alarmante dhe po shkon drejt një pike fatale, ministria ka vijuar të trumbetojë me të madhe që Gjirokastra tashmë ka dalë nga gjendja e emergjencës dhe ka hyrë në një fazë të re, atë të 'rijetëzimit'. Ky mendim për ne është i gabuar", - thuhet ndër të tjera në deklaratë.

Forumi, një grupim vullnetar intelektualësh dhe aktivistësh publikë të bashkuar përtej bindjeve politike për të mbrojtur trashëgiminë kulturore risjellë në vëmendje listën e shkurtër të 'EUROPA NOSTRA'-s, me 12 sitet më të rrezikuara të trashëgimisë në Europë. Siç "Gazeta Shqiptare" raportonte në numrin e saj të djeshëm, në dy vendet e para të kësaj liste ishin dy site nga Shqipëria, Gjirokastra në vendin e parë dhe kishat pasbizantine të Voskopojës e Vithkuqit në vendin e dytë. Për sa më sipër, ditën e martë, Ministria e Kulturës rikujtoi të gjitha restaurimet e bëra në Voskopojë, Viothkuq dhe risolli në vëmendje ndërhyrjet në Gjirokastër, sikundër edhe listën me 18 objekte ku do ndërhyhet sivjet sipas projekteve të miratuara këtë javë nga Instituti i Monumenteve të Kulturës.

> Kumbaro: Gjirokastra që duam? Asnjë shtet nuk mund të investojë për të restauruar prona private, që më pas nuk mirëmbahen

**REAGIMI I KUMBAROS**

Po të martën, përmes një postimi në profilin e saj në "Facebook, ministrja Mirela Kumbaro, tha se "Gjirokastra", që duam është Gjirokastra ku ndërtohet çdo ditë, ku merr vlerë e jetë shprehja 'gur-gur bëhet mur'. Kjo do kohën e vet, se 30 vite harresë nuk rikuperohen në 4 vjet, por në 4 vjet Gjirokastra ka vëmendjen e qeverisë, partnerëve ndërkombëtarë, donatorëve dhe sidomos të atyre që e duan vërtetë Gjirokastrën, jo për sot, por për përgjithmonë"!

Kumbaro shtonte se rezultat i punës shumëmujore të specialistëve të Institutit të Monumenteve dhe të Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e tij të fundit, miratoi mbi 18 projekte restaurimi të banesave më të rrënuara, por edhe domethënëse të qendrës historike, banesa të komplikuara për nga pronësia, vendndodhja dhe degradimi disa dhjetëra vjeçar".

Me këtë rast, ajo ka ftuar pronarët, investitorët, apo trashëgimtarët, nëse e duan vërtetë pronën e tyre, shtëpinë e tyre, shtëpinë e gjyshërve, të bëhen partnerë të Ministrisë së Kulturës, në rimëkëmbjen e shtëpive të tyre dhe të trashëgimisë kulturore.

"Asnjë shtet nuk mund të shpenzojë pa fund paratë e taksapaguesve për të restauruar vetëm prona private, që më pas as nuk mirëmbahen, por rrënohen sërish. Banesat - pasuri kulturore, janë një mundësi shumë e mirë për t'i rijetëzuar në bujtina, restorante, qendra shërbimi dhe të tjera aktivitete private fitimprurëse. Çdo propozim është i mirëpritur! Projektet e restaurimit janë gati!", e mbyllte ajo reagimin e saj.

**REAGIMI I FORUMIT**

"Forumi ynë ka qenë shumë i vëmendshëm karshi gjendjes së monumenteve në Gjirokastër përgjatë kohëve të fundit", shkruhet në deklaratë. Shtohet se duke filluar nga data 12 shkurt 2016, "ne filluam botimin e mjaft fotove nga gjendja e monumenteve në këtë qytet, duke kërkuar të arrinim si sensibilizimin e qytetarëve, opinionit publik, të aktorëve që veprojnë në fushë, por në radhë të parë të atyre që janë përgjegjës për mbrojtjen, konservimin dhe restaurimin e monumenteve, DRKK Gjirokastër, Institutin e Monumenteve të Kulturës dhe vetë Ministrinë e Kulturës". Forumi thotë se mjaft prej anëtarëve të vet kanë hedhur idenë dhe kanë bërë thirrje që gjendja në vend është alarmante, ndaj kanë sugjeruar që Ministria e Kulturës të shihte mundësinë për të bërë një takim me aktorët e fushës në vend, pikërisht në Gjirokastër dhe për t'i bërë atje diskutimet. "Zëri ynë, si edhe për shumë çështje të tjera në fushën e trashëgimisë ra në vesh të shurdhët. Përkundër mendimit tonë që gjendja në Gjirokastër është alarmante dhe po shkon drejt një pike fatale, ministria ka vijuar të trumbetojë me të madhe që Gjirokastra tashmë ka dalë nga gjendja e emergjencës dhe ka hyrë në një fazë të re, atë të 'rijetëzimit'. Ky mendim për ne është i gabuar", thotë Forumi.

Mandej, kujton se më 16.01.2018, një organizatë ndërkombëtare prestigjioze në fushën e trashëgimisë, "Europa Nostra", shpalli një listë me 12 sitet më të rrezikuara të trashëgimisë në Europë. "Për fat të keq në dy vendet e para listoheshin dy site nga Shqipëria, Gjirokastra në vendin e parë dhe kishat pasbizantine të Voskopojës e Vithkuqit në vendin e dytë. 'Europa Nostra' gjithashtu jepte edhe rekomandimet e saj kryesore për këto site. Sugjerimet janë bërë nga aktorë vendorë (për pikën e parë nga Fondacioni 'Gjirokastra', dhe për pikën e dytë nga Fondacioni 'E Shkuara Për Të Ardhmen'), por gjykimi dhe vlerësimi është bërë nga një komision i gjerë ndërkombëtar. Nga kjo shortlistë do të përzgjidhen më pas 7 sitet më të rrezikuara dhe do të shpallen në datën 15 mars nga 'Europa Nostra'", nënvizon Forumi.

E mbyll deklaratën për mediat me shpresën "që ky qëndrim i Europa Nostra, bashkuar edhe me mjaft reagime të aktorëve vendorë (ku Forumi ynë është një prej tyre) të jetë një tërheqje vëmendjeje për organizmat tona shtetërore, që operojnë në fushën e trashëgimisë. Shpresojmë që Ministria e Kulturës të dalë nga guaska e vetëkënaqësisë ku është mbyllur dhe të fillojë të jetë më bashkëpunuese me aktorët dhe faktorët vendorë, si dhe me ata ndërkombëtarë. Ne i qëndrojmë mendimit që trashëgimia jonë duhet parë me tjetër vizion".

---

← e programit apostolik të Shën Palit, ku mbolli ndoshta rishtazi farën e Ungjillit". Në mesazh, shënohet se Papa shtonte: "Pararendësit tanë e mbuluan me elozhe më tepër se çdo hero të asaj epoke. Ai arriti të ruante për njëzet e pesë vjet prej pushtimit atdheun e tij, i cili ishte pika me e brishte e sistemit mbrojtës të krishterimit. Për këtë arsye, pararendësi ynë, Kaliksti III, duke pasur parasysh devocionin dhe atashimin ndaj Selisë apostolike të këtij kapedani, tha për të me të drejtë se 'ai kishte merituar më shumë nga të gjithë princat katolikë lëvdata për nder të besimit dhe fesë katolike". Citimi i Papës, në kuadër të debateve që mbahen për besimin fetar të Skënderbeut, duket interesant.

Por, teksa vihet në dukje se Skënderbeu, me shumë kurajë e forcë i bëri ballë njërës prej perandorive më të forta e gjakatare të kohës, nuk harroi rrënjët e tij shoqërore dhe shpirtërore, as u josh nga pushteti që i jepej. "Si i tillë Skënderbeu nuk i përket vetëm një grupi njerëzish, një krahine apo një feje, por të gjithë atyre që e ndjekin lirinë si një aspiratë të brendshme për të cilën ia vlen çdo sakrificë".

**MBI LIRINË**

Në 550-vjetorin e vdekjes së tij, ipeshkvijtë gjejnë rastin të të ftojnë për një çast reflektimi për aspiratat e lirisë së popujve dhe të njeriut si individ. "Liria është ndër të drejtat më thelbësore të një populli, të grupeve shoqërore dhe të individëve. Thënia lapidare që i atribuohet Skënderbeut në momentin e mbërritjes së tij në trojet arbërore, se lirinë nuk e kishte sjellë, por e kishte gjetur aty, tregon se liria i rri natyrshëm çdo njeriu dhe çdo populli", thuhet në mesazh. "Çdokush që lufton për lirinë e një populli në fakt promovon atë çka i përket në thelb natyrës njerëzore dhe që e bën bashkëjetesën njerëzore më të mundshme dhe të bukur", thuhet në mesazhin e Konferencës Ipeshkvore. Kjo e fundit, teksa falënderon kryeministrin për shpalljen e një viti jubilar për Gjergj Kastriotin Skënderbeun, thotë se duhet t'i drejtojmë vetes këto pyetje: Sot a ndjehemi vërtetë të lirë, pas 27 vjetësh nga rënia e komunizmit? Çfarë na shtyp akoma? Cilat janë frikërat tona? Pse kaq vonesa për të hyrë në Bashkimin Europian, një ëndërr që na shoqëron gjithmonë? Pse nuk e duam atdheun tonë si etërit tanë që vdiqën për të, por ne duam të ikim prej tij? Kush janë armiqtë tanë sot, kundër të cilëve duam të luftojmë e t'i mundim së bashku: varfëria, zhvillimi i pabarabartë i shoqërisë tonë, korrupsioni, analfabetizmi, etj.? Kemi nevojë për një hov të fortë "ndershmërie" dhe "meritokracie" nga ana e të gjithëve për të mirën e kombit tonë.

Mesazhi mbyllet me njoftimin se dje u mbajt një meshë falënderimi në Kishën Katedrale të Lezhës në orën 9.00 paradite dhe pastaj u bë një ceremoni pranë memorialit të Skënderbeut.

Opinioni i Ditës

Nga Monika Kryemadhi

# Reforma në drejtësi, ne nuk mund të përdorim dy standarde

*(Vijon nga faqja e parë)*

... "LSI ka qenë një nga forcat politike kryesore dhe ndërhyri jashtëzakonisht fort për miratimin e Kushtetutës me konsensus"- tha ajo.

**Ka pasur një zhvillim për ngritjen e KLP-së dhe KLGJ-së dhe opozita ka marrë pjesë. Kjo do të thotë se tashmë do të votoni në këtë proces?**

Ajo çka dua të them është që opozita ka paraqitur ditën e hënë në parlament dy amendamente dhe një letër drejtuar Kryetarit të Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, për sa i përket rikthimit të parlamentit në shtratin kushtetues dhe ajo që ndodhi më 18 dhjetor, le të themi, një rrënim i Kushtetutës, e cila u miratua me 140 vota nga të gjithë deputetët e Kuvendi, më datë 21 korrik duke gdhirë data 22 e 2016. Pra, ajo çka ndodhi më 18 dhjetor shënoi një kapje të kësaj reforme. Ku ndërkohë opozita, për t'i dhënë shansin edhe njëherë mazhorancës të tregojë se ka vërtet dëshirë të tregojë një vullnet të pastër për të realizuar reformën, dhe për të ecur më tej me zbatimin e saj. Pra, për të mos treguar shenjat e kapjes ndaj sistemit, ose për të mos treguar frikën ndaj sistemit të ri të drejtësisë, ishte një shans që ne i ofruam, kur, në fakt, është një letër shumë e thjeshtë, e cila kërkon rikthimit të parlamentit në shtratin kushtetues dhe në ligjshmërinë e tij. Ashtu sikurse për të vazhduar për ngritjen e KLP dhe KLGJ në mënyrë institucionale për vetë faktin se Gjykata Kushtetuese ka sjellë një rrëzim të funksionimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe atij Gjyqësor. Janë dy nene, një për prokurorin e përkohshëm, i cili nuk ekziston në Kushtetutë, kur i mbaron mandati, jo kur i ndërpritet. Domethënë ne nuk mund të përdorim dy standarde për një gjë, që është shkruar për të gjithë shqiptarët, pra që kërkon një barazi, sepse ne nuk mund të themi që për politikën e përdorim, e shkelim Kushtetutën, ndërsa për qytetarët e thjeshtë nuk e shkelim. Ndërsa për sa i përket KLP dhe KLGJ janë dy nene, një nga këto ka 10 pika që bën funksionimin e KLP dhe KLGJ.

**Do të kushtëzohet vota juaj për ngritjen e KLP dhe KLGJ me ndryshimin e amendamentit kushtetues?**

Kurrsesi nuk mund të funksionojë KLP dhe KLGJ, nëse nuk bëjmë ndryshimet kushtetuese. Kryeministri Rama ditën e hënë, pa e lexuar se çfarë kishte propozuar opozita, ktheu një përgjigje dhe tha ne nuk e zbatojmë. Në qoftë se opozita pati për herë të parë një propozim në tryezë për mazhorancën, pra tregoi një vullnet të mirë. Është e sinqertë në atë që ofron, sepse nuk ka asgjë konspirative. Ka një material, besoj se mediat janë njohur me amendamentet, të cilat për herë të parë janë të shkruara. Një nga pikat është për zgjedhjen e prokurorit të përkohshëm që të mos ketë mundësi, edhe opozita të përdori veton e saj, pra mos ta kushtëzojë veton për zgjedhjen, por të jetë e pavarur dhe të ketë edhe mekanizmin zhbllokues. Sigurisht që për sa i përket ndryshimeve në zgjedhjen e KLP dhe KLGJ, nëse do të rikthehet parlamenti në bazat e kushtetutshmërisë. Nëse të gjitha ndryshimet kushtetuese, të cilat ne i kemi miratuar me 140 vota, por mazhoranca kërkon t'i uzurpojë dhe t'i rrëmbejë atëherë është e kotë që të flasim, sepse të diskutosh me një strukturë, e cila ka kryer në puç institucional, është humbje kohe.

**Jeni rakorduar me PD për qëndrimin që do të mbani për reformën në drejtësi?**

Patjetër që jemi rakorduar, sepse për sa iu përket qëndrimeve tona për Kushtetutën, janë shumë të rëndësishme. Dua të them që LSI ka qenë një nga forcat politike kryesore dhe ndërhyri jashtëzakonisht fort për miratimin e Kushtetutës me konsensus, sepse kjo është shumë e rëndësishme. Sepse ndryshime shumë të rëndësishme që kanë të bëjnë jo vetëm me sistemin në drejtësi për reformën në drejtësi, por dhe për integrimin Shqipërisë në BE janë shumë të rëndësishme miratimet e ligjeve në mënyrë konsensuale. Sepse një nga kushtet kryesore për hapjen e negociatave të Shqipërisë me BE është dialogu politik, i cili është shumë i rëndësishëm.

**A keni mbështetjen e ndërkombëtareve për të ndryshuar amendamentin kushtetues?**

Unë sot kam hartuar një letër, të cilën nesër do ua drejtoj të gjithë ambasadorëve të BE, gjithë institucioneve ndërkombëtare, qoftë në BE, qoftë në institucione të tjera ndërkombëtare, për t'iu bërë të qartë kërkesat që ne si opozitë i kemi paraqitur. Ndërkohë jemi rakorduar dhe me PD që dhe ata nga ana e tyre të informojnë të gjithë ambasadorët e vendeve të BE që janë në Shqipëri, por jo vetëm ata, por dhe të gjithë institucionet e tjera ndërkombëtare, sepse është shumë e rëndësishme për t'i njohur me realitetin.

**Nuk e njihnin kur e mbështetën, nuk njihnin realitetin?**

Po sigurisht, sepse ne e kemi të shkruar në Kushtetutë që prokurori zgjidhet me 84 vota. Dhe zgjidhet me konsensus.

**Kemi pasur një interpretim të OPDAT...**

Jo nuk ka qenë i OPDAT, ka qenë interpretim i EURALIUS, sepse OPDAT nuk është shprehur, për hir të së vërtetës. Është një letër që z. Ulsi Manja, në mënyrë individuale, jo si kryetar i Komisionit të Ligjeve. Sepse si kryetar i Komisionit të Ligjeve duhet të bëjë një mbledhje të komisionit.

**Ka pasur dhe një qëndrim publik të ambasadorit amerikan më 7 dhjetor.**

Ambasadori amerikan ka pasur një qëndrim publik për largimin e prokurorit, për mbarimin e mandatit të prokurorit të kaluar. Megjithatë, unë nuk besoj se ambasadori amerikan do t'i kërkojë parlamentit shqiptar që të shkelë Kushtetutën. Ne kemi qenë të gatshëm dhe ia kemi ofruar gjithmonë bashkëpunimin tonë si opozitë, për të zgjidhur këto ngërçe kushtetuese, të cilat janë shumë të rëndësishme, sepse ne nuk mund të përdorim dy standarde. Nëse ne iu themi shqiptarëve që do bëjmë reformë në drejtësi, reforma në drejtësi nuk është vetëm për hallexhinjtë. Reforma në drejtësi fillon në radhë të parë për klasën politike. Ne nuk mund të përdorim dy standarde. Për politikanët, për të korruptuarit, ne e shkelim Kushtetutën dhe të bëjmë sikur nuk shohim, ndërsa për hallexhinjtë i marrim i fusim në burg dhe i harrojmë nëpër birucat e burgjeve. Sepse e tillë është reforma. Shqiptarët nuk besoj se kanë aspiruar për një reformë në drejtësi, e cila ka dy lloj standardesh. Unë jam e bindur që komuniteti ndërkombëtar nuk mund ta thotë hapur dhe unë dua të dëgjoj ku kemi një deklaratë të ndonjë ndërkombëtari, që thotë shkelni Kushtetutën. Absolutisht. Nuk ia ka kushtëzuar njeri atyre emrin e prokurorit të përkohshëm, pavarësisht se nuk ekziston, por ama është e thënë që prokurori zgjidhet me veting. Në qoftë se ne të gjithë këtë histori që kemi bërtitur, ulëritur, kemi tre vjet që bërtasim vetingu, vetingu i famshëm, ne do bëjmë një veting. Por, nëse ne reformën në drejtësi duam ta bëjmë, siç u bë 'policia që duam' e Saimir Tahirit, atëherë bujrum, le ta marrim, dhe të mbajnë përgjegjësi ambasadorë, ndërkombëtarë, kombëtarë, institucionalë, politikanë, kryeministër, media, çdo gjë. Por unë nuk besoj se shqiptarët duan që të kenë një reformë në drejtësi, të kemi prokuror dhe gjykatës siç kishim 'policinë që duan', që ishte e përfshirë komplet në trafikun e drogës dhe sot treçereku i policisë është në kërkim dhe ne nuk e dimë ku janë.



**Z. Rama është shprehur se LSI ka vepruar 'hidhte gurin dhe fshihte dorën' keni ndonjë koment për këtë?**

Nuk kam asnjë lloj komenti. Unë dua të them këtë gjë, që reforma në drejtësi pa LSI nuk do bëhej dhe nuk do të ishte e realizuar, pavarësisht se personit që nuk i ka interesuar për ta realizuar reformën në drejtësi ka qenë z. Rama. Kështu që, nuk kam ndërmend të nis diskutime personale me të. Kjo ka të bëjë me rolin që ka pasur LSI-a, e cila ka qenë një ndër rolet vendimtare, sepse qoftë departamenti i shtetit apo BE, por edhe ndërkombëtarët kërkonin që reforma në drejtësi të miratohej me konsensus. Mbaj mend tre ligjet e famshme para se Shqipëria të merrte statusin për vendin kandidat, të cilat duhej të miratoheshin me konsensus. Por mos të harrojmë edhe një gjë tjetër, që paketë e këtyre ligjeve ishte vendosur edhe rregullorja e parlamentit, të cilën LSI po të donte ia jepte votat PD në atë kohë dhe ta kalonte në një shumicë të thjeshtë. Por, jo pa qëllim rregullorja e vendit u fut pjesë e konsensusit, për të vetmen arsye, sepse ishte shumë e rëndësishme për të pasur një mbarëvajtje dhe një ndërtim institucional të marrëdhënieve midis opozitë-mazhorancë-parlament. Mora vesh sot që PS paska bërë propozim për të ndryshuar Rregulloren e parlamentit, gjë që është shumë e habitshme, por kjo tregon një lloj frike dhe uzurpimi. Me aq sa pashë kishte të bënte me heqjen e imunitetit dhe arrestimin e deputetëve. Nuk është se kam shumë dijeni, por me aq sa mora vesh ka të bëjë më paraqitjen e provave nëse kërkohet arrestimi i një deputeti nga prokuroria. Por atëherë i bie që mos heqja e imunitetit dhe mos arrestimi i z.Tahiri ka qenë i paligjshëm. Pra i bie që parlamentin ta kthejnë në një formë gjykate, ku ne ndërkohë i kemi gjykata dhe parlamenti duhet të kryejë funksionin e tij.

**Jemi pak ditë para protestës së opozitës PD-LSI. Tonet janë më të qeta krahasuar me protestën e parë. Keni ndryshuar strategji?**

Unë jam shumë e qartë në qëndrimet e LSI-së. Gjithashtu, opozita është shumë e qartë sa i përket rolit të zbatimit kushtetues. Në fundit të fundit në politikë, kush e bën ndarjen e demokracisë nga diktatura? Sigurisht që kushtetuta dhe rregullat. Pse vendosen rregullat? Sigurisht që për t'u zbatuar. Ajo që është e rëndësishme është që, opozita, në një farë mënyre, është garanci e zbatimit të Kushtetutës dhe fjala e lirë është e vetmja gjë që ka opozita. Protestat janë e vetmja gjë që ka opozita në dorë. Protestat janë një instrument legjitim, jo vetëm i opozitës, por i çdo qytetari për të protestuar në një vend të lirë dhe demokratik. Në qoftë se Shqipëria nuk është një vend demokratik, por një vend diktatorial, atëherë të ndërrojnë ligjet, numrat në parlament i kanë, siç bënë me dhunimin e Kushtetutës më datë 18 dhjetor dhe kjo është shumë e thjeshtë. 18 dhjetori është vërtet shumë i rëndë. Nuk ka të bëjë as me Monikën, as me LSI-në, as me politikën, ka të bëjë me atë se çfarë do t'u ndodhë shqiptarëve nesër. Sepse kur një njeri kërkon të uzurpojë, jo vetëm institucionet kushtetuese dhe Kushtetutën ditën për diell, dhe na bën ne për budallenj, atëherë kjo tregon që jo vetëm ka rënë shteti, por ka rënë çdo gjë. Sepse, në fundit të fundit, Kushtetuta çfarë është? Garanci e zbatimit të ligjit.

**A keni një skenar se si do të zhvillohet protesta e 27 janarit?**

Dua t'ju them diçka tepër të rëndësishme që, protesta e 27 janarit është një protestë demokratike. Opozita është e detyruar nga kërkesa e qytetarëve. Sepse në takimet tona ne shikojmë vazhdimisht trishtimin dhe dhimbjen që kanë bizneset e vogla, për sa i përket rritjes së taksave. Shikojmë dhimbjen dhe humbjen e shpresës te të papunët, të cilët do të shohin këtu një mënyrë për të reaguar. Protesta e 27 janarit i përmbledh të gjitha, sepse varfëria, papunësia, mjerimi, krimi, dhuna, mungesa e shpresës ka sjellë që, gjithë këtë trishtim, që ka përfshirë gjithë shqiptarët, ta mundohen ta mbulojnë me shkeljen e Kushtetutës dhe dhunimin e saj. Çfarë e detyroi mazhorancën që më datën 18 dhjetor të bënte një veprim të tillë? Frika. Frika e protestës, frika e njerëzve. Kërkon të marrë instrumentin e Prokurorit të Përgjithshëm për të ushtruar dhunë dhe presion ndaj prokurorëve. Dhunë dhe presion ndaj bizneseve.

**Nuk do të ndërhyjnë ndërkombëtarët, nëse vinin re që kjo mazhorancë po merr pushtetin...**

Unë mendoj se z. Rama nuk mund të vazhdojë të fshihet pas kostumeve dhe fustaneve të ndërkombëtarëve. Por, sado që ai mundohet t'i manipulojë, sado që ai mundohet t'i keqinformojë, e them këtë me bindje, sepse të gjitha kontaktet që ne kemi pasur me ambasadorë, apo edhe me përfaqësues të institucioneve të tjera ndërkombëtare, shikojmë dhe konstatojmë me bindje që ka një deformim qëkur ka filluar fushata zgjedhore dhe procesi i zgjedhjeve dhe përfundimi i këtij procesi, e deri tek ardhja e datës 18 dhjetor. Nuk di që të ketë një ndërkombëtar që t'i ketë thënë z. Rama që të zgjedhë kryeprokurorin me 69 vota. Ashtu sikurse EURALIUS, që ju përmendët pak më parë, është një institucion konsultativ, jo vendimmarrës. Për LSI dhe gjithë klasën politike, Komisioni i Venecias është kryesor. LSI ishte ajo që votoi 7 ligjet, që i dha 84 votat për votimin e 7 ligjeve dhe tregoi hapur që Partia Demokratike kishte shumë të drejtë që mazhoranca do të kërkonte ta përdorte për të kapur reformën në drejtësi, sepse një nga kushtet që ne kishim kush ishte? Zgjedhja e një kryeprokurori jo nga klasa politike.

**Z. Rama i bëri disa thirrje publike opozitës për negociata.**

Mesazhet qesharake të z. Rama në "Facebook" si "Luli, lëri llafet dhe hajde voto" janë thirrje, të cilat e shtyjnë opozitën që të largohet nga tryeza e diskutimeve. Edi Rama kurrë nuk i ka ofruar opozitës, apo qoftë PD-së, seriozisht bashkëpunimin.

**Si duhet ta shprehë seriozitetin?**

Sepse ka institucione. Opozita i ka paraqitur 2 dokumente. Një letër z. Ruçi, të cilit i jepet shansi për të treguar edhe një herë që nuk është i kapur dhe që ka një lloj fisnikërie brenda vetes së tij dhe të tregojë që kërkon ta rikthejë në tempullin e demokracisë opozitën. Të mos ketë më marrëdhënie të kushtëzuar me parlamentin. Të tregojë edhe një herë që nuk një vegël e një grupi të caktuar. Z. Rama e ka shumë të qartë, ai nxori z. Manja. Ulsi Manja mund të flasë si kryetar i Komisionit të Ligjeve, por ka një problem, që ai është për të drejtuar mbledhjen dhe jo për ta marrë vendime. Ka një sekretariat, ku është nënkryetari i komisionit dhe sekretari që marrin vendime për rendin e ditës, apo edhe për letrat e dërguara në mënyrë kolegjiale.

**Ka dhe nga ata që e shikojnë edhe si një garë mes PD-së dhe LSI-së, apo jo?**

Absolutisht që jo. Më shumë e shoh si një nxitje që po e bën Rama, sepse gjithmonë kërkon që nga gjëra shumë të rëndësishme ta kalojë vëmendjen në gjëra shumë të vogla. Është njeri i detajeve, por jo thelbësor. Opozita është një pjesë e protestës më 27 janar. Pjesa më e madhe do të jenë të gjithë ata njerëz, të cilët kërkojnë barazi në ekonomi, barazi në drejtësi, barazi në Shqipëri. Të gjithë duam të jemi njerëz të barabartë në një vend demokratik. Për këtë kemi luftuar 27 vite më përpara dhe vjen dita sot kur i rikthehemi të njëjtave kërkesa. Kërkojmë barazi për të ndërtuar një ekonomi të fortë, kërkojmë barazi për të zhvilluar një sistem arsimor të drejtë për të gjithë, kërkojmë një sistem drejtësie të barabartë për të gjithë, që institucionet shqiptare të jenë të barabarta për të gjithë.

**Mund të më thoni si është gjendja në bazë të LSI-së?**

Gjendja është shumë e mirë. Ajo që më bën më shumë përshtypje është se njerëzit janë pak më agresivë se jam unë.

Opinioni i Ditës

# Dëmshpërblimi i të përndjekurve - detyrim kushtetues, jo lëmoshë

Nga Besim Ndregjoni

*(Vijon nga faqja e parë)*




... të ndërtuar një shtet të së drejtës, demokratik e social, për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut duke e pranuar njëherazi shtetin e së drejtës si një nga parimet më fondamentale në një shoqërie postkomuniste. Ligji "Për dëmshpërblimin e ish - të përndjekurve politikë të regjimit komunist, konkretizon jo vetëm premtimin politik publik në përmbushjen e detyrimeve morale dhe ligjore që shoqëria jonë ka ndaj kësaj shtrese të nderuar, por njëherazi formaton seriozisht korpusin e ligjeve për shtetin e së drejtës që ne po ndërtojmë. Mbas 27 vjet tranzicion del Ministri i Financave dhe deklaron me papërgjegjshmëri dhe në kundërshtim me Kushtetutën, por dhe me kërkesat e Forumeve Europiane se qeveria e tij nuk do të dëmshpërblejë trashëgimtarët e të përndjekurve politikë. Urrejtje ideologjike apo lajthite individuale e ministrit. Institucionet Europiane kërkojnë një qeverisje të standardit perëndimor, ku ne aspirojmë të integrohemi, larg frazeologjive të bukura letrare, larg çdo patetizmi që gjithsesi do të ishte i drejtë.

Më duhet të theksoj në krye të herës në këtë shkrim, se me këtë ligj plotësojmë kërkesat ligjore që garantohen në nenin 44 të Kushtetutës së Shqipërisë të vitit 1998 "Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe /ose zhdëmtohet në përputhje me ligjin në rast se është dënuar për shkak të një akti veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore". Ne, të gjithë, shoqëria shqiptare kemi arritur në deduksionin logjik se: Regjimi komunist në Shqipëri, 1944-1990 ishte antikombëtar, i paligjshëm dhe kriminal. Si i tillë ky regjim është dënuar nga e gjithë shoqëria shqiptare pa të drejtë apelimi. Organi ligjvënës, Kuvendi i Shqipërisë, parlamenti i parë pluralist i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr.7514 datë 30.09.1991 duke përdorur kompetencat e tij, u jep ish- të burgosurve, dhe të përndjekurve politikë, pafajësinë, dhe e konsideron në nderin e vet që si përfaqësuesi më i lartë i popullit, në emër të shtetit juridik t'u kërkojë falje këtyre njerëzve për dënimet politike dhe vuajtjet që kanë pësuar në të kaluarën ".Neni 1 i ligjit sanksionon se: "Janë të pafajshëm dhe quhen të padënuar për efekte moshe, politike, sociale dhe ekonomike të gjithë personat që janë dënuar për legjislacionin dhe propagandën kundër shtetit, arratisje, sabotim, pjesëmarrje në organizatat politike etj. "Kjo pafajësi, e theksoj PAFAJESI, e lidhur me nenin 18 të Kushtetutës për barazi para ligjit u jep të drejtë të dëmshpërblehen në masën e parashikuar në Kodin Penal, e konkretisht në nenin 57 të tij. Për të arritur tek Kuvendi aktual që duke iu referuar Rezolutave të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës dhe konkretisht Rezolutës nr.1096 (viti 1996) "Masat për të çrrënjosur trashëgiminë e sistemeve totalitare komuniste". Rezoluta nr.1481 ( vitit 2006) " Domosdoshmëria për dënimin ndërkombëtar të krimeve të regjimeve totalitare komuniste" si dhe vendimeve të Konventës së Parë Kombëtare të Unionit Mbarëkombëtare për Integrimin e të Përndjekurve Politike dhe të Qendrës Shqiptare të Rehabilitimit të të Mbijetuarve të torturës" Për dënimin e krimeve të komunizmit në Shqipëri", datë 12.05.2006 në pikën 15 të Rezolutës të miratuar nga ky Kuvend: " Mbështet hartimi i një strategjie kombëtare për eliminimin e pasojave të totalitarizmin gjysmë shekullor në Shqipëri dhe fton institucionet shtetërore të përmbushin të gjitha detyrimet ligjore lidhur me statusin e të përndjekurve politikë për integrimin, arsimin, punësimin, strehimin dhe dëmshpërblimin e tyre në një kohë sa më të shpejtë". Pra, qeveria në këtë rast s?ka bërë asgjë tjetër veçse ka përmbushur detyrimin e saj ligjor, e theksoj detyrimin ligjor kushtetues.

Nga ana tjetër, sipas të Drejtës Ndërkombëtare bashkëkohore konkretisht: Deklarata e Parimeve Themelore të Drejtësisë për viktimat e krimeve dhe të abuzimit me pushtetin, aprovuar me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB viti 1985 / "Viktimat kanë të drejtën për dëmshpërblim të menjëhershëm për dëmin e pësuar, dhe, se shtetet duhet të përpiqen të parashikojnë kompensim financiar". Ligji i datës 29.07.1993 nr.7748 "Për Statusin e ish - të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", obligon shtetin demokratik që pavarësisht nga vështirësitë me të cilat ndeshet shteti dhe shoqëria shqiptare e ka detyrë dhe përgjegjësi morale e historike që të respektojë dhe të marrë masa konkrete për realizimin e së drejtës ligjore të dëmshpërblimit e kompensimit këtij grupimi të madh, të konsiderueshëm, të orientuar historikisht e politikisht. Duke sintetizuar në një të Drejtat Kushtetuese Dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë, përfshi Kodin Penal etj. si dhe detyrimet nga e Drejta Ndërkombëtare, në funksion të përmbushjes edhe të detyrimeve që shtron integrimi në radhën e shteteve demokratike europiane, parimi i drejtësisë ka marrë në konsideratë edhe interesat e tjera të shoqërisë, si dhe interesin publik në tërësi duke pasur synimin kryesor zvogëlimin (pa arritur dot objektivisht zerimin) e pasojave të këtyre padrejtësive përmes përcaktimit të grupimeve përfitues, masës së dëmshpërblimit, shtrirjes në kohë të tij etj., në mënyrë që zgjidhja të jetë e qëndrueshme, efektive. Parimi i barazisë kërkon ndalimin e diskriminimit dhe trajtim të barabartë në të drejta e të gjithë viktimave. Duke qenë të vetëdijshëm se dëmshpërblimi dhe kompensimi në tërësi janë detyrime pozitive të shtetit për integrimin dhe rehabilitimin e kësaj kategorie njerëzish në shoqërinë shqiptare. Pra, filli kryesor i këtij ligji është respektimi i dinjitetit të barabartë të çdo personi që për shkak të burgosjes apo përndjekjes politike gjatë regjimit komunist përfiton interesin publik në tërësi duke pasur synimin kryesor zvogëlimin (pa arritur dot objektivisht zerimin) e pasojave të këtyre padrejtësive përmes përcaktimit të grupimeve përfitues, masës së dëmshpërblimit, shtrirjes në kohë të tij etj., në mënyrë që zgjidhja të jetë e qëndrueshme, efektive. Pra, filli kryesor i këtij ligji është respektimi i dinjitetit të barabartë të çdo personi që për shkak të burgosjes a përndjekjes politike gjatë regjimit komunist përfiton nga Kushtetuta dhe ligjet shqiptare. Dëmshpërblimi dhe kompensimi i të burgosurve politikë duhet të jetë më shumë reflektim i detyrimeve ligjore, por edhe vuajtjeve të tyre, hallet dhe problemet me të cilat ballafaqohet jeta e përditshme.

Dua të kujtoj këtu që, ligji i qeverisë socialiste i vitit 2004, i cili me të drejtë u hodh poshtë nga Gjykata Kushtetuese parashikonte ta dëmshpërblente këtë kategori me një vlerë financiare 30 lekë në një muaj, që është e barabartë me dëmshpërblimin në një ditë, ku Gjykata Kushtetuese e hodhi poshtë si një ligj diskriminues ndaj viktimave të komunizmit, ligji i vitit 2007 kthehet me dinjitet dhe plotëson atë obligim moral, politik e historik jo vetëm thjesht ndaj shtresës së ish-të përndjekurve politikë, por edhe me gjerë, detyrimet ligjore ndaj Kushtetutës apo dokumenteve të ndryshme ndërkombëtare Ligji nr. 9831, datë 12.11.2007 "Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist". Është vënë në zbatim nga qeveria e mëparshme demokratike, e cila për hir të së vërtetës me gjithë politizimin dëmshpërbleu 24 .000 qytetar me dy këste. Ndryshe ndodhi me PS që është në pushtet. Ajo ka dhënë 3 këste për 2000 qytetar duke bërë një diferencim klasor me arsyetimin të gjallët nënkupto të burgosurit, e te trashëgimtarët asnjë qindarkë dhe këto nga mosha po i kalojnë të 60-tat, dhe në propagandën e saj qeveritare deklaron se kemi dhënë 5 këste duke përfshirë dhe 2 këstet që i ka dhënë PD. Problemi i dëmshpërblimit duhet të mos trajtohet politikisht, por ligjërisht se ai është një ligj detyrues kushtetues për ata qytetar që përballuan vuajtjen plumbin torturat nga një regjim diktatorial. Problemi i dytë është se rreth 1000 të përndjekur i kanë dorëzuar dokumentet mbas afatit dhe duhet të kalojnë për të u dëmshpërblyer. Dëmshpërblimi nuk është lëmoshë e qeverive, por detyrim ligjor kushtetues dhe detyrues për zbatim për çdo qeveri e majtë e djathtë. I sjellim në vëmendje ministrit të Financave mbas deklaratës që bëri dje se qeveria e tij do të propozojë heqjen e dëmshpërblimit, për trashëgimtarët, të lexojë Kushtetutën e vendit, konventat ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe Kodin Civil që përcakton trashëgiminë e qytetarit në sistemin demokratik në Republikën e Shqipërisë.

E paralajmërojmë ministrin e Financave çdo vendim politik ndaj të përndjekurve politikë do të jetë fundi i turpshëm i urrejtjes suaj dhe qeverisë që ju bëni pjesë. Ne nuk iu frikëm plumbave të etërve tuaj jo t'u frikemi vendimeve politike staliniste të një ministri që me këtë vendim do të fshijë krimet makabre të komunizmit. Urrejtja juaj ndaj të përndjekurve politikë do të mposhtet nga paqja që ne i kemi përcjellë shqiptarëve nga 28 vite pluralizëm.

***President i Unionit të të Burgosurve dhe të Përndjekurve Politikë të Shqipërisë***

# VDEKJA E OLIVER IVANOVIÇ
## REAGIMET



**MOTRA E VIKTIMËS**

Pas vrasjes së kreut të SDP ka reaguar edhe motra e tij, Natasa Ivanoviç Iliq. "Ai më nuk është dhe tani asgjë tjetër nuk ka rëndësi",-u përgjigj ajo, në pyetjen se a beson se drejtësia kosovare do ta gjejë shpejtë dorasin e kësaj vepre. Nuk kam asnjë fuqi për të folur. Kuptoni dhimbjen tonë", ka thënë shkurt ajo.



**RADIKALI SHESHEL**

Lideri radikal serb, Vojislav Sheshel ka akuzuar shqiptarët për vrasjen e politikanit serb, Ivanoviç. Ai tha se në vrasje mund të jetë e përfshirë një organizatë shqiptare. "Mund të jetë një organizatë shqiptare që e ka bërë këtë, si pjesë e përpjekjeve për të shfuqizuar Gjykatën Speciale për krime lufte të kryera nga UÇK",-tha ai.



**FEDERICA MOGHERINI**

Përfaqësuesja e lartë e BE-së për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë dhe zv/presidente e KE-së, Federica Mogherini ka zhvilluar bisedë telefonike me presidentin e Kosovës dhe atë të Serbisë, pas vrasjes së liderit të serbëve të veriut, raporton Anadolu Agency. Ajo u bëri thirrje të gjitha palëve të tregojnë qetësi dhe përmbajtje si dhe të lejojnë sundimin e ligjit dhe drejtësinë të marrë rrugën e saj.

Lideri i SDP-së masakrohet me 6 plumba në kraharor në Mitrovicë, zbulohet pronari i makinës së vrasjes

# Vrasja e Ivanoviç, gruaja: Do varroset në Beograd

## *Atentati, Vuçiç viziton Kosovën në fundjavë*

Ditën e martë është vrarë lideri i SDP-së, Oliver Ivanoviq ndërsa ishte duke dalë nga zyra e tij në Mitrovicë. Gruaja e Ivanoviç, Milena Ivanoviç, përmes deklarimeve që ka bërë për mediat serbe, ka bërë edhe një postim nëpër mediat sociale lidhur me vrasjen e burrit të saj. Ajo ka thënë se me vrasjen e Ivanoviçit, është vrarë liria, siç edhe është shprehur edhe Serbia. "Ata më goditën në zemër, dashurinë, kënaqësinë. Ata goditën në babanë e Bogdanit. Ata na goditën neve, lirinë, Serbinë",-është shprehur Milena Ivanoviç. Dje, në veri të Mitrovicës, Ivanoviç u qëllua në gjoks, për vdekje, me gjashtë plumba ku njëri ishte fatal për jetën. Lideri i SDP u qëllua rreth orës 8:10 minuta para selisë së partisë së tij, Iniciativa Qytetare. Sipas autopsisë, ai u qëllua në pjesën e sipërme të trupit me gjashtë plumba nga një pistoletë e tipit "Zastava M70A", prodhim serb. Trupi i Ivanoviçit u gjet nga një fqinj që ishte duke shkuar në dyqan. Në orën 9:30, mjekët njoftuan se Ivanoviç kishte vdekur. Ai pritet të varroset në kryeqytetin serb me nderime të larta. Obduksioni i trupit të tij është kryer nga një mjeke serbe në veri të Kosovës. Është quajtur akt që destabilizon rajonin dhe bisedimet. Por, në pah janë vënë edhe marrëdhëniet e brishta të liderit të serbëve të Kosovës me Beogradin për shkak se Ivanoviç konsiderohej pro dialogut dhe vepronte i pavarur. Katër ditë më parë i kishte thënë agjencisë boshnjake SRNA se kishte frikë për sigurinë e tij. Analistët thonë se Ivanoviç ka qenë i gatshëm edhe në kushtet më të vështira të negociojë. "Fatkeqësisht nuk mund të thuhet se kjo është e papritur. Oliver vetë përmes intervistave të tij disa herë ka sqaruar se ai është cak terrorizmit politik që ishte paralajmëruar edhe nga Departamenti Amerikan i Shtetit". Shefi i diplomacisë serbe, Ivica Daçiç, tha se pasojat në marrëdhëniet me Kosovën do të jenë të thella. Opozita ka kujtuar se qeveria e quante paranojak Ivanoviç dhe përçarës të serbëve në Kosovë në fushatë parazgjedhore. "Disa politikanë kanë vizatuar shenjën target në kokë të disa njerëzve këtu. Kushdo që e ka bërë këtë është edhe kundër shqiptarëve dhe serbëve dhe prek dinjitetin e secilit prej nesh", tha Sasha Jankoviç, i Lëvizjes së Qytetarëve të Lirë. Një pjesë e opozitës kanë bërë thirrje për nderim të Ivanoviç dhe protestë. Zyrtarët e lartë serb thanë se nuk i kuptojnë sulmet që vijnë nga opozita. Tri institucionet serbe, Ministria e Drejtësisë, e Brendshme respektivisht policia dhe prokuroria serbe për krim të organizuar, i kanë dërguar kërkesë Kosovës për përfshirje në hetimin në rastin e vrasjes së Oliver Ivanoviçit. Letrat u janë dërguar EULEX-it dhe zyrës së Bashkimit Evropian në Prishtinë pa ndonjë referencë për institucionet e Republikës së Kosovës. Por, ministri i Drejtësisë Abelard Tahiri ka konfirmuar për "Express" se të mërkurën ka pranuar një shkresë nga ministria homologe e tij në Serbi dhe ka sqaruar se shkresa e Ministrisë së Drejtësisë në Serbi nuk kërkon përfshirjen e autoriteteve të Beogradit në hetimin e vrasjes së Oliver Ivanovçit, por kërkon që prokuroria e shtetit serb të ketë informacione shtesë rreth vrasjes dhe zhvillimit të hetimeve. Sipas këtyre dokumenteve, bëhet e ditur se prokuroria për krim të organizuar e Serbisë ka kërkuar që t'i jepen të dhëna, kopje të dëshmive eventuale, të cilat eventualisht janë mbledhur nga organet kompetente gjatë punës për kapjen e autorëve dhe për rrethanat në të cilat është kryer vepra penale. Kurse, në dokumentin e dërguar EULEX-it nga ana e policisë serbe, kërkohet që ata të informohen sa më shpejt që është e mundur për të gjitha masat që janë ndërmarrë deri më tani lidhur me rastin e vrasjes së Oliver Ivanoviçit.



Oliver Ivanoviç

**PRESIDENTI VUÇIÇ SHKON NË KOSOVË**

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç, këtë të shtunë dhe të diel do të shkojë në Kosovë, pas atentatit që iu bë kreut të SDP-së, Oliver Ivanoviç mëngjesin e së martës në Mitrovicë. Lajmi është bërë i ditur nga zyra e presidentit, shkruan "Tanjug". Aleksandar Vuçiç do të zhvillojë bisedime me serbët në Mitrovicën Veriore, Graçanicën si dhe fshatin Llapllasellë. Ndërkohë që dy ditë më parë, Vuçiç e quajti këtë ngjarje një akt terrorist. Ai tha se organet kompetente duhet të punojnë për kapjen e autorëve.

**AUTOPSIA**

Pas autopsisë së bërë liderit të SDP-së, ai u qëllua në pjesën e sipërme të trupit me gjashtë plumba nga një pistoletë e tipit "Zastava M70A", prodhim serb. Trupi i Ivanoviçit u gjet nga një fqinj që ishte duke shkuar në dyqan. Në orën 9:30 mjekët njoftuan se Ivanoviç kishte vdekur. Ekspertët mjekoligjorë thanë se në trupin e tij plumbat e gjetur janë të një arme të vogël dore. Autopsia është kryer nga trupi mjekoligjor i Kosovës në rajonin e Mitrovicës. Ndërkohë që dy prokurorë kanë nisur hetimet, një serb dhe një kosovar.

**VENDNGJARJA**

Kryeprokurori i Mitrovicës, Shyqeri Syla, ka thënë se vrasja ka ndodhur "nga një makinë në lëvizje" një metër larg selisë. Makina, e tipit "Opel Astra", pa targa, u gjet në një rrugë në veri. Policia gjeti tri predha para zyrës së tij. Në objektin ku është selia e Iniciativës Qytetare Serbe ka kamera, dhe pritet të ekzaminohen. Policia kosovare ka deklaruar se pronari i makinës është i regjistruar në pronësi të një personi që nuk jeton më. Sipas këtij mediumi serb, pronari i mjetit, një 70-vjeçar, është një shtetas austriak me prejardhje serbe.

## Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL
1. Pupi regjisor.
5. Kujtohet për një fitore të grekëve ndaj persëve
11. Turner aktore.
12. Fillojnë festat.
13. Skuadër greke.
14. Falen pa fe.
15. U shkrua nga Gorkij.
18. Një sferë për... model.
19. Janë bisha.
22. Parashtesë për dy.
23. Demoni që persekutonte Sarën.
24. Stacion i famshëm orbital.
25. Mendes regjisor.
27. Një rreth i ngushtë miqësor
29. Film me Robert de Niro dhe Jean Reno
30. Këndohen në opera.
32. Është lajm i vjetër.
34. Sharif aktor.
35. Martin i Norma Rae.
36. Mund të jenë filmi.
38. Një jepet për hartim.
39. Ami i Maupassant.
41. Fundi i Turandot.
42. Halili këngëtare.
45. Neill i Jurassic park.
47. Pineda e Garcia Lorca-s.
48. Giorgio stilist

VERTIKAL
1. Morissette këngëtare.
2. Kilmer aktor.
3. Heche aktore.
4. Fillojnë tatëpjetën
5. Është diapozitiv shumë i ndjeshëm.
6. Mbyllin spitale.
7. Në krye të masave.
8. Bëjnë shirit me shi.
9. Qe vajza e Tantalit.
10. Janë më shumë se dëshira
12. Ishte dekret i sulltanit.
15. Qe mbreti i urtë i Pilos.
16. Quinn aktor.
17. Gasol i NBA.
20. Fillojnë garën.
21. Një pjesë e reformave.
26. Është si biskotë.
28. Mund të jetë karmelitan.
29. Sjellin shi.
30. Bel i Maupassant.
31. Direk pa ekstreme.
33. Gjysma e bimëve.
34. Mbyllin një motor.
36. Është bitum.
37. Fara këngëtare.
38. Hanks aktor
39. Stiller aktor.
40. Morrison rockstar.
42. Fillojnë masat.
43. Në krye të tabelës.
44. Derisa janë në fund.
46. Fund filmi.

## Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL
1. Film i hitchock.
6. Fillojnë premierën.
7. Janë legjendat.
11. Kush ka... ka zët.
12. Thurman aktore.
15. Një pjesë e testamentit
16. Një pjesë e studimeve.
18. Kështu është situata e tensionuar.
21. Telefoni në kartëvizitë.
22. Është ngasje.
24. Në krye të autoriteteve.
25. Mbyllin mbledhjen.
26. Pason abetaren.
28. Nisin nga kreu.
29. Fillojnë aafrimin.
30. Cocker këngëtar.
31. Bartok kompozitor.
33. Tiriac që qe tenist.
35. Oxa këngëtare.
36. Kalimi në ekstreme.
37. U shkrua nga Zola.
39. Fise pa fe.
40. Është mballomë.
41. I mungon apatikut.
43. Një pjesë e medaljeve.
44. Një këngëtar lirik.
46. Pak torturuese.
48. Ka privilegjin e jetës.
51. I famshmi Pacino.
52. Nasi shkrimtar.
53. Janë temperaturat më të ulëta.
54. Me pit në box.

VERTIKAL
1. Janë enigmatikë.
2. Emri i Vivaldit.
3. Rrjedh në klepsidër.
4. Inicialet e Selleck aktor.
5. Fillojnë rubrikën.
6. Ishte babai i Proknit dhe Filomelës.
8. Vitet pa kufij.
9. Mbyllin kanate.
10. U shit për një pjatë thjerza.
13. ... e shëndoshë në trup të shëndoshë.
14. Moore aktore.
17. Rocca aktore.
19. Janë përmasa.
20. Fund dhjetori.
23. Mbyllin krahun.
26. Fillojnë kalimin.
27. Duhen ruajtur.
32. Ishte Europa komuniste.
34. Agjenci Kombëtare Lokale
38. Berg kompozitor.
40. Të parat në Amsterdam.
42. Elsa këngëtare.
45. Memoria në computer
47. Me të nxjerrin trarë.
49. Në mes të dhomës.
50. Ekstreme kateti.
52. Kufijtë e lutjes.



## Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigjja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

## SUDOK

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 5 | | 9 | | 4 | 2 | | 8 | |
| | | 6 | | | 5 | 1 | | 7 |
| 4 | | | 8 | | 6 | 2 | | |
| | 1 | | | 9 | 4 | | 6 | |
| | 9 | 4 | | | | 7 | 3 | |
| | 2 | | 7 | 6 | | | 9 | 1 |
| | | 8 | 3 | | 7 | | | 5 |
| 1 | | 7 | 4 | | | 8 | | |
| | | | 6 | 1 | | 9 | | 4 |

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | 1 | 7 | 8 | 4 | 3 | 6 | 5 | 9 |
| 3 | 9 | 4 | 1 | 5 | 6 | 8 | 7 | 2 |
| 6 | 8 | 5 | 7 | 9 | 2 | 1 | 4 | 3 |
| 7 | 6 | 8 | 2 | 3 | 4 | 9 | 1 | 5 |
| 1 | 3 | 2 | 9 | 7 | 5 | 4 | 8 | 6 |
| 4 | 5 | 9 | 6 | 1 | 8 | 3 | 2 | 7 |
| 5 | 7 | 6 | 4 | 8 | 9 | 2 | 3 | 1 |
| 8 | 2 | 3 | 5 | 6 | 1 | 7 | 9 | 4 |
| 9 | 4 | 1 | 3 | 2 | 7 | 5 | 6 | 8 |

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

## PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALEKRYQI (1)
FJALEKRYQI (2)



## Argëtim filozofik



## Argëtim filozofik

SAMI FRASHERI

- Njeriu duhet të përpiqet të mësojë çdo gjë, jo të tregojë veten e tij.
- Zgjuarësia është një dritë hyjnore, ndriçimi i së cilës ndrit jo vetëm sipërfaqen e sendeve, por edhe brendinë e tyre.
- Më i forti i njerëzve është ai që është i zoti të përmbajë vetveten.

## KRIPTOSKEME



## KRIPTOSKEME

*Përgjigja e numrit të djeshëm*



## Thënie të mençura

- Gjeniu i vërtetë është një mendje me fuqi të përgjithshme të madhe, të orientuar rastësisht në një drejtim të caktuar. (Samuel Xhonson)
- Gjithnjë mund të largojmë nga mëkati një njeri që jeton dhe përpiqet. (Gëte)
- Ne nuk jetojmë, thjesht shpresojmë të jetojmë, duke pritur gjithnjë lumturinë në të ardhmen, ndaj është e pashmangshme që s'do të jemi asnjëherë të lumtur. (Blez Paskal)

## HOROSKOPI

### DASHI

Mendojeni mirë përpara se të ndërmerrni një veprimtari ekonomike me miqtë, sepse rrezikoni të dëmtoni lidhjen që ju bashkon në mënyrë të riparueshme. Me Jupiterin që ju vëzhgon, vlerësoni kontaktet me persona me të cilët keni të përbashkëta në fushën e kulturës.

### DEMI

Jupiteri dhe Saturni krijojnë kontakte të shkëlqyera me Marsin dhe ju ndihmojnë të zhvilloni në qetësi projekte shumë premtuese. Do t'ia dilni të organizoni hapësirën ku të qëndroni të vetëm dhe të meditoni, por edhe ku të zbaviteni me shoqërinë.

### BINJAKET

Me ndikimin e Marsit priten ulje dhe ngritje të humorit në lidhje me sqarime familjare, por jo përballje zënkash. Çlirohuni nga të tjerët. Veproni sipas mendjes suaj në çdo mjedis, po u dashur fare t'u përshtateni ritmeve të të tjerëve.

### GAFORJA

Hëna miqësore i buzëqesh Venusit, Marsit dhe Mërkurit. Do të njihni persona, të cilët mund t'jua vërtetojnë menjëherë vlerën dhe sinqeritetin. Po kaloni një periudhë ndryshimesh në çdo fushë. Të papriturat do t'ju bëjnë përsëri vizitë.

### LUANI

Luhatje yjore do të shkaktohen nga bashkëveprimi i vrullshëm i planetëve. Do të sprovohet lidhja juaj në çift me zënka dhe qortime. Më në fund do të hyni në lojë me një bashkëpunëtor, duke sjellë bashkë me të një strategji fituese.

### VIRGJERESHA

Bashkëveprimi i Jupiterit me Uranin do të bëjë t'ju vijnë ide nga më të çuditshmet. Do ta kaloni ditën me kokën mbi re. Nuk do të jetë e thjeshtë të harmonizoni ndjeshmërinë tuaj me atë që keni afër, por është mëse e sigurt që është gjëja e duhur për t'u bërë.

### PESHORJA

Nëse jeni beqarë, një stazh pune dhe një lundrim në internet mund t'ju sjellë një risi të këndshme. Me Saturnin tek shenja juaj, ndoshta do të jeni më i varur se zakonisht për aprovimin nga personat e dashur.

### AKREPI

Sot do të mposhtni çdo mendim shkatërrimtar dhe negativ. Prandaj do të përvishni mëngët dhe do të përmbushni me zell punët tuaja. Në fillim kush ju intereson, do t'i përgjigjet ftesës me droje, por më pas do të dorëzohet nga sharmi juaj.

### SHIGJETARI

Priten perspektiva interesante risish në sektorin e dashurisë, mbi të gjitha nëse jeni beqarë. Do të rrethoheni nga njerëz me të cilët ndiheni mirë dhe do të mënjanoni ata që duan t'u detyrojnë të bëni zgjedhjet e tyre dhe t'ju imponojnë mendimet e veta.

### BRICJAPI

Planetët janë angazhuar dhe po bëjnë gjithçka për t'ju mundësuar kënaqësi në sektorin sentimental. Gjithçka shkon vaj. Pozicionimi i Saturnit është garanci si gjithmonë se gjërat do të zgjasin dhe do të jenë konkrete.

### UJORI

Nëse në jetën e në çift xhelozia dhe dyshimet do t'i kalonin nivelet e normales, jepini fund kur të mundeni dhe ndërroni menjëherë drejtim. Saturni do të bashkëveprojë me Marsin, duke bërë që të jeni në harmoni me kolegët.

### PESHQIT

Gjatë ditës mund t'ju dalin gjëra të paparashikueshme. Për të shmangur tensione, ndiqni atë që ju thotë zemra, edhe pse mund të interpretohet si një dobësi. Do të keni një ditë që priret drejt përtacisë, por që nuk pajtohet me angazhimet e shumta që keni.

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH
www.gsh.al

Tashmë edhe lundroni!

